SUN TZU

ARTI I LUFTËS

Interpretimi përfundimtar i
veprës klasike të Sun Tzu për strategjinë

ARTI
I LUFTËS

SUN TZU

PARATHËNIE

Arti i Luftës përbën librin më të mirë dhe më të shquar të strategjisë ushtarake të të gjitha kohërave. Libër që i kishte shërbyer si burim frymëzimi për bëmat e mëtejshme ushtarake Napoleon Bonapartit, si inspirim dhe shembull edhe vetë Nikolo Makiavelit, si yll polar Mao Ce Dunit dhe shumë e shumë figurave të tjera të rëndësishme përgjatë historisë. Ky libër me plot dy mijë e pesëqind vite jetë është një ndër tekstet më të vyera dhe të spikatura të klasikëve kinezë, në të cilin, pavarësisht kohës dhe kalimit të shekujve e mijëvjeçarëve, asnjë nga parimet e tij nuk mund të cilësohet si i vjetëruar dhe të gjitha këshillat e tij vijojnë të jenë të dobishme edhe sot e kësaj dite.

Megjithatë, vepra e gjeneralit Sun Tzu nuk ngërthehet vetëm nga të qenët një libër mbi praktikat ushtarake, por është pa dyshim një traktat i mirëfilltë që i shpërfaq lexuesit strategjinë më të epërme të zbatimit me mençuri të dijenive lidhur me natyrën dhe karakterin njerëzor në momentin e përballjes në fushën e betejës. Pra, ky nuk është një libër mbi luftën; më tepër mund të konsiderohet si një vepër që të shtyn të kuptosh më qartë se ku ndryhen rrënjët e një konflikti dhe rrjedhimthi të kërkosh edhe zgjidhjen. "Fitorja më e mirë është ngadhënjimi pa luftuar", na pohon Sun Tzu-ja, "dhe pikërisht ky është dallimi mes njeriut të matur dhe injorantit".

Sun Tzu ishte gjeneral kinez që jetoi rreth shekullit të pestë para Krishtit. Koleksioni i eseve mbi artin e luftës, të

shkruara nga Sun Tzu, përbën traktatin më të lashtë që ka njohur njerëzimi mbi këtë temë. Pavarësisht lashtësisë së tyre, këshillat e Sun Tzu-së vazhdojnë të mbartin po të njëjtën vlerë. Vepra e Sun Tzu-së erdhi në Europë për herë të parë në periudhën para Revolucionit Francez, përmes një përkthimi të shkurtër të realizuar nga prifti jezuit J. M. Amiot. Në përkthimet e shumta që janë kryer pastaj, emri i autorit herë shqiptohet si Sun Wu e herë të tjera si Sun Tzi. Thelbi i filozofisë së Sun Tzu-së mbi çështjet e luftës prehet në këto dy parime:

1. I gjithë arti i luftës mbështetet te dredhia dhe mashtrimi i armikut.
2. Arti më i epërm dhe i rafinuar i luftës ka të bëjë kryesisht me nënshtrimin dhe mposhtjen e armikut pa luftë.

Idetë e Sun Tzu-së ishin përhapur në gjithë Azinë gjersa kishin arritur në Japoni. Japonezët menjëherë i kishin vënë në zbatim dhe përvetësuar këto mësime dhe është fort e mundur që të kenë shtuar disa të tyret. Besohet gjerësisht se libri kryesor japonez mbi temën e luftës, *Libri i Pesë Unazave*, është ndikuar thellësisht nga filozofia e Sun Tzu-së, meqenëse autori i tij, Miyamoto Mushashi, e kishte studiuar traktatin *Arti i Luftës* gjatë shkollimit dhe përgatitjes së tij për Samurai.

Përgjithësisht, kulturat orientale aty trajtohen si kultura që mbështeten thelbësisht te strategjia dhe ndikimi i veprës dhe mendimit të Sun Tzu-së është tepër i theksuar në këtë zhvillim specifik kulturor. Në ditët e sotme, filozofia e artit të luftës ka marrë një zhvillim që shkon përtej kufizimeve ngurtësisht ushtarake, duke u zbatuar edhe në fushën e tregtisë, të sportit e edhe të vetë sjelljeve personale të njeriut. Për shembull, shumë fraza kyçe të manualeve moderne për

menaxhimin e ndërmarrjeve dhe firmave të ndryshme tregtare përbëjnë praktikisht citime tekstuale të veprës së Sun Tzu-së (duke e ndryshuar për shembull, fjalën "ushtri" me "ndërmarrje" ose "firmë", ose fjalën "armatime" me "burime natyrore ose njerëzore"). Idetë e tij vijojnë të kenë të njëjtën vlerë pavarësisht 25 shekujve të kaluar qyshkur ato ishin ngjizur në mendjen e autorit dhe shkruar prej tij.

KAPITULLI I

PLANIFIKIMI, VLERËSIMI I GJENDJES
始計

Lufta përbën diçka me vlerë thelbësore për shtetin: një çështje për jetë a vdekje; shtegun pra, që të shpie drejt mbijetesës apo rrënimit. Kështu, është e domosdoshme që ajo të studiohet imtësisht.
Ajo duhet vlerësuar përmes pesë faktorëve themelorë, duke bërë krahasimet përkatëse të kushteve të ndryshme të palëve në konflikt në mënyrë që të përcaktohen rezultatet e luftës në vetvete. I pari ndër këta faktorë është politika; i dyti, moti; i treti, terreni; i katërti, komandanti; dhe i pesti nga ta është doktrina përkatëse. Politika përbën atë faktor që i shtyn njerëzinë që të bashkëjetojnë në harmoni të plotë me sundimtarin e tyre, në mënyrë që ata të jenë të gatshëm ta ndjekin atë pavarësisht sigurisë për jetët e tyre dhe pa iu druajtur asnjë rreziku. Ndërsa moti në vetvete ka të bëjë me natën apo ditën, të ftohtin apo të ngrohtin, me ditët me kohë të bukur apo shiun, dhe me ndërrimin e stinëve. Terreni lidhet me largësitë, dhe ka të bëjë me faktin nëse ky i fundit mund të përshkohet me lehtësi apo vështirësisht dhe me atë nëse është terren i hapur apo i ngushtë, duke ndikuar kështu te mundësitë e juaja për mbijetesë apo vdekje. Sa i përket komandantit, ai duhet të zotërojë cilësitë themelore të urtësisë, sinqeritetit, dashamirësisë, kurajës dhe të

qenët i disiplinuar. Doktrina do të duhej të kuptohej si e lidhur me organizimin e ushtrisë, shpërndarjen e gradave përkatëse mes oficerëve të ushtrisë, sistemimin e rrugëve të furnizimit, si dhe me sigurimin e materialeve luftarake për ushtrinë.

Këta pesë faktorë themelorë njihen me imtësi nga çdo gjeneral ushtrie. Ata që dinë t'i përdorin faktorët e mësipërm në fund dalin ngadhënjimtarë; ndërsa ata që nuk munden, si përfundim dalin të humbur. Për këtë arsye, teksa përgatisni planet e luftës, bëni një krahasim midis shtatë elementeve të mëposhtme, duke e vlerësuar secilën nga ta me vëmendjen më të lartë.

1. Cili sundues është më i mençur dhe i zoti?
2. Cili komandant është më i talentuar?
3. Cila ushtri gëzon përparësitë e terrenit dhe të natyrës?
4. Në cilën ushtri rregullat dhe udhëzimet zbatohen më rreptësisht?
5. Cilat trupa janë më të forta?
6. Cila ushtri ka ushtarë dhe oficerë të ushtruar më mirë?
7. Në cilën ushtri arrihet që të administrohen në mënyrë më të përshtatshme dhe të mençur shpërblimet dhe ndëshkimet përkatëse?

Falë këtyre shtatë elementeve, unë do të jem i aftë që të parashikoj se cila palë do të dalë fituese dhe cila do të përballet me humbjen.

Ai gjeneral që vendos të ndjekë këshillat e mia, padyshim do të ngadhënjejë. Një gjenerali të tillë patjetër duhet t'i dorëzohen frenat e komandës. Ai gjeneral që nuk i merr parasysh këshillat e mia patjetër mposhtet. Një gjeneral i tillë do të shkarkohet nga detyra më pas.

Pasi të jetë treguar i vëmendshëm ndaj këshillave dhe planeve të mia, gjenerali përkatës do të duhej të krijonte

një situatë përmes së cilës të vihen në pah arritjet e tij. Me fjalën "situatë" nënkuptoj faktin se ai duhet ta marrë parasysh situatën në fushën e betejës dhe të veprojë në përputhje me mundësitë për të nxjerrë përfitimet përkatëse.
I gjithë arti i luftës ka të bëjë me dinakërinë dhe mashtrimin. Prandaj, kur jeni të aftë të sulmoni, shtiruni sikur nuk mundeni ta bëni këtë gjë; kur jeni duke i spostuar trupat, shtiruni sikur nuk mundeni fare të lëvizni vendit.
Kur ndodheni pranë armikut, bëni të duket sikur në fakt jeni shumë larg tij; ndërsa kur vërtet ndodheni shumë larg, bëni të pamundurën që të duket sikur jeni krejt afër.
Përgatisni karremë të ndryshëm për ta joshur armikun. Goditeni armikun pa mëshirë kur atë e ka zënë rrëmuja.
Përgatituni për t'u përballur me armikun kur ai duket i pathyeshëm në çdo aspekt.
Shmangiuni armikut për aq kohë sa të jetë nevoja, kur ai është më i fuqishëm se ju.
Nëse kundërshtari juaj ka një karakter kolerik, rrekeni gjithmonë që ta acaroni atë.
Nëse keni të bëni me një armik arrogant, përpiquni që t'ia mikloni atij këtë egoizëm.
Nëse trupat armike janë të mirëpërgatitura pas një riorganizimi, synoni që t'i ndillni sërish trazirat në radhët e tyre.
Nëse këta trupa janë të bashkuar, përpiquni të mbillni farën e përçarjes mes tyre.
Sulmojeni armikun aty ku ai s'e pret, dhe dëshmojeni para tij pikërisht atëherë kur ai s'e pret.
Këta janë faktorët kyç për fitoren e një strategu. Është e pamundur që ato të formulohen me saktësi që përpara.
Tani, nëse vlerësimet e bëra përpara betejës tregojnë fitoren e mundshme, kjo ndodh ngaqë përllogaritjet e kryera

me shumë kujdes të bëjnë të mendosh se kushtet tua janë më të favorshme se ato të armikut tuaj; kurse nëse ato tregojnë humbjen, kjo gjë ndodh për shkak se përllogaritjet e kujdesshme të shtyjnë të gjykosh se kushtet e favorshme në betejën vijuese janë më të pakta. Falë përllogaritjeve të kujdesshme, gjenerali përkatës mund të dalë ngadhënjyes; në të kundërtën, humbës. Jashtëzakonisht më pak mundësi fitoreje do të ketë ai gjeneral që nuk bën asnjë përllogaritje!
Përmes këtyre mjeteve pra, mund të parashikojmë rezultatet e një beteje.

KAPITULLI II

VEPRIMET LUFTARAKE
作戰

Gjatë operacioneve luftarake – atëherë kur nevojiten një mijë karroca lufte të shpejta me katër kuaj, një mijë karroca lufte të rënda dhe një mijë ushtarë të veshur me parzmore metalike; atëherë kur furnizimet transportohen mijëra *li*[1]; kur duhen bërë shpenzime të larta në vendin e origjinës dhe frontin e luftës, dhe kur duhen paguar njëkohësisht edhe lajmëtarët dhe këshilltarët e ndryshëm – çmimi i materialeve të ngjitësit dhe vernikut, apo edhe i karrocave dhe parzmoreve, do të rritet gjer në mijëra florinj në ditë. Njëqind mijë trupa do të jenë gati për luftë vetëm në momentin kur këto holla të jenë të disponueshme.
Një fitore e shpejtë përbën qëllimin kryesor në luftë. Nëse ajo nuk arrihet menjëherë, si rrjedhim armët topiten dhe morali i ushtarëve tulatet. Nëse trupat do të jenë duke sulmuar qytete të ndryshme, fuqia e tyre do të shterohet. Në ato raste kur ushtria u futet fushatave të stërzgjatura, si pasojë burimet financiare të shtetit do të nisin të mungojnë. Atëherë kur armët e ushtrisë suaj do të jenë topitur dhe hovi juaj do të jetë frenuar, fuqia juaj do të ketë shteruar dhe thesari juaj i shtetit do të jetë përtharë krejtësisht,

---

[1] Njësi matëse kineze e distancës, e barasvlershme me gjysmë kilometër.

drejtuesit e shteteve fqinje do të përfitojnë nga kriza juaj dhe do të vihen përnjëherë në veprim. Në një rast të tillë, askush, sado i mençur qoftë, nuk do ta ketë të mundur që t'i shmangë pasojat katastrofike që do të vijnë më pas. Në këtë mënyrë, megjithëse kemi dëgjuar për raste të shumta nxitimi të marrë në luftë, akoma nuk na ka rënë në vesh ndonjë operacion i mençur luftarak që ka zgjatur shumë. Dhe kjo ndodh për faktin se prej një lufte të tejzgjatur vështirë të ketë pasur dobi ndokush. Prandaj, ata që e kanë të pamundur t'i kuptojnë rreziqet e pandashme nga përdorimi i trupave në luftë, janë njëlloj të paaftë që të kuptojnë përparësitë lidhur me këtë gjë.
Njerëzit të cilëve u takon të drejtojnë luftën, nuk kanë nevojë për të rekrutuar një valë të dytë ushtarësh ose për të marrë dyfish furnizime. Ata i mbartin me vete pajisjet ushtarake nga atdheu, por ndërkohë furnizimet ia marrin armikut. Kështu, ushtria e tyre gëzon me shumicë furnizime ushqimore.
Kur një vend i caktuar varfërohet si pasojë e operacioneve ushtarake, kjo gjë ndodh si pasojë e shpenzimeve marramendëse për transportin; mbartja e furnizimeve nëpër distanca të largëta e varfëron tejmase popullin. Aty ku fushon ushtria, çmimet ngrihen pandalur. Atëherë kur çmimet rriten, paralelisht përthahet edhe mirëqenia e banorëve të zonës. Në momentin që mirëqenia e tyre është shteruar, banorët e ngratë do të ngarkohen me taksa të rënda dhe tejet urgjente. Si pasojë e kësaj humbjeje të mirëqenies dhe e rraskapitjes vijuese, banorët e vendit do të bëhen skajshmërisht të skamur dhe shtatë të dhjetat e pasurisë së tyre do të davariten dhe treten. Sa për shpenzimet qeveritare, ato që kanë të bëjnë me karrocat luftarake të dëmtuara, me kuajt e kapitur, me parzmoret, helmetat,

harqet dhe shigjetat, shpatat dhe mburojat, shqytat mbrojtëse, buajt për tërheqje dhe karrocat do të arrijnë gjer në 60 përqind të shpenzimeve të përgjithshme.
Kështu që, një gjeneral mendjemprehtë kujdeset që ushtarët e tij të ushqehen në kurriz të armikut, meqenëse çdo porcion ushqimor nga rezervat e armikut është i barabartë me njëzet të tilla nga rezervat ushqimore të ushtrisë së tij.
Në mënyrë që t'u ngjallet guximi ushtarëve për të ngadhënjyer mbi armikun, atyre duhet t'u rritet zemërata. Dhe duke synuar që të kapet sa më tepër plaçkë lufte nga armiku, atyre duhet dhënë shpërblimi.
Për këtë shkak, në luftimet me karroca luftarake, kur qëllohet që t'i kapen armikut më tepër se dhjetë karroca të këtilla, është e udhës që të shpërblehen përzemërsisht ata që do të kenë kapur të parët nga to. Më pas duhen zëvendësuar flamujt e armikut me këtë kapur armikut, me të tuajat, dhe duhen përzier karrocat luftarake që i keni kapur armikut, me të tuajat, duke përdorur ato për luftë. Do të ishte e kështillueshme që robërit e luftës të trajtoheshin njerëzisht, me të gjithë përkujdesjen e duhur. Kjo është ajo që quhet: "Të fitosh betejën dhe të bëhesh edhe më i fuqishëm!"
Kështu pra, ajo që ka vlerë në një betejë është fitorja dhe jo fushatat e stërzgjatura. Gjenerali që arrin të kuptojë se si t'i përdorë trupat nën komandën e vet, do të shndërrohet në një element përcaktues për fatin e popullit të tij dhe një arbitër për rrethanat e ardhshme të kombit të vet.

KAPITULLI III

STRATEGJIA SULMUESE
謀攻

Në kushte lufte, përgjithësisht, qasja më e mirë është që territorin e pushtuar ta ruash të paprekur; shkatërrimi i tij vlen më pak se opsioni i mësipërm. Kapja rob e të gjithë ushtrisë armike, përbën një gjë më të udhës sesa dërrmimi i saj i plotë; kapja gjallë e një regjimenti të tërë, një kompanie, ose një toge, është diçka më me vend sesa shpartallimi i tyre.[2] Sepse të fituarit njëqind herë në njëqind beteja nuk përbën kulmin e zotësisë. Të nënshtruarit e armikut pa qenë nevoja që të luftohet, përbën atë që cilësohet kulmi i përsosmërisë.
Kështu, ajo që ka një rëndësi madhore sa i përket luftës, ka të bëjë me të godituri e strategjisë së armikut. Veprimi i radhës lidhet me dëmtimin e aleancave të tij përmes diplomacisë. Pastaj është veprim më i keq jetësohet kur sulmohen ushtria e tij. Ndërsa qasja më e keqe jetësohet kur sulmohen qytetet. Qytetet duhen sulmuar vetëm atëherë kur të mungojë çfarëdo lloj alternative tjetër, për arsye se të përgatiturit e mburojave të mëdha dhe e mjeteve të transportit apo e mbrojtjeve të mëdha dhe e mjeteve të transportit apo e armëve të nevojshme, si dhe e pajisjeve të nevojshme për

---

[2] Regjimenti, kompania dhe toga, quhen *lu*, *zu* dhe *wu* në gjuhën kineze. Në Kinën e lashtë, pesëqind ushtarë përbënin një *lu*, njëqind formonin një *zu* dhe pesë të tillë një *wu*.

rrethana të tilla, kërkon së paku tre muaj, dhe ngritja e pirgjeve të dheut për të vendosur shkallët e rrethimit, kërkon tre muaj të tjerë plus. Një gjeneral i tillë, që nuk është i zoti ta kontrollojë padurimin e tij, do t'i urdhërojë trupat e tij që t'u aviten mureve sikur të ishin milingona, dhe si rrjedhojë një e treta e tyre do të vriten pa ia dalë mbanë që ta pushtojnë qytetin. Kjo është gjëma që ndodh kur sulmohen qytetet.

Ata që ia kanë marrë dorën artit të luftës, dinë ta mposhtin armikun pa zbritur fare në fushëbetejë. Ata arrijnë që t'i pushtojnë qytetet armike pa qenë nevoja t'ua mësyjnë atyre dhe si përfundim e përmbysin pushtetin armik pa u zgjatur në fushata rraskapitëse. Qëllimi i tyre është që të marrin gjithçka nën kontroll pa e trazuar fort ambientin, pra, të paprekur nga pikëpamja strategjike. Kështu, trupat e tyre nuk do të rraskapiten dhe përfitimet e tyre do të jenë të plota. Ky është arti i strategjisë sulmuese.

Rrjedhimisht, arti i përdorimit të trupave ushtarake, është ky: Kur jeni dhjetë me një përballë armikut, rrethojeni atë. Kur zotëroni pesëfish më tepër fuqi sesa ai, sulmojeni atë. Nëse keni dyfishin e fuqisë së tij, përçajeni atë. Nëse jeni të barabartë me të, atëherë do të mund të përballeni me të nëse keni përpiluar një plan të mirë. Nëse jeni më të dobët se ai numerikisht, del nevoja që të jeni të aftë për t'u tërhequr. Dhe nëse gjendeni në pozicion inferior në çdo këndvështrim, atëherë bëni mirë t'i shmangeni atij, sepse një ushtri e vogël në numër, shndërrohet në plaçkë të lehtë për një armik më të fuqishëm, nëse ushtarët e saj luftojnë në mënyrë të pamatur.

Tani, duhet theksuar se gjenerali mbulon një rol ndihmës për sovranin e shtetit. Nëse kjo mbështetje që ai ofron, do të jetë e largpamëse dhe gjithëpërfshirëse, atëherë vetë

shteti patjetër që do të bëhet më i fortë; por nëse do të jetë e mangët, si pasojë shteti do të dobësohet.

Pra, ekzistojnë tri mënyra përmes të cilave një sovran mund ta ndjellë të keqen mes radhëve të ushtrisë së tij:

1. Atëherë kur, duke injoruar faktin se ushtria nuk do të ishte e udhës të përparonte, ai sërish do të jepte urdhër për të përparuar, ose kur duke injoruar faktin se ushtria nuk do të duhej të tërhiqej, ai do të urdhëronte tërheqjen e trupave të veta. Ky fenomen përshkruhet si: "Çapitje e ushtrisë".
2. Atëherë kur, duke injoruar krejtësisht artin ushtarak, ata ndërhyjnë në mënyrën se si administrohen veprimet luftarake. Në këtë mënyrë vetë oficerët do të mbeten të hutuar.
3. Atëherë kur, duke injoruar thellësisht problemet që kanë të bëjnë me komandimin, ata ndërhyjnë në vendimmarrjen lidhur me luftimet. Kjo gjë shkakton dyshime të forta në mendjet e oficerëve të tyre.

Nëse ushtria ndihet e hutuar dhe plot mëdyshje, sundimtarët fqinjë do të nxjerrin përfitime nga kjo gjë dhe do të shkaktojnë probleme. Ky është kuptimi i frazës: "Një udhëheqës ushtarak i hutuar, shkakton fitoren e armikut të vet".

Por gjithsesi, ekzistojnë edhe pesë pika falë të cilave mund të parashikohet fitorja:

1. Udhëheqësi që është i ndërgjegjshëm për momentin se kur mund të luftojë dhe kur e ka të pamundur këtë gjë, do të ngadhënjejë pa dyshim.
2. Udhëheqësi që arrin të kuptojë se si do t'i duhet të luftojë varësisht nga fuqia e forcave kundërshtare, do të ngadhënjejë pa dyshim.
3. Udhëheqësi, radhët e ushtrisë së të cilit janë të përbashkuara me një synim të vetëm, do të ngadhënjejë pa dyshim.

4. Udhëheqësi që është i mirëpërgatitur dhe që qëndron në pritje të lëvizjes përkatëse të një armiku i cili nuk është mjaftueshëm i përgatitur për t'u përballur me të, do të ngadhënjejë pa dyshim.
5. Udhëheqësi, gjeneralët e të cilit janë të aftë sa ç'duhet dhe në vendimet e të cilëve sovrani nuk i fut hundët, do të ngadhënjejë pa dyshim.

   Përmes këtyre pesë mënyrave bëhet e mundur të ndriçohet rruga për te fitorja. Prandaj them: Njiheni sa më mirë armikun tuaj dhe vetveten; dhe në qindra beteja nuk do të njihni humbje. Kur nuk e njihni aspak armikun tuaj, por së paku e njihni mirë veten, shanset tuaja për të fituar apo humbur janë të barabarta. E nëse nuk e njihni armikun tuaj, e aq më pak vetveten, pashmangshmërisht do të mposhteni në çdo betejë.

KAPITULLI IV

UDHËZIME TAKTIKE
軍形

Luftëtarët e zotë, në kohët e lashta, përgatiteshin fillimisht që vetë të ishin të pamposhtur dhe pastaj prisnin momentin e duhur kur armiku i tyre ishte i cenueshëm. Sepse të qenët vetë i pathyeshëm varet kryesisht nga vetvetja, ndërsa në është armiku i cenueshëm apo jo, varet thelbësisht prej tij.
Ata që zotërojnë aftësitë e duhura në luftë, mund ta shndërrojnë veten në të pathyeshëm, por që gjithsesi nuk mund ta bëjnë armikun e tyre të cenueshëm, pa ia gjetur dot atij pikën e dobët. Për këtë arsye mund të thuhet se, dikush mund të dijë fare mirë se si të ngadhënjejë, por jo domosdoshmërisht ta bëjë vërtet këtë gjë.
Mbrojeni pra veten kur nuk ia dilni dot që ta mposhtni armikun tuaj, dhe sulmojeni armikun atëherë kur ju ofrohet mundësia për ta bërë këtë. Zakonisht mbrohemi atëherë kur forca e tij është e pamjaftueshme; ndërsa sulmojmë atëherë kur fuqia e ka të madhe. Ata që janë të zotët të mbrohen, fshihen poshtë nëntë shtresave tokësore; kurse ata që janë të zotët të sulmojnë, mësyjnë përpara sikur të zbrisnin nga parajsa nëntë-shtresash qiellore. Kështu, ata janë të aftë që njëkohësisht ta mbrojnë veten dhe të sigurojnë një fitore të plotë.
Të parashikuarit e një fitoreje të cilën edhe një njeri i

zakonshëm mund ta parashikojë, nuk përbën dot kulmin e përsosmërisë. As të triumfuarit në fushëbetejë dhe fakti se turma mund të brohorasë duke të shpallur me të madhe si “ekspert”, nuk përbën diçka të tillë, sepse të ngriturit e një gjetheje vjeshtore nga toka, nuk kërkon ndonjë mund të madh, aftësia për të bërë dallimin midis hënës dhe diellit nuk përbën ndonjë provë mençurie, të dëgjuarit e bubullimës nuk tregon dëgjim të mprehtë. Në kohët e lashta, ata që cilësoheshin si të zotët në punët e luftës, ia dilnin mbanë që ta mposhtnin armikun me lehtësi. Dhe, për këtë arsye, fitoret e këtilla të arritura falë mjeshtërisë së luftës, nuk u jepnin atyre ndonjë reputacion madhor mençurie e as ndonjë meritë për kurajë të shquar. Sepse këta njerëz i arrinin fitoret e tyre pa bërë asnjë gabim. Duke mos bërë asnjë gabim ata vinin gurin e themelit të fitoreve të tyre; sepse ata ia dilnin të mposhtnin një armik që kishte qenë i mundur qysh në krye të herës. Prandaj, një komandant i zoti, zë një pozicion të tillë në të cilin ai bëhet i pamposhtur dhe pastaj nuk le t’i shpëtojë asnjë mundësi për ta dërrmuar armikun e tij. Në këtë mënyrë, ushtri ngadhënjimtare gjithherë e kërkon betejën vetëm atëherë kur planet e komandantit të saj tregojnë se fitorja është e arritshme sipas këtyre planeve, kurse një ushtri që është e paracaktuar të jetë humbëse, vijon të luftojë me shpresën se do të arrijë të fitojë edhe pa planifikimin e duhur. Ata që janë të zotët në punët e luftës, i kultivojnë qasjet e tyre duke iu përmbajtur në mënyrë të rreptë ligjeve dhe rregullave. Kështu, arritja e suksesit qëndron brenda vullnetit të tyre.

Tani, mund të pohojmë se elementet e luftës janë së pari, matja e hapësirës; së dyti, vlerësimi i sasive; së treti, përllogaritja; së katërti, krahasimet; dhe së pesti, mundësitë për të korrur fitoren. Matjet e hapësirës lidhen

me terrenin. Sasitë lidhen me matjet, shifrat me sasitë, krahasimet me shifrat dhe vetë fitorja me krahasimet. Në këtë mënyrë, një ushtri triumfuese është si një "yi"[3] krahasuar me një kalli gruri në një peshore, ndërsa një ushtri e mposhtur është si një kalli gruri përballë një "yi-je".

Pikërisht falë mënyrës së duhur për t'i përdorur mjetet dhe mundësitë që ka në dispozicion, një gjeneral ngadhënjyes gëzon aftësinë për t'i bërë ushtarët e tij të luftojnë sipas efektit të ujërave të ndryra pas digës, që kur papritmas lëshohen, përmbytin gjithçka gjejnë përpara tyre.

[3] Një njësi matëse e lashtë kineze, përafërsisht e barabartë me 0,7 kg

KAPITULLI V

MBI SJELLJEN E USHTRISË
兵勢

Në përgjithësi, administrimi i një ushtrie të madhe nuk ka ndonjë ndryshim të veçantë nga administrimi i pak njerëzve. E gjitha ka të bëjë me organizimin. Dhe udhëheqja e një ushtrie të madhe është njëlloj si të udhëheqësh pak njerëz. Kjo ka të bëjë me formacionet dhe sinjalet përkatëse. Fakti nëse ushtria është në gjendje t'i bëjë ballë sulmit armik pa pësuar humbje, u detyrohet veprimeve të trupave me aftësi të jashtëzakonshme dhe atyre me aftësi normale. Trupat që i lëshohen përsipër armikut sikur të ishin gurë mulliri që përplasen mbi ca vezë, përbëjnë një shembull të një sulmi të fuqishëm kot së koti.
Zakonisht, në betejë, duhet përdorur forca normale për t'u përballur me armikun, dhe një fuqi e jashtëzakonshme për ta mposhtur atë. Pra, kjo do të thotë se burimet dhe energjitë e atyre që zotërojnë aftësinë për të përdorur fuqinë e jashtëzakonshme, janë gjithmonë po aq të pashtershme sa ç'janë edhe parajsa dhe thellësitë tokësore, dhe po aq të paepura sa edhe rrjedha e lumenjve të mëdhenj, sepse ato siç mbarojnë, edhe rifillojnë menjëherë – në mënyrë ciklike, ashtu si lëvizjet e diellit dhe hënës në qiell. Ato vdesin dhe rilindin përnjëherë – në mënyrë të përsëritur, siç ndodh me stinët e ndryshme. Notat muzikore janë vetëm pesë si

numër[4], por kombinimi i tyre u jep jetë melodive të panumërta, që kurrë të gjitha bashkë nuk mund t'i dëgjojmë. Ngjyrat parësore janë vetëm pesë si numër, por kombinimet mes tyre janë të pafundme, saqë e kemi krejt të pamundur që t'i përfytyrojmë dot të tëra. Shijet janë vetëm pesë si numër, por përzierjet e tyre janë aq të shumanshme, saqë e kemi të pamundur që t'i provojmë dot të gjitha. Në betejë, ekzistojnë vetëm forcat normale dhe ato të jashtëzakonshme, por kombinimet mes tyre janë të pakufishme; askush nuk është i aftë t'ua kuptojë atyre plotësisht përdorimin. Sepse këto dy forca janë anasjelltas të ringjallshme. Është sikur ato të rrotulloheshin qarkas pafundësisht. E kush vallë do të mund t'i shteronte mundësitë e tyre për t'u rikombinuar në vazhdimësi?

Kur rrëketë e rrebeshta arrijnë të flakin nga vendi një gur të madh, kjo gjë ndodh si pasojë e vrullit të momentit; kur skifteri godet me përpikmëri prenë e vet, kjo ndodh për shkak të koordinimit të mirë kohor. Kështu, vrulli i momentit të duhur, kombinuar me zotësitë e dikujt që ia ka marrë dorën artit të luftës, bëhet diçka e papërmbajtshme, ndërsa sulmi përkatës gjithmonë është i koordinuar si duhet. Fuqia e tij është si ajo e një harku të tendosur plotësisht; kurse koordinimi i tij kohor, është i njëjtë me tërheqjen e këmbëzës së armës.

Në mes të gurgulesë dhe poteres së përleshjes, beteja duket si diçka kaotike, por një udhëheqës i zoti nuk duhet të lejojë çrregullime në radhët e trupave të veta. Fushëbeteja mund të duket e turbullt dhe pre e kaosit, por rreshtimi i ushtarëve të tij duhet të jetë krejtësisht i rregullt. Kështu ky komandant nuk do të njohë kurrë humbje. Çoroditja e

---

[4] Sipas idesë kineze të kohës.

rreme ka të bëjë me rregullin e rreptë mes trupave; burracakëria e rreme, me kurajën; dobësia e rreme, me forcën. Rregulli ose çoroditja varen nga organizimi dhe udhëheqja e duhur; kurajoja ose burracakëria nga rrethanat; forca ose dobësia nga udhëzimet taktike. Kështu, një komandant i zoti në të vënit e armikut në lëvizje (sipas interesit të vet), e bën këtë gjë duke krijuar një situatë të tillë, sipas së cilës armiku do të veprojë. Ai e tërheq për hunde armikun me diçka që ai e di fort mirë se armiku e dëshiron shumë. Ai arrin ta mbajë armikun në lëvizje duke e tërhequr vazhdimisht karremin dhe pastaj i vërshon armikut me trupat e tij më të zgjedhura.

Për këtë arsye, një komandant i zoti, e kërkon fitoren përmes krijimit të situatës së duhur, duke mos pretenduar atë nga ushtarët dhe vartësit e tij. Ai përzgjedh njerëzit e përshtatshëm dhe më pas shfrytëzon situatën e duhur për qëllimet e veta. Ai që di se si ta përdorë situatën dhe rrethanat, i përdor njerëzit në përleshje, ashtu siç rrotullojmë përtokë trungjet apo gurët. Pra, natyrshëm trungjet apo gurët zakonisht rrinë në vend, kur terreni është normal; por ndërkohë, në një të tatëpjetë, ato nisin të lëvizin. Nëse terreni është i sheshtë, ato ndalojnë; nëse është i pjerrët, fillojnë të rrotullohen sërish. Pra, energjia e trupave që administrohet mjeshtërisht nga komandanti i tyre në betejë, do të mund të krahasohej me vrullin e momentit të copave të shkëmbinjve të mëdhenj që rrotullohen nëpër shpatet e maleve duke u rrëzuar me shpejtësi nga qindra metra lartësi.

KAPITULLI VI

ZBRAZËTIA DHE PLOTËSIA
虛實

Në përgjithësi, ai që zë vend i pari në fushën e betejës dhe që pastaj rri në pritje të armikut të vet, zakonisht është i qetë, dhe ai që hyn më pas në skenë, duke mësyre kështu me vërtik në përleshje, përgjithësisht është i rraskapitur. Për këtë arsye, ata që zotërojnë mjeshtërinë e luftës, e sjellin armikun pas tyre, dhe nuk e lënë veten që t'i sjellë armiku aty. Ai komandant që është i aftë ta sjellë armikun në fushëbetejë sipas interesit të vet, arrin ta bëjë këtë gjë duke i ofruar atij njëfarë përfitimi. Dhe një komandant që gëzon aftësinë për ta penguar armikun të vijë, e bën këtë duke ia pamundësuar këtë veprim. Kështu pra, kur armiku ndihet i qetë, jini të aftë ta kapitni atë, kur armiku është i mirëushqyer, jini të zotët që ta ngordhni atë urie, dhe kur ai po çlodhet, bëjeni të vihet në lëvizje.
Shfaquni në ato vende ku armiku e ka të pamundur të shpëtojë prej jush; lëvizni me shpejtësi në një drejtim të atillë, nga ku armiku kurrë nuk do ta priste që ta sulmonit.
Të marshuarit për mijëra kilometra pa ndier lodhje, ka të bëjë me faktin se duhet të udhëtoni patjetër nëpër shtigje ku nuk ka këmbë armiku. Të qenët të aftë për të arritur synimin e sulmit tuaj, lidhet pazgjidhshmërisht me faktin se ju duhet të mësyni pikërisht aty ku armiku juaj e ka të

pamundur të mbrohet prej jush. Të qenët të sigurt për të mbrojtur atë që zotëroni, ka të bëjë me faktin se ju duhet të mbroheni në një vend të atillë që armiku juaj nuk do të duhej të guxonte apo të mundej të sulmonte dot. Rrjedhimisht, armiku nuk mundet ta dijë se ku të mbrohet ndaj atyre që janë të zotët për të sulmuar, dhe kundër atyre që gëzojnë mjeshtërinë për t'u mbrojtur, armiku nuk e ka idenë se ku të sulmojë.

Mjeshtri i luftës nevojitet të jetë aq mendjemprehtë dhe i padukshëm, sa të mos lërë asnjë gjurmë pas vetes. Ai nevojitet të jetë aq hyjnisht i mistershëm, saqë të jetë bërë krejtësisht i padëgjueshëm nga ushtria armike. Pra, ai duhet ta ketë në dorë fatin e armikut të vet. Taktika e tij sulmuese do të jetë e papërmbajtshme nëse ai do të synojë pikat e dobëta të armikut të tij; dhe ai nuk do të mund ta mposhtin teksa tërhiqet, në qoftë se do të lëvizë si shigjetë. Nëse ne vendosim që ta bëjmë të zbresë në fushën e betejës armikun me mua, ngaqë unë do ta kem sulmuar në një pikë të lartë dhe hendeqe të thella, ai nuk do t'i bëjë dot bisht përballjes me mua, ngaqë unë do ta kem sulmuar në një pikë të pambrojtshme për të. Ndërsa kur unë dëshiroj që t'i shmangem betejës, unë do të mundem ta mbroj veten thjesht duke i vënë atij një kufi të pakalueshëm; kështu armiku do ta ketë të pamundur të më sulmojë për arsye se unë nuk do ta lejoj atë të godasë aty ku dëshiron.

Nëse unë do të jem i aftë që të përcaktoj lëvizjet taktike të armikut tim, ndërkohë që në të njëjtën kohë, arrij t'ia fsheh atij të miat, atëherë unë do ta gëzoj mundësinë për t'i përqendruar forcat e mia sipas dëshirës, ndërsa të tijat do të përçahen. Dhe nëse trupat e mia vijojnë të përqendrohen teksa trupat e tij përçahen, atëherë unë do të mund ta përdor tërë fuqinë time goditëse për të sulmuar një pjesë

të trupave të tij (falë përçarjes dhe fraksionimit të tyre). Pastaj, nëse unë do të kem mundësinë që të përdor shumë ushtarë të mi për të goditur pak ushtarë të tij në një pikë të caktuar, ata ushtarë të ngratë armiq që unë do të sulmoj, do të jenë krejt të pashpresë. Armiku nuk do të duhet kurrsesi që ta dijë se ku synoj unë të godas. Sepse nëse ai nuk do të jetë në dijeni të vendit ku unë dëshiron të godas, atëherë rrjedhimisht ai do të rreket të mbrohet në shumë pika të ndryshme. Dhe kur atij i duhet të mbrohet në shumë pika të ndryshme, ato syresh që unë do të godas, do të jenë fort të pakta. Sepse nëse ai do të përpiqet të përforcojë anën ballore të trupave të tij, ana e pasme do të jetë më e dobët, dhe nëse do të përpiqet të përforcojë prapavijën, atëherë pjesën ballore do ta ketë më të brishtë. Nëse ai do të përforcojë anën e majtë, anën e djathtë do ta ketë më të cenueshme, dhe nëse përforcon të djathtën, atëherë do të ketë shumë pak trupa për të mbrojtur anën e majtë. Dhe atëherë kur armikut do t'i duhet të'i shpërndajë trupat anekënd, atëherë trupat e tij do të jenë të thyeshme anekënd gjithaq. Dobësia numerike ka të bëjë me faktin se duhet të mbrohesh nga sulme të mundshme; kurse fuqia numerike lidhet me faktin nëse ia dalim mbanë që ta shtojmë armikun që t'i bëjë gjithë këto përgatitje për t'u mbrojtur nga sulmet tona.

Nëse një komandant është në dijeni të faktit se ku dhe kur do të luftohet një betejë e caktuar, atëherë trupat e tij mund të marshojnë për mijëra kilometra dhe të arrijnë plot entuziazëm në fushëbetejë. Por nëse komandanti përkatës nuk ka idenë se ku do të luftohet beteja, e as vetë ditën e betejës, atëherë ana e majtë e trupave të tij nuk do të jetë e aftë të mbrojë të djathtën dhe e djathta do ta ketë të pamundur të ndihmojë të majtën, dhe pararoja nuk do të

mundet t'i dalë Zot praparojës dhe praparoja, pararojës. Asnjë ndryshim qenësor nuk ka këtu, qoftë nëse bëhet fjalë për dhjetëra kilometra shtrirjeje të trupave në fushëbetejë, e qoftë për pak syresh! Sado që t'i vlerësoj si të shumta trupat e gjeneralit Yüe, gjithsesi, çfarë përfitimi ka njeriu nga kjo epërsi numerike në lidhje me rezultatin e luftës? Pra, unë pohoj këtu se fitorja mund të arrihet. Sepse edhe nëse armiku gëzon një epërsi numerike, unë sidoqoftë di se si t'ia pamundësoj atij përballjen me mua në fushë të hapur.

Kështu që, duhen analizuar planet armike që të jeni në dijeni të pikave të tyre të dobëta, ashtu si edhe të përparësive të tij kundrejt jush. Bëni mirë ta trazoni nga pak armikun, në mënyrë që të mësoni mënyrën dhe shtigjet e tij të lëvizjes. Mashtrojeni dhe lëshojini atij ndonjë karrem, për të mësuar lëvizjet e tij taktike dhe për të përcaktuar pozicionet e tij. Kryeni ndonjë sulm zbulues sa për të mësuar pikat ku përqendrohet fuqia e tij, dhe ato ku struken dobësitë e tij. Hapi final sa u përket lëvizjeve taktike të trupave, lidhet me kamuflimin e tyre në mënyrë të papërcaktueshme nga armiku. Pastaj, as spiunët që do të mund të kenë depërtuar më në thellësi të linjave të tua mbrojtëse, nuk do të mund të kuptojnë dot gjë, e as komandantët e tyre të mençur nuk do të bëjnë dot plane sipas lëvizjeve tua taktike. Planet për fitore përpilohen varësisht nga situata, por shumica e njerëzve nuk arrijnë ta kuptojnë dot këtë. Megjithëse shumica syresh arrin t'i shquajë shtresat e jashtme, gjithsesi askush nuk e kupton dot mënyrën sesi fitorja arrihet themelisht. Prandaj, kur një fitore tashmë është korrur, taktikat përkatëse nuk duhen përsëritur më. Një komandant i zoti është gjithmonë nevoja që t'i përgjigjet sfidës së situatave të ndryshme me anë të një pafundësie variantesh përkatëse.

Pra, një ushtri mund të krahasohet me ujin, sepse uji i

rrjedhshëm i shmanget lartësive dhe vërshon nëpër rrafshina, kështu pra edhe një ushtri duhet t'i shmanget forcës dhe të godasë dobësitë. Dhe ashtu siç uji e mëson rrjedhën e tij varësisht nga terreni ku vërshon, edhe një ushtri e administron fitoren e vet varësisht nga situata në të cilën ndodhet armiku i saj. Dhe ashtu si uji nuk ka një formë të vazhdueshme, edhe sa i përket artit të luftës, nuk ekzistojnë kushte të vazhdueshme apo të njëtrajtshme. Pra, një komandant që është i aftë të ngadhënjejë përmes përshtatjes së taktikave të tij varësisht nga situata e armikut, mund të cilësohet si një mendje hyjnore. Nga pesë elementet (uji, zjarri, metalet, druri dhe toka), asnjëri syresh nuk mbizotëron mbi të tjerët; nga katër stinët, asnjëra syresh nuk zgjat përgjithmonë; nga ditët e javës, disa syresh janë të gjata, e disa të shkurtra, por gjithnjë hëna shkëlqen dhe shuhet. E njëjta gjë vlen edhe për ligjin e përdorimit të trupave ushtarake.

KAPITULLI VII

MANOVRIMI: PËRBALLJA E DREJTPËRDREJTË DHE E TËRTHORTË
軍爭

Normalisht, në kushte lufte, gjenerali përkatës i merr urdhra e tij drejtpërdrejt nga sovrani i vet. Gjatë këtij procesi që shkon nga mbledhja e trupave te mobilizimi i popullit e gjer te përgatitja e ushtrisë si një trupë në harmoni të plotë vepruese dhe fushimi i saj, nuk ka gjë më të vështirë sesa arti i të manovruarit për të gjetur pozicione të favorshme luftimi. Gjëja e vështirë lidhur me këtë, ka të bëjë me shndërrimin e shtigjeve të tërtorta në udhë që të shpien drejtpërdrejt te synimet tua dhe e të shndërruarit të situatave të pafavorshme në përparësi në të mirën tënde. Pra, marshoni nga një shteg i tërtortë dhe devijojani udhën edhe armikut duke i lëshuar atij një karrem. Në këtë mënyrë, ju mund të niseni pas tij dhe të arrini në fushëbetejë përpara armikut. Një komandant që është i aftë ta bëjë këtë, shpërfaq qartësisht një njohje të thellë të artit të dredhisë dhe diversionit. Prandaj, qoftë përparësia, ashtu edhe rreziku kanë të bëjnë me të manovruarit për të kapur një pozicion të favorshëm. Një komandant që e vë tërë ushtrinë e tij në një marshim plot pengesa, me qëllim që të arrijë të zërë një pozicion të favorshëm, kurrë nuk do ta arrijë dot atë. Nëse

ushtria e tij e braktis fushimin dhe nuk pyet për tërë pengesat e mundshme, duke synuar arritjen e një pozicioni të favorshëm, gjithë rezervat e ushtrisë së tij do të jenë të humbura. Pra, nëse një komandant i urdhëron ushtarët e tij që të bëjnë marshime të detyruara pa qenë të pajisur me armët e tyre, pa ndalur as natën e as ditën, duke përshkuar vazhdimisht dyfishin e distancave të zakonshme, dhe duke ecur qindra kilometra për ta zënë pozicionin e favorshëm, atëherë është e mundur që komanda e ushtrisë të bjerë rob në duart e armikut. Pjesëtarët më të fortë të kësaj ushtrie do të arrijnë të parët në destinacion, ndërsa ata më të dobëtit do të heqin të zitë e ullirit në prapavijë; kështu që, nëse merret parasysh kjo metodë, vetëm një e dhjeta e ushtrisë do të arrijë në destinacion. Në një marshim të mundimshëm prej 25 kilometrash, me shumë gjasë vetë komandanti i pararojës do ta pësojë, për ndërsa gjysma e ushtrisë do të arrijë në destinacion. Në një marshim të mundimshëm prej 15 kilometrash, vetëm dy të tretat e ushtrisë do të arrijnë në destinacion. Kështu pra do ta pësojë një ushtri e pashmangshme ushtri që nuk është e pajisur siç duhet me armatime të rënda dhe të cilës i mungojnë ushqimet për kafshët e transportit, ashtu si edhe rezervat ushqimore për ushtarët.

Nëse nuk jeni në dijeni të planeve të kundërshtarëve tuaj, ju nuk duhet të hyni në aleanca me ta. Ata komandantë që nuk i njohin malet dhe pyjet, grykat e rrezikshme, kënetat dhe moçalet e terrenit armik, nuk mundën në asnjë mënyrë të marrin përsipër udhëheqjen e një marshimi ushtarak. Ata që nuk dinë të përdorin udhërrëfyes vendas, e kanë të pamundur që të sigurojnë përparësi në terren ndaj armikut. Pra, arti i luftës mbështetet te mashtrimi. Të lëvizet atëherë kur kjo gjë është me fitim dhe të krijohet larmi

në zhvillimin e situatës duke i shpërndarë dhe përqendruar sërish trupat. Kur keni ndërmarrë një fushatë, jini të shpejtë porsi era; gjatë marshimeve të ngeshme, jini të madhërishëm si një pyll i gjelbër; teksa plaçkitni dhe bastisni, jini mizorë si flakët e zjarrit; kur i bëni ballë armikut, jini të qëndrueshëm porsi vetë malet. Kur fshiheni, jini të padëpërtueshëm si qielli prapa reve; kur po lëvizni drejt armikut, bini mbi të si gjëmim rrufeje. Kur të jeni duke plaçkitur ndonjë zonë rurale, ndajini trupat tuaja. Kur të pushtoni ndonjë territor, jini të vëmendshëm që të mbroni pikat strategjike. Peshojeni mirë situatën para se të bëni ndonjë lëvizje me rëndësi kyçe. Ai komandant që e njeh si duhet dredhinë e mashtrimit, gjithmonë do t'i gëzohet fitores. Ky është pra arti i të manovruarit.

Libri i Administrimit Ushtarak thotë: "Meqenëse zëri njerëzor nuk mund të dëgjohet në fushëbetejë, atëherë përdoren tupanët dhe kambanat. Meqë trupat e kanë të pamundur që ta shohin shoku-shokun në fushëbetejë, atëherë përdoren flamujt dhe shqytat". Pra, kambanat dhe tupanët, flamujt dhe shqytat feudale përdoren për t'i bërë më të njëtrajtshme veprimet e trupave në fushëbetejë. Dhe atëherë kur trupat arrijnë të kenë një kohezion të këtillë, ata më trimat syresh nuk kanë përse të përparojnë të vetmuar, dhe burracakët nuk kanë guxim të tërhiqen. Ky pra, është arti i udhëheqjes së një mase të madhe trupash në fushëbetejë. Sa u përket luftimeve natore, nevojiten të përdoren shumë pishtarë dhe tupanë, kurse në luftime më kushte dite, shumë flamuj dhe shqyta, në mënyrë që të udhëhiqet shikimi dhe dëgjimi i ushtarëve tanë.

Pra, një ushtrie mund t'i zhvatet shpirti i saj luftarak dhe komandantit të saj vetëbesimi. Në fillim të një fushate ushtarake, shpirti luftarak i ushtarëve është në nivelin e

duhur; por pas njëfarë periudhe kohore, ata ligështohen, dhe në një fazë të mëvonshme mendimet e tyre fluturojnë drejt shtëpisë. Dhe për këtë arsye, ata që ia kanë marrë dorën artit të luftës, bëjnë të pamundurën që t'i shmangen armikut kur shpirti i tij luftarak është akoma i përflakur, dhe e sulmojnë atë kur e ka zënë amullia dhe kur ushtarët e tij i ka kapur malli për vendlindjen. Në këtë mënyrë kontrollohet faktori moral. Duke i shtrënguar radhët pra, ata rrinë në pritje të një armiku të padisiplinuar; me shpirtin në paqe, ata presin të përballen me një armik të zhurmshëm. Kështu pra kontrollohet faktori moral. Të gjendur vetë pranë fushës së betejës, ata rrinë në pritje të një armiku që vjen nga larg; teksa vetë çlodhen, ata presin një armik të rraskapitur; me trupat e tyre të mirëushqyera, ata presin përballjen me një armik të uritur. Ky pra është kontrolli i faktorit fizik. Ata nuk përballen me një armik që përparon në mënyrë të rregullt dhe formacionet luftarake të të cilit janë grupuar siç duhet. Ky pra është kontrolli i faktorit të rrethanave të ndryshueshme.

Prandaj, arti i përdorimit të trupave ka të bëjë me faktin se kur armiku ka zënë pozicion mbi një kodër, nuk duhet të përballesh me të mbi kodër, dhe nëndrejtë, kur prapavija e tij qëndron e sigurt nëpër kodra, atëherë armiku nuk duhet sulmuar në mënyrë ballore. Kur armiku mëton të largohet, mos e ndiqni atë. Mos sulmoni trupat armike që e kanë shpirtin të përflakur nga ethet e luftës. Mos e hani karremin e armikut. Mos ia zini rrugën armikut që po kthehet për në vendlindje.

Lërini gjithherë një shteg nga t'ia mbathë armikut të rrethuar, si dhe mos i bini me tepri në qafë një armiku të dëshpëruar. Ky pra është arti i përdorimit të trupave.

KAPITULLI VIII

NËNTË NDRYSHORET
九變

Përgjithësisht, sistemi i përdorimit të trupave, zhvillohet sipas kësaj mënyre: komandanti merr mandat nga sovrani i tij për të mobilizuar popullin dhe për të mbledhur ushtrinë.
Pastaj, nuk duhet ta ngrini fushimin nëpër zona të vështira për t'u arritur. Duhet gjithaq të bashkoheni me aleatët tuaj nëpër zona që janë të ndërlidhura me udhë të ndryshme strategjike. Dhe mos rrini kot së koti të sorollateni nëpër djerrina pa nevojë. Nëse bëhet fjalë për një terren të mbyllur, mbështetuni te ndonjë manovër e mençur. Nëse ndodheni në një terren vdekjeprurës, atëherë përleshuni sikur të ishte dita juaj e fundit në jetë.
Ekzistojnë disa rrugë që duhen përshkuar, disa trupa të cilat nuk duhen sulmuar, disa lloj qytetesh mbi të cilat nuk duhet mësymë, dhe disa toka që është më e udhës të mos provohet të pushtohen. Por gjithashtu ka edhe raste përkatëse kur nuk duhen ndjekur me përpikmëri urdhrat e sovranit tuaj. Prandaj, një gjeneral që i njeh thellësisht përfitimet që vijnë si pasojë e nëntë faktorëve të ndryshueshëm, fare mirë di edhe se si t'i udhëheqë trupat e veta. Ndërsa një gjeneral që i këtillë që nuk arrin të kuptojë përparësitë që këta faktorë sjellin, rrjedhimisht nuk do të jetë i aftë ta përdorë terrenin në dobi të tij, sado që mund ta njohë

atë fort mirë. Sa i përket drejtimit të operacioneve ushtarake, ai komandant që nuk arrin t'i kuptojë taktikat e përshtatshme për nëntë situatat e ndryshueshme, do ta ketë të pamundur t'i përdorë në mënyrë efikase trupat e tij, edhe në qoftë se do t'i ketë mirë parasysh "pesë përparësitë"[5].

Dhe pikërisht për këtë arsye, një gjeneral që i merr me urtësinë e duhur vendimet e tij, duhet patjetër të konsiderojë njëkohësisht faktorët e favorshëm dhe ata të pafavorshëm. Duke i marrë parasysh faktorët e favorshëm, ai arrin ta bëjë të realizueshëm planin e tij; ndërsa duke marrë parasysh faktorët e pafavorshëm, ai do të jetë në gjendje të shmangë ndonjë katastrofë të mundshme.

Ai komandant që dëshiron që të nënshtrojë udhëheqësit e vendeve fqinje, e bën këtë duke u shkaktuar atyre sa më tepër dëme. Ai që synon t'i kontrollojë ata, e bën këtë duke i mbajtur ata nën pushtim vazhdimisht, dhe ai që ka për qëllim që t'i bëjë ata për vete, e realizon këtë duke u ofruar atyre përfitime të rreme.

Një doktrinë e mirëfilltë e luftës thotë se është më e udhës të mbështetesh te gatishmëria jote për t'u përballur me armikun, më mirë sesa të hamendësosh se mos vallë kundërshtari nuk do të zbresë në fushëbetejë për t'u përleshur me ty; dhe po ashtu, të mos supozosh se armiku nuk do të të sulmojë, por të bësh të pamundurën që ta kesh shndërruar ushtrinë tënde në të pathyeshme.

Ekzistojnë pesë cilësi që janë fatale sa i përket karakterit të një gjenerali: nëse ai është i pamatur, ai do të vritet; nëse është burracak, ai do të bjerë rob; nëse i merr vendimet pa u menduar mirë, ai do të bjerë lehtësisht pre e provokimeve armike dhe do të marrë vendime mendjelehta; nëse e ka

---

[5] Bëhet fjalë për pesë situatat e përmendura në fillimin e këtij paragrafi.

sensin e humorit tepër të brishtë, atë do të mund ta fyejnë fare lehtë; nëse ka një shpirt shumë të mëshirshëm, atëherë mund t'i bien fort në qafë.

Pra, këto pesë karakteristika përbëjnë pesë meta shumë serioze te një gjeneral, dhe kur vjen puna për operacione ushtarake, ato janë fatzeza. Rrënimi i ushtrisë dhe vdekja e vetë gjeneralëve bëhen kështu të pashmangshme, si pasojë e këtyre të metave. Prandaj ato duhen analizuar me kujdes.

KAPITULLI IX

NË MARSHIM
行軍

Kur një ushtri zë një pozicion dhe përballet me armikun, ajo duhet të vëzhgojë dhe hulumtojë situatën e kundërshtarit. Duke e bërë këtë, gjithsesi duhet kushtuar vëmendje si vijon:
Kur jeni duke kaluar nëpër male, kujdesuni që të ecni nëpër lugina; kur ngrini fushimin, zgjidhni me kujdes një terren që shikon nga ana që rrihet nga rrezet e diellit; kur terreni i ngritur është i zënë nga armiku, mos u kacavirrni për ta sulmuar atë. Kaq pra, sa i përket të zënit të një pozicioni në male.
Pasi të keni kaluar një lumë, duhet të largoheni cazë prej tij. Kur një armik në përparim e sipër kalon nëpër lumë, mos u përballni me të në mes të rrjedhës. Më e udhës është që të lejoni më parë gjysmën e trupave të tij që të dalin në breg, dhe pastaj të sulmoni. Nëse dëshironi të përlesheni me të, mos u përballni me armikun pranë ujit. Zini një pozicion në terren të ngritur përballë diellit. Mos zini pozicion diku poshtë, aty ku armiku mund t'ju godasë më lehtë. Kaq pra, sa i përket të pozicionuarit pranë lumit.
Kalojini me shpejtësi lagunat. Mos humbni kohë brenda tyre. Nëse e hasni armikun në mes të një lagune, atëherë duhet të zini një pozicion pranë barishteve ujore, me pemët

prapa jush. Kjo gjë ka të bëjë pra, me të zënit e një pozicioni në laguna.

Në një terren të sheshtë, zini një pozicion që jua lehtëson veprimet. Me ndonjë lartësi prapa dhe në të djathtën tuaj, fushëbetejën do ta keni në anën ballore dhe prapavijën të sigurt. Kështu pra, zihet pozicion në terren të sheshtë.

Përgjithësisht, këto janë disa parime avantazhuese sa i përket fushimit në të katërta situatat e lartpërmendura. Duke i përdorur ato si duhet, Perandori i Verdhë ia kishte dalë mbanë që t'i mposhte të katër sovranët e tij fqinjë[6].

Në fushëbetejë, të gjitha ushtritë parapëlqejnë terrenin e ngritur krahasuar me atë të ulëtin, dhe vendet me diell, në vend të atyre ku bie hija. Nëse ndonjë ushtri arrin të zërë pozicion në një terren të ngritur, ku mund të jetohet dhe fushohet mirë, atëherë trupat e saj nuk do të vuajnë nga sëmundje të panumërta, dhe kjo gjë do të parathotë fitoren pasuese. Kur hasni kodra, sfrate apo argjinatura, atëherë ju duhet të zini një pozicion nga ana e rrahur nga dielli. Këto janë të tëra metoda avantazhuese, të fituara falë ndihmës që ofron vetë terreni. Kur nis të bjerë shi në rrjedhën e sipërme të lumit dhe uji shkumëzues zbret i rrëmbyer, ata që duan të përparojnë, duhet të presin gjersa uji të jetë qetësuar. Aty ku ka përrenj të rrëmbyer, atëherë duhet të marshoni me shpejtësi sa më larg tyre. Mos ju aproni atyre askurrë. Rrijuni atyre sa më larg dhe çojeni armikun drejt tyre. Qëndroni përballë me to dhe shtyjeni armikun që të jetë me kurriz ndaj tyre. Kur, në krahët e ushtrisë, ka ndonjë grykë ose kënetë të mbuluar me barishte ujore ku rriten kallama dhe xunkthe, ose ndonjë mal me pyje plot me gëmusha të dendura, atëherë ju nevojitet të rrini syhaqur,

---

[6] Legjenda thotë se Perandori i Verdhë ishte perandori më i lashtë i Kinës; ai kishte mbretëruar rreth pesë mijë vite më parë.

sepse të tilla vende gëlojnë nga kurthet dhe aty fshihen spiunët armiq.

Kur armiku ndodhet në afërsi, por sërish rri i qetë, atëherë kjo do të thotë se ai ka zënë një pozicion të favorshëm. Kur ai ju sfidon në betejë së largu, kjo domethënë se ai dëshiron që me mashtrim t'ju bëjë të përparoni. Kur pemët duken sikur lëvizin, atëherë do të thotë se armiku po përparon. Kur shumë rrjeta janë shtruar përtokë, kjo gjë ka qëllim t'ju mashtrojë. Zogjtë që ngrihen në fluturim përbëjnë një shenjë se armiku ka zënë pritë; kur kafshët e egra tremben dhe ia mbathin, atëherë armiku po rreket t'ju kapë të papërgatitur.

Pluhuri që ngrihet nga toka me shtëllunga tregon se po afrohen karroca luftimi. Kur pluhuri nuk ngrihet shumë dhe është i përhapur ngado, kjo gjë tregon se po afrohet këmbësoria. Kur pluhuri ngrihet në zona të ndryshme, kjo tregon se armiku po mbledh dhe sjell në kampin e tij drutë e zjarrit; kur ka shtëllunga të herëpashershme pluhuri, kjo tregon se po ngrihet fushimi. Kur lajmëtarët ushtarakë flasin me një gjuhë të përulur, por ndërkaq ushtria vijon të përgatitet, kjo tregon se ata do të vazhdojnë të përparojnë. Kur gjuha e tyre është e ashpër dhe kur ndërkaq armiku përparon në mënyrë shumë sfiduese, kjo gjë mund të dojë të thotë se në të vërtetë armiku do të tërhiqet. Kur karrocat e lehta të luftës shkojnë të zënë pozicion në krahët e ushtrisë, atëherë domethënë se armiku po radhitet në formacion luftimi. Kur pa ndonjë marrëveshje të mëparshme, armiku kërkon armëpushim, kjo do të thotë se po komploton kundër jush. Kur trupat e tij marshojnë me shpejtësi dhe ai duket sikur i nxjerr në paradë karrocat e tij të luftës, atëherë domethënë se ai pret të takohet me përforcimet e veta. Kur gjysma e trupave të tij përparojnë dhe gjysma

tjetër tërhiqen, ai po përpiqet të hedhë karremin. Kur trupat e tij mbështeten tek armët e tyre, kjo do të thotë se ata janë të uritur. Kur kazanët me ujë thahen pa arritur akoma në fushim, kjo do të thotë se ata po vuajnë nga etja. Kur armiku juaj pikas një përfitim të mundshëm, por gjithsesi nuk përparon për t'iu gëzuar atij, kjo domethënë se ai është i lodhur. Kur zogjtë mblidhen në tufa mbi fushimin armik, do të thotë se fushimi është i zbrazur. Kur gjatë natës kampi armik është plot zhurma, domethënë se aty mbretëron ankthi.

Kur mes trupave të tij mbretëron rrëmuja, atëherë gjenerali i tyre nuk gëzon asnjë prestigj mes ushtarëve të vet. Kur flamujt dhe shqytat e armikut sorollaten andej-këtej, kjo do të thotë se armikun e ka zënë hutimi. Nëse oficerët e armikut janë të paduruar, kjo tregon rraskapitjen e tyre. Atëherë kur armiku i ushqen kuajt me grurë dhe dher dhe barëtitë e veta për t'u ushqyer, si dhe kur trupat e tij nuk i varin për t'u tharë poçat e tyre të gatimit, e as kthehen në çadrat e tyre, domethënë se armiku është i dëshpëruar. Kur trupat armike vazhdimisht mblidhen në grupe të vogla dhe pëshpërisin së bashku, atëherë gjenerali i tyre e ka humbur tërësisht besimin e ushtrisë së vet. Shpërblimet tejet të shpeshta tregojnë se gjeneralit po i shterojnë burimet; ndëshkimet e shpeshta dhe të tepruara, tregojnë se atë e ka zënë një ankth i therës. Nëse oficerët si fillim i trajtojnë dhunshëm ushtarët e tyre dhe pastaj u druhen atyre, kjo gjë shpërfaq një mungesë madhore inteligjence. Kur trupat armike marshojnë të murrëtyera dhe, megjithëse të ndodhura përballë ushtrisë sate, përleshen për një kohë të gjatë, e as largohen, atëherë situata në fjalë kërkon një syçelësi të lartë dhe hulumtime në detaje.

Në kushte lufte, numrat në vetvete, nuk të japin ndonjë

avantazh kushedi se çfarë. Mjafton që mos t'i futeni marshimit duke u mbështetur thjesht te fuqia juaj ushtarake. Nëse vlerësoni si duhet situatën në të cilën ndodhet armiku dhe më pas të përqendroheni te fuqia që ju nevojitet për ta mposhtur armikun, atëherë mjafton kjo për të dalë faqebardhë. Ai komandant të cilit i mungon largpamësia dhe që nënvlerëson armikun, pashmangshëm do të bjerë rob i këtij të fundit.

Nëse trupat ndëshkohen përpara se besnikëria e tyre të jetë siguruar, atëherë ato do të jenë të pabindura. Nëse do të jenë të pabindura, atëherë bëhet e vështirë të përdoren në fushëbetejë, në qoftë se trupat janë lidhur me ty si komandant, por ndërkaq disciplina e tyre nuk është në nivelin e duhur, sërish do ta keni të pamundur t'i përdorni ato. Pra, komandojini ato në mënyrë të njerëzishme, por njëkohësisht mbajini nën kontroll me një disiplinë të hekurt, dhe pastaj mund të pohohet se fitorja është e sigurt. Nëse urdhërat do t'u përçohen rregullisht trupave për t'i udhëzuar ato, atëherë trupat do t'ju binden pa një, pa dy. Nëse urdhërat nuk do të përçohen rregullisht për t'i udhëzuar ato, atëherë trupat do të tregohen të pabindura.

Nëse urdhërat do të përçohen rregullisht në mënyrë të besueshme, kjo gjë dëshmon se marrëdhënia midis komandantit dhe trupave të tij është në nivel të kënaqshëm.

KAPITULLI X

TERRENI
地形

Terreni i luftimit mund të klasifikohet varësisht nga natyra e tij, pra si i depërtueshëm, si i koklavitur, neutral, i thiktë, i largët, ose me gryka të ngushta. Terreni të cilin si ne, ashtu si edhe armiku, mund ta përshkojmë lehtësisht, quhet i depërtueshëm. Në një terren të këtillë, ai që ia del mbanë të sigurojë një pozicion të ngritur dhe të rrahur nga dielli, dhe që i ruan shtigjet e tij të furnizimit të papenguara, rrjedhimisht mund të luftojë me të gjitha përparësitë përkatëse. Terreni që është i lehtë për t'u arritur, por i vështirë për t'u larguar prej tij, cilësohet si i koklavitur. Natyra e këtij lloj terreni është e atillë që nëse armiku është i papërgatitur dhe nëse ju befas sulmoni, atëherë mund ta mposhtni atë. Në qoftë se armiku është i përgatitur dhe ju mësyni drejt tij, por nuk fitoni dot, dhe ndërkaq e keni të vështirë ta godisni atë sërish, kjo gjë mund të rezultojë aspak avantazhuese për ju. Terreni që është njëlloj i pafavorshëm për të depërtuar, si për ju, ashtu edhe për armikun, quhet neutral. Natyra e këtij terreni është e atillë që sado që armiku ta hajë karremin tuaj, ju sërish nuk do të përparoni për ta goditur, por do të vijoni ta joshni drejt jush duke vazhduar t'i bëni bisht atij. Kur ta keni tërhequr drejt jush gjysmën e

ushtrisë së vet armikut, atëherë mund ta godisni atë sipas kushteve më të favorshme për ju. Nëse ia dilni të kontrolloni grykat e ngushta, atëherë duhet t'i bllokoni ato dhe të rrini në pritje të armikut. Nëse armiku i zë i pari këto gryka dhe i bllokon ato, atëherë nuk duhet kurrsesi ta sulmoni atë; nëse ai nuk i bllokon ato tërësisht, atëherë mund ta sulmoni armikun. Sa i përket terrenit të thiktë, aty ju nevojitet të zini një pozicion në lartësitë që rrihen nga dielli dhe të prisni armikun. Nëse armiku arrin t'i zërë i pari lartësitë e tilla, ju duhet të largoheni; pra mos ta sulmoni atë. Kur ndodheni larg një armiku me forca të barabarta me ju, ju e keni të vështirë të shkaktoni përleshje dhe e keni të pafavorshme të përballeni me të.

Këto janë pra parimet që kanë të bëjnë me gjashtë llojet e ndryshme të terrenit. Përgjegjësia më e lartë e gjeneralit përkatës, lidhet me hulumtuarit e imtësishëm për to.

Ekzistojnë gjashtë kushte në të cilat trupat mund të dështojnë në misionin e tyre. Ato janë: ikja nga sytë këmbët nga fushëbeteja, mosbindja, kolapsi i rrëmuajshëm, ankthi, çorganizimi dhe shpartallimi. Asnjëra prej këtyre katastrofave nuk mund t'u vmishet shkaqeve të natyrshme, por vetëm mangësive të gjeneralëve përkatës.

Po t'i vlerësojmë si të barabarta kushtet e tjera, nëse një formacion ushtarak sulmon një formacion armik dhjetë herë më të madh në numër, atëherë rezultati më i natyrshëm është largimi nga sytë këmbët i pjesëtarëve të tij. Kur ushtarët janë të vendosur dhe oficerët e tyre të dobët, atëherë ushtria bie pre e mosbindjes. Kur oficerët janë të guximshëm dhe ushtarët të pazotë, rezultati është kolapsi total. Kur oficerët janë nervozë dhe të parregullt, dhe në të përballurit me armikun ata mësyjnë në fushëbetejë pa zotëruar asnjë

njohuri përkatëse lidhur me përleshjet e këtilla, si dhe pa duruar sa të marrin urdhërat e nevojshme nga komandanti i tyre, atëherë ushtrinë do ta kapë ankthi dhe paniku. Kur gjenerali përkatës është i dobët moralisht dhe nuk gëzon asnjë autoritet, kur udhëzimet dhe udhëheqja e tij nuk janë tepër të mençura, kur nuk zbatohen rregullat e rrepta për të drejtuar në fushëbetejë oficerët dhe trupat e tij, si dhe kur formacionet luftarake janë vendosur në mënyrë të çregullt, atëherë gjithçka do të bjerë pre e çorganizimit tëtërësor. Kur një komandant i cili është i paaftë të vlerësojë fuqinë e armikut të tij, përdor një forcë të vogël për t'u përballur me një kundërshtar të madh në numër, ose trupa të dobëta për t'u përleshur me një armik të fuqishëm, ose kur ai nuk ia del mbanë të përzgjedhë siç duhet një skuadër goditëse për trupat e pararojës, rezultati i pashmangshëm është shpartallimi. Kur mbizotëron njëra prej këtyre gjashtë kushteve, atëherë ushtria i është futur udhës së humbjes. Është pra, përgjegjësia më e lartë e një komandanti, shqyrtimi i imtësishëm i tyre.

Struktura e terrenit është diçka fort e nevojshme për t'u njohur në kushte lufte. Prandaj, virtytet e një komandanti mendjemprehtë kanë të bëjnë pikërisht me vlerësimin e situatës së armikut të vet, si dhe me përllogaritjen e distancave dhe shkallën e vështirësisë së terrenit përkatës, në mënyrë që të mund të sigurohet fitorja. Ai komandant që lufton duke zotëruar njohuri të plota të këtyre faktorëve, e ka fitoren e sigurt; ndërsa ai që nuk i zotëron ato, pa dyshim që do të mposhtet. Nëse situata tregon se fitorja është e mundur, por ndërkaq sovrani ka dhënë urdhër të mos zbritet në fushëbetejë, gjithsesi gjenerali përkatës mund të vendosë të luftojë. Nëse situata tregon se fitorja është e

pamundur, por ndërkohë sovrani ka dhënë urdhër që të nisë beteja, gjenerali nuk duhet ta bëjë këtë. Dhe kështu pra, gjenerali që në përparim e sipër nuk po synon lavdinë personale, dhe në tërheqje e sipër, nuk i intereson asfare turpërimi i tij personal, por synimi i vetëm i të cilit është që të mbrojë atdheun e vet dhe t'i jetësojë sa më mirë interesat e sovranit të tij, ai pra, përbën një gur vërtet të çmuar për popullin e vet. Një gjeneral duhet t'i shikojë ushtarët e tij si fëmijët e vet, me të cilët ai do të marshojë gjer në skajet më të largëta. Ai duhet t'i trajtojë ata si bijtë e tij më të dashur, dhe pastaj ata do t'i qëndrojnë besnikë gjer në vdekje. Nëse një gjeneral ua plotëson gjithë dëshirat ushtarëve të vet, por nuk di se si t'i përdorë ata, nëse ai i do ata me gjithë shpirt, por e ka të pamundur t'i bëjë të zbatueshme urdhërat e tij, nëse ushtarët janë të çregullt dhe ai nuk mundet t'i kontrollojë dot, atëherë këtë të fundit mund të krahasohen fare mirë me çiliminjtë e përkëdhelur, dhe kështu janë krejt të padobishëm.

Nëse unë jam në dijeni të faktit se trupat e mia janë të afta ta godasin armikun, por ndërkaq nuk e di se ai është i pacenueshëm nga sulmi im, atëherë mundësitë e mia për të korrur fitore janë të përgjysmuara. Nëse unë jam i ndërgjegjshëm për faktin se armiku im mund të cenohet nga sulmi im, por ndërkohë e injoroj faktin se trupat e mia nuk janë të afta ta sulmojnë atë suksesshëm, atëherë mundësitë e mia për fitore përgjysmohen. Nëse unë e njoh faktin se armiku mund të sulmohet dhe njëkohësisht se trupat e mia janë të afta ta sulmojnë atë me sukses, por ndërkaq nuk arrij ta kuptoj faktin se struktura e terrenit e bën të pamundur përleshjen, mundësitë e mia për fitore përgjysmohen. Prandaj, kur komandantët me përvojë në beteja

vihen në lëvizje, ata kurrë nuk janë të hutuar; kur ata veprojnë, ata gëzojnë burime të pakufishme. Dhe për këtë arsye, unë pohoj: Njiheni në tërësi armikun, njiheni gjithashtu edhe vetveten; fitorja juaj kështu kurrë nuk do të vihet në rrezik. Njiheni terrenin, njihni edhe kushtet atmosferike; kështu fitorja juaj pastaj do të bëhet e plotë.

KAPITULLI XI

NËNTË TERRENET E NDRYSHME
九地

Lidhur me përdorimin e trupave, terreni mund të klasifikohet si shpërndarës, kufitar, kyç, i hapur, udhëkryq, rrezikshëm, i vështirë, i rrethuar dhe dëshpërues.
Kur një fisnik feudal lufton në territorin e vet, atëherë ai gjendet në një territor shpërndarës, sepse kur ushtarët e tij luftojnë jo shumë larg shtëpive të tyre, ata mund të shpërndahen me lehtësi sipas nevojës. Kur ai bën qoftë edhe një depërtim të vogël në territorin armik, ky quhet territor kufitar. Territori që është njëlloj i favorshëm për t'u pushtuar si nga ai, si nga armiku, cilësohet si territor kyç. Territori që është njëlloj i depërtueshëm për ty dhe armikun, quhet i hapur. Kur një territor është i mbyllur nga të qenët i kufizuar me tri shtete të tjera dhe kur ti je i pari që mundëson një qasje të lirë brenda tij, atëherë terreni në fjalë quhet si udhëkryq. Territori udhëkryq është ai ku puqen rrugët kryesore të komunikimit, duke u bashkuar njëra me tjetrën: ai që arrin ta vërë këtë lloj territori nën kontroll, pastaj do të sigurojë mbështetjen e tërë vendeve fqinje. Kur ushtria jote ka përparuar thellë në territor armik, duke lënë shumë mbrapa qytetet dhe qytezat armike, atëherë ky territor quhet si i rrezikshëm. Kur ushtria jote përshkon male, pyje, ose shpate të thikta, duke marshuar përmes grykave

të ngushta, moçalishteve ose kënetave, ose çfarëdolloj terreni të koklavitur, atëherë ky quhet territor i vështirë. Ai terren ku është e vështirë të depërtohet, dhe nga i cili është e komplikuar të largohesh, si dhe ku një forcë e vogël armike mund të godasë lehtësisht një forcë më të madhe në numër, quhet territor i rrethuar. Ai terren në të cilin ushtria ia del të mbijetojë vetëm nëse lufton me kurajën e dëshpërimit, quhet rrjedhimisht si dëshpërues. Dhe prandaj, mos shkoni të luftoni në një territor shpërndarës; dhe mos ndaloni nëpër territore kufitare.

Mos sulmoni një armik që ka zënë para jush një territor kyç; ndërsa në terren të hapur, mos i lejoni formacionet tuaja që të ndahen mes tyre dhe komunikimin tuaj me to që të ndërpritet. Sa i përket territorit udhëkryq, bëni aleanca me vendet fqinje; lidhur me territorin e rrezikshëm, mblidhni shpejt ushtarët tuaj dhe plaçkitni ç'të mundeni. Në një terren të vështirë, vijoni të marshoni përpara; në një terren të rrethuar, thurni plane të zgjuara; në një territor dëshpërues, luftoni me guxim.

Në kohët e lashta, ata njerëz që përshkruheshin si të zotët në punët e luftës, ia pamundësonin armikut të tyre rastin që të bashkonte pararojën dhe prapavijën, ua pengonin bashkëpunimin divizioneve të tij, qofshin ato të mëdhaja apo të vogla, duke i penguar gjithhaq trupat e tij më të fuqishme, për t'u ardhur në ndihmë atyre më të dobëta, dhe kontaktet midis oficerëve dhe ushtarëve armiq. Kur forcat armike shpërndaheshin rrëmujshëm, ata nuk i lejonin më që të ribashkoheshin sërish; dhe qoftë edhe kur arrinin ta bënin bashkëkohësin, ata sërish shkaktonin përçarje mes tyre. Ata i mblidhnin forcat e tyre ushtarake dhe viheshin në lëvizje vetëm kur kushtet qenë të favorshme; ndërsa kur nuk ishin të këtilla, ata rrinin në vend. Nëse ndokush do të pyeste: "Si

të përballem me një ushtri të mirë-organizuar që bëhet gati të më sulmojë?" Kështu pra, unë do të përgjigjesha: "Vër duart mbi diçka që ai e ka fort përzemër, dhe pastaj armiku do t'u përkulet tërë kërkesave të tua." Thelbi i luftës ka të bëjë me shpejtësinë. Përfitoni nga mospërgatitja e armikut tuaj, përparoni nëpër shtigje nga ku ai s'pret që të vini, si dhe sulmojeni aty ku nuk marrë masa të mbrohet nga ju.

Parimet e përgjithshme të zbatueshme nga një fuqi pushtuese kanë të bëjnë me faktin se kur ju keni depërtuar thellë në territor armik, atëherë ushtria juaj është e bashkuar dhe armiku nuk mundet dot t'ju mposhtë. Plaçkiteni me shumicë territorin e lulëzuar dhe sigurojini ushtrisë suaj rezerva të shumta ushqimore. Mbajeni gjithnjë parasysh nevojën e mirë-ushqimit të trupave tuaja; mos i rraskapitni ata së koti. Bashkojini ata rreth një synimi të vetëm; mësoni ta ruani për momentin e duhur forcën e tyre goditëse. Përpiloni plane të pazbulueshme nga armiku juaj lidhur me lëvizjen e trupave. Pastaj edhe nëse i urdhëroni ushtarët tuaj të zënë një pozicion nga i cili nuk kanë më shpëtim, ata sërish në betejë, nuk ka gjë që ata ta kenë të pamundur për të arritur! Pastaj, bashkërisht, oficerët dhe ushtarët do të bëjnë përpjekje titanike për të arritur qëllimin. Në një situatë të dëshpëruar, ata nuk do t'i tremben asgjëje; kur të mos ketë më rrugë shpëtimi, ata sërish nuk do të tuten. Thellë brenda territorit armik, ata do të qëndrojnë të bashkuar si një trup i vetëm, dhe aty ku nuk ekziston asgjë tjetër si mundësi, ata do të përballen me armikun trup më trup. Pra, të tillave trupa nuk ka përse t'u thuhet të jenë të vëmendshme. Gjenerali i tyre nuk e ka aspak të nevojshme që t'ua vjelë me dhunë mbështetjen atyre, sepse e gëzon atë

krejt natyrshëm; pa qenë nevoja ta blejë dashurinë e tyre, ai e fiton atë po kaq natyrshëm; pa qenë nevoja ta pretendojë disiplinën e tyre të plotë, ai e përfton atë sërish natyrshëm. Si t'ia kesh dalë mbanë të frenosh mëdyshjet besytne dhe të shmangësh thashethemet, pastaj askush nuk do t'ia mbathë, qoftë edhe kur të përballet me vdekjen. Oficerët e mi nuk kanë pasuri me tepri, por kjo nuk ndodh si pasojë e faktit se e përçmojnë atë; ata nuk presin të jetojnë gjatë, por kjo nuk ndodh ngaqë duan të nisë marshimin, lotët e ushtarëve, këmbësorëve apo kalorësish, ua lagin shamitë dhe u rrjedhin rrëke nëpër faqe. Por si t'i keni vërvitur në një situatë ku mos të kenë nga t'ia mbajnë, dhe do të shikoni se do të sillen me kurajën e pavdekshme të Zhuan Zhusë dhe Cao Kueit[7].

Pra, trupat e atyre që ia njohin sekretet artit të luftës, përdoren si një "gjarpër që reagon në mënyrë të njëkohëshme". Kur goditet në kokë, sulmon bishti i tij; kur e godasin në bisht, sulmon koka e tij; kur e godasin në qendër të trupit, sulmojnë njëkohësisht edhe koka edhe bishti. Nëse ndokush do të pyeste: "A është vallë e mundur që trupat të bëhen menjëherë të koordinuara?" unë do të përgjigjesha se është e mundur. Sepse, megjithëse ushtarët e Wu-së dhe Yüeh-ut e urrejnë njëri-tjetrin, po të ndodheshin bashku brenda një anijeje që e shkund era dhe valët, ata do të bashkëpunonin, ashtu siç bën dora e djathtë me të majtën. Pra, me qëllim që mos të lejohet që ushtarët t'ia mbathin nga fushëbeteja, nuk mjafton që t'i mbështesim shpresat te kuajt e çalë apo te rrotat e thyera të karroca të

---

[7] Zhuan Zhu dhe Cao Kuei, kishin jetuar të dy në periudhat e Pranverës dhe Vjeshtës, dhe tregohej për ta si luftëtarë të patrembur përballë vdekjes.

luftës. Të arriturit e një niveli të njëtrajtshëm vlerash morale, varet nga një administrim i përshtatshëm ushtarak. Dhe falë përdorimit të duhur të vetë terrenit, të forcave më të fuqishme dhe më të dobëta të ushtrisë suaj, atëherë do të sigurohen avantazhet më të dukshme. Pra, një gjeneral i zoti e drejton ushtrinë e tij sikur të ishte duke udhëhequr një njeri të vetëm, dashur pa dashur, e merr atë përdore. I takon gjeneralit që të jetë i kthjellët dhe i padepërtueshëm në mendimet e veta, i paanshëm dhe i vetëpërmbajtur. Ai duhet të jetë i aftë që mos t'ua bënte të ditur oficerëve dhe ushtarëve të vet planet e tij. Ai do të duhej t'i ndryshonte metodat e veta dhe t'i modifikonte planet e tij në mënyrë të atillë që askush të mos mundej t'i kuptonte qëllimet e tij. Ai do të duhej t'i ndryshonte fushimet e ushtrisë së tij, në mënyrë që rivalët të mos arrinin dot t'ia vidhnin synimet. I takon një gjenerali që t'ua heqë shkallën ushtarëve të vet, në momentin që i ka bërë të kacavarren shumë lart. Atij i takon ta udhëheqë ushtrinë thellë në territor armik dhe aty e shkrep edhe armën. Ai i djeg anijet e veta dhe i thyen poçat e tij; në një moment i drejton ushtarët e vet në kopenë e dhenve, në mënyrë që askush të mos e kuptojë dot se ku ka ndërmend ai të shkojë vërtet. Mbledhja dhe vërvitja e ushtrisë nëpër pozicione të dëshpëruara, po ashtu është diçka që i takon gjeneralit ta bëjë. Gjithaq edhe marrja e masave të ndryshme varësisht nga nëntë variantet e terrenit, zbatimi i taktikave agresive apo mbrojtëse, sipas situatave të ndryshme, si dhe të kuptuarit e gjendjeve psikologjike të ushtarëve të vet në rrethana të ndryshme; të gjitha këto pra, janë aspekte që studiohen me kujdes nga një gjeneral.

Përgjithësisht, kur pushtojmë një territor armik, sa më

tepër që depërtojmë në brendësi, aq më tepër kohezion krijohet mes ushtarëve tanë; ndërsa depërtimi vetëm pak kilometra, ka efektin e kundërt. Prandaj, kur ndodhemi në një territor shpërndarës, na takon t'i bëjmë më të bashkuara radhët e ushtrisë sonë. Kur ndodhemi në një territor kufitar, duhen mbajtur forcat të ndërlidhura mirë mes tyre. Në një territor kyç, do të mësyja drejt prapavijës armike. Në një territor të hapur, do të kisha kujdes vijat e mia mbrojtëse. Në një territor udhëkryq, do të përforcoja aleancat e mia. Në një territor të rrezikshëm, do të kujdesesha për furnizime të vazhdueshme. Në një territor të vështirë, do të marshoja sa më shpejt nëpër shtigje. Në një territor të rrethuar, do të bllokoja pikat e hyrjes dhe daljes. Në një territor dëshpërues, do ta bëja të qartë se nuk ekziston asnjë mundësi për të mbijetuar. Sepse është në natyrën e ushtarëve që të rezistojnë kur ata janë të rrethuar, si dhe dhe të luftojnë gjer në vdekje kur nuk ka asnjë zgjidhje tjetër, e gjithhaq që kur i ka zënë rrethi i vështirë, të ndjekin me përpikmëri urdhërat.

Një komandant që nuk i njeh planet luftarake të shteteve fqinje, e ka të pamundur të bëjë aleanca me ta; nëse ai nuk i njeh si duhet kushtet e terrenit nëpër male, pyje, gryka të rrezikshme, moçale apo këneta, atëherë ai nuk mund ta udhëheqë marshimin e ushtrisë së tij; nëse ai dëshiron në përdorimin e udhërrëfyesve vendas, atëherë ai e ka të pamundur të përfitojë nga përparësitë përkatëse të terrenit. Një gjeneral që nuk njeh qoftë edhe njërën prej këtyre varianteve të terrenit, është rrjedhimisht i papërshtatshëm për të drejtuar ushtritë e një mbreti absolut. Pra, kur një mbret absolut sulmon një shtet të fuqishëm, atëherë ai bën të pamundurën që t'ia pengojë armikut të vet përqendrimin e trupave. Ai ia fut tmerrin në palcë armikut dhe i parandalon aleatët e këtij të fundit, që t'i shkojnë në ndihmë.

Që domethënë se nuk është nevoja që të luftohet përballë kombinimeve të fuqishme armike, apo që të ushqehet fuqia e shteteve të tjera. Komandanti i mençur, realizimin e qëllimeve të veta e arrin falë lebetitjes së armikut. Dhe në këtë mënyrë ai mund t'i shtyjë në dorë qytetet armike dhe ta përmbysë pushtetin e kundërshtarëve të tij. Shpërndani shpërblime pa ia mbajtur ison traditës së zakonshme; jepni urdhra pa u kujdesur për të respektuar precedentët përkatës në këtë fushë. Pra, mund ta përdorni tërë ushtrinë, njëlloj siç do të kishit përdorur një ushtar të vetëm. Caktojani detyrat përkatëse ushtrisë, pa ua bërë vartësve tuaj të njohura planet e tua; përdorini këto plane për t'i nxjerrë sa më tepër përfitime të jetë e mundur, pa ua bërë vartësve dhe trupave tuaja të ditura rreziqet e bashkangjitura. Vërvitini trupat tuaja nëpër situata të rrezikshme dhe do ta shihni se ato do të mbijetojnë; shpjerini në ndonjë territor dëshpërues (vdekjeprurës) dhe do të shikoni se do të dalin prej aty gjallë. Sepse kur një ushtri ndodhet në një situatë të këtillë, mund ta kthejë disfatën në triumf të plotë. Pra, në kryerjen e operacioneve ushtarake është e udhës që analizimi dhe njohja e planeve të armikut; dhe dita porsa të ofrohet një shteg që mund të përdoret në të mirën tuaj, atëherë nevojitet t'i përqendroni forcat kundër armikut. Pra, edhe po të marshoni mijëra kilometra, sërish do t'ia dilni t'i vrisni gjeneralët armiq. Kjo pra quhet aftësia për t'ia arritur qëllimit në një mënyrë dinake dhe të mençur.

Prandaj, kur vjen koha për të zbatuar planin e sulmit, nevojitet t'i mbyllni gjithë kalimet, të anuloni lejekalimet, mos të mbani më komunikim me lajmëtarët e armikut, dhe t'i bëni thirrje këshillit të tempullit që të vijojë me zbatimin e planeve. Kur armiku jua ofron një mundësi për ta goditur, shfrytëzojeni atë menjëherë. Pushtoni ato territore që armiku

i ka më tepër përzemër, pa u përballur me të në fushë të hapur. Gjatë zbatimit të planit, duhet t'ia përshtasni lëvizjet tuaja situatës së armikut, me qëllim që të korrni fitore. Për këtë arsye, si fillim nevojitet të shtireni si të përmbajtur, të ndrojtur. Dhe kur armiku t'ju ketë dhënë një shteg goditjeje, jini të shpejtë porsi një lepur në ndërmarrjen e sulmit tuaj, dhe ai nuk do të mundet t'ju bëjë ballë.

KAPITULLI XII

SULMI ME ZJARR
火攻

Ekzistojnë pesë mënyra për të sulmuar me zjarr. E para syresh ka të bëjë me djegien e ushtarëve; e dyta, me djegien e rezervave dhe furnizimeve; e treta, me djegien e pajisjeve luftarake; e katërta, me djegien e depove të armëve; dhe e pesta, me djegien e shtigjeve të transportit. Për të përdorur zjarrin nevojiten disa mjete specifike. Gjithashtu, edhe pajisjet përkatëse për të ndezur zjarre, duhet të jenë përherë në dispozicion. Ekzistojnë kohë të përshtatshme dhe ditë më të favorshme kur mund të ndizen zjarre. Me termin "kohë" nënkuptohet moti i nxehtë, zhegu; ndërsa me "ditë" kemi parasysh momentin kur hëna është të Shigjetari, Alferatz[8], ose në yjësitë I ose Zhen, sepse pikërisht në të tilla ditë fryjnë erëra më të thata.
Pra, në sulmet me zjarr, nevojitet t'u përshtatemi rrethanave të ndryshueshme. Kur shpërthen zjarri në fushimin armik, ju nevojitet që përnjëherë t'i koordinoni veprimet tuaja nga jashtë tij. Por nëse trupat armike e ruajnë qetësinë, përmbahuni dhe mos sulmoni menjëherë. Kur zjarri të ketë përfshirë gjithçka, atëherë mësyni edhe ju, nëse mundeni. Ndërkaq, nëse e keni të pamundur, atëherë bëni mirë të

[8] Ose Alfa Andromeda, ylli më i madh i yjësisë së Andromedës.

prisni. Nëse mund të ndizni zjarr që jashtë fushimit armik, atëherë nuk ka nevojë që të prisni gjersa zjarri të ketë rënë në brendësi të tij. Ndizini zjarret në kohën e përshtatshme. Kur zjarret ndizen në drejtim të kundërt me erën, mos sulmoni në drejtimin e erës. Kur era fryn gjatë ditës, ajo do të reshtë së fryri gjatë natës. Pra, ushtria duhet t'i njohë pesë situatat e ndryshme kur sulmohet me zjarr dhe të presë për momentin e favorshëm.
Ata që e përdorin zjarrin si mbështetje për mësymjet e tyre, mund të arrijnë rezultate mjaft të mira; ndërsa ata që përdorin përmbytjet për këtë qëllim, arrijnë të krijojnë një efekt të fuqishëm. Uji mund ta izolojë armikun, por nuk është se ia shkatërron atij furnizimet ose pajisjet luftarake njëlloj siç bën zjarri.
Pra, fitorja në betejë dhe realizimi i qëllimeve tuaja, që nuk pasohen nga konsolidimi i këtyre arritjeve, përbën diçka ogurzezë dhe mund të përshkruhet si një humbje kohe. Dhe prandaj, thuhet se sundimtarët mendjehollë duhet të urdhërojnë lidhur me planet e betejës, kurse gjeneralët e zotë nevojitet që t'i zbatojnë ato me kujdes. Nëse një veprim nuk përputhet me interesat madhore të shtetit, mos e vini atë në zbatim. Nëse nuk ia dilni dot në krye, mos i fusni fare në veprim trupat tuaja. Nëse nuk ju kanoset ndonjë rrezik, mos nisni fare luftën. Një sovran nuk mund të shpallë luftë vetëm sepse është i inatosur, e aq më pak mundet një gjeneral ta shpjerë ushtrinë në betejë, për shkak se ndihet i meritur. Sepse ndërkaq, nëse një njeri i zakonshëm të cilit i janë ngritur nervat, mundet sërish të ndihet i lumtur, ose nëse një njeriu të meritur, mund t'i bëhet prapë qejfi, një shtet i rrënuar nuk mund të rindërtohet aq lehtë, dhe as ushtarët e vdekur nuk mund të ringjallen dot. Prandaj, sundimtari mendjehollë është gjithmonë i përmbajtur

dhe gjenerali i mençur u druhet veprimeve të pamatura. Pra, kështu ruhet mirëqenia e shtetit dhe jetët e ushtarëve.

KAPITULLI XIII

PËRDORIMI I SPIUNËVE
用間

Pra, kur një ushtri e përbërë nga njëqind mijë trupa mblidhet dhe niset për një fushatë të largët, shpenzimet në kurriz të popullit, bashkë me pagesat nga thesari i shtetit, do të arrijnë në mijëra monedha të florinjta në ditë. Për më tepër, do të ketë përmallim të vazhdueshëm qoftë në shtëpitë e origjinës, ashtu edhe në frontin e luftës, populli do të rraskapitet nga angaritë e transportit, dhe veprimtaria bujqësore e shtatëqind mijë familjeve do të dëmtohet rëndë[9].
Ushtritë armike përballen njëra me tjetrën përgjatë viteve të tëra, duke synuar fitoren në ndonjë betejë vendimtare; por ndërkohë, një komandant që jargëzon për të arritur grada më të larta, nderime dhe për t'u larë në ar, duke mbetur ndërkaq thelbësisht injorant sa i përket situatës në të cilën ndodhet armiku; atëherë këtij njeriu nuk i intereson aspak e mira e vendit dhe e popullit të vet. Ky njeri nuk mund të jetë një gjeneral i zoti, as këshilltar i mirë i sovranit

---

[9] Në kohët e lashta, tetë familje përbënin një komunitet; kur një familje dërgonte një njeri në luftë, shtatë të tjerat kontribuonin për mirëqenien e saj. Kështu pra, kur një ushtri e përbërë nga njëqind mijë ushtarësh mblidhej për luftë, ata që si pasojë nuk mundeshin më t'i përkushtoheshin me orar të plotë plugimit të tokës bujqësore ose të mbjellave, arrinin në shtatëqind mijë familje.

të vet, dhe si rrjedhojë, ky sovran nuk do ta ketë më në dorë fitoren finale. Pra, arsyeja se përse një sovran i shkëlqyer dhe një gjeneral i mençur e mposhtin armikun sa herë që është nevoja, dhe përse arritjet e tyre i tejkalojnë ato të njerëzve të zakonshëm, qëndron në dijenitë e tyre largpamëse lidhur me situatën e armikut. Kjo "dijeni largpamëse" nuk mund të vijë nga shpirtrat e botës së përtejme, as nga zotat, as nga ndonjë analogji me ngjarje të së kaluarës, as nga llogaritjet astrologjike. Ajo mund të zotërohet vetëm nga ata njerëz që ia njohin mirë situatën armikut.

Pra, ekzistojnë pesë lloje spiunësh. Spiunët vendas, spiunët e brendshëm, spiunët e dyfishtë, spiunët që mund të hiqen qafe dhe spiunët mbijetues. Atëherë kur gjithë këto lloje spiunësh janë vënë në punë dhe kur veprimet e tyre zhvillohen në klandestinitet, kjo quhet "tërheqja e mençur e fijeve" dhe pikërisht këtu fshihet avantazhi më i madh i një sovrani, thesari i tij. Spiunët vendas janë ata banorë të shtetit armik që ne përdorim në të mirën tonë. Spiunët e brendshëm janë zyrtarë të armikut që i përdorim sipas interesit tonë. Spiunët e dyfishtë janë spiunë të armikut që i përdorim sipas dëshirës. Spiunët që mund të hiqen qafe, janë ata spiunë tanët të cilëve qëllimisht u japim informacione të pavërteta dhe u themi t'ua përçojnë ato armikut. Spiunët mbijetues janë ata që venë dhe më pas kthehen nga fushimi armik për ta na sjellë informacione të freskëta.

Ndër gjithë pjesëtarët e ushtrisë, askush nuk është më i afërt me komandantin sesa spiunët; ndër tërë shpërblimet, më bujarët u kushtohen spiunëve; mes gjithë çështjeve të ndryshme, asnjë syresh nuk është më sekrete sesa ato që lidhen me operacionet e spiunimit. Ai komandant që nuk është as i matur e as i mençur, i njerëzishëm dhe i drejtë, nuk mund të dijë si t'i përdorë spiunët. Dhe ai komandant

që nuk është aq i mprehtë dhe mendjehollë, e ka të pamundur t'ua blejë atyre mendjen dhe ta kuptojë të vërtetën.

I mprehtë pra! Vërtet i mprehtë! Nëse nuk ka një vend në botë ku të mos depërtojë spiunazhi. Nëse planet që kanë të bëjnë me operacionet e spiunazhit bëhen të ditura para kohe, agjenti përkatës dhe të gjithë njerëzit me të cilët ai eventualisht do të ketë folur, do të rrezikojnë jetët e tyre.

Përgjithësisht, kur bëhet fjalë për një ushtri armike që ju dëshironi të godisni, si dhe për njerëz të caktuar që doni të vrisni, është e nevojshme që të zbulohen qysh më parë emrat e komandantit të garnizonit, adjutantëve, shoqëruesve të tyre, portierët dhe truprojat. Nevojitet që t'i udhëzoni spiunët tuaj që këto çështje t'i sqarojnë imtësisht. Është me rëndësi themelore që t'u bini në gjurmë spiunëve armiq që kanë ardhur në territorin tuaj për të zhvilluar aktivitete spiunazhi kundër jush dhe pastaj t'i paguani ata në mënyrë që të vihen në shërbimin tuaj. Jepuni atyre udhëzimet e duhura dhe kujdesuni për ta. Kështu, spiunët e dyfishtë rekrutohen dhe përdoren sipas interesit tuaj. Përmes punës së spiunëve të dyfishtë mund të rekutohen dhe përdoren spiunët vendas dhe ata të brendshëm. Përmes punës së agjentët që mund të hiqen qafe, të udhëzuar me informacione të pavërteta, mund të çohen për të mashtruar armikun. Kështu edhe spiunët mbijetues mund të kthehen pranë jush dhe t'ju sjellin informacionet më të freskëta.

Sovrani duhet të jetë në dijeni të plotë të veprimtarive të këtyre pesë lloj spiunëve. Dhe çelësi qëndron pikërisht në përdorimin e spiunëve të dyfishtë. Prandaj, është e detyrueshme që ata të trajtohen në mënyrë thellësisht dorëlëshuar.

Në kohët e lashta, zeniti i Dinastisë Shang i detyrohej Yi Zhi-së, i cili i kishte shërbyer edhe Xia-s njëlloj, kurse ngritja e Dinastisë Zhou, kishte ndodhur falë Lu Ya-së, i cili

i kishte shërbyer gjithashtu Yin-ve. Dhe për këtë arsye, vetëm një sovran mendjehollë dhe një gjeneral i mençur, që dinë se si t'i përdorin njerëzit më të zgjuar si spiunë, mund të arrijnë rezultate madhështore. Operacionet e spiunazhit janë thelbësore në luftë; aty mbështetet ushtria për të hedhur çdo hap të saj.

_____

KOMENTET E GJENERALIT
TAO HANGZHANG
PËR ARTIN E LUFTËS

_____

KAPITULLI I

VLERËSIMET STRATEGJIKE

Teza themelore e Artit të Luftës të Sun Tzu-së, ka të bëjë me mposhtjen e armikut me zgjuarsi, jo vetëm përmes forcës. Sun Tzu besonte se një përballje ushtarake nuk përbënte vetëm një garë mes forcave rivale ushtarake, por gjithashtu edhe një konflikt gjithëpërfshirës që ngërthente në vetvete edhe politikën, fushën ekonomike, fuqinë ushtarake dhe diplomacinë.

Qëndrimi i Sun Tzu-së kundrejt luftës ishte skajshmërisht i përmbajtur, serioz dhe i matur. Ai pohonte se: "Lufta duhet analizuar me vlerë jetike për vetë shtetin; një çështje për jetë a vdekje; rrugëtimi drejt mbijetesës apo rrënimit total. Gjë që domethënë se është e domosdoshme që ajo të studiohet me themel."

PESË FAKTORËT THEMELORË TË LUFTËS

Sun Tzu-ja pohonte: "Lufta duhet analizuar së pari në këndvështrimin e pesë faktorëve themelorë dhe të bëhen krahasime midis kushteve me të cilat ndodhen palët kundërshtare, me qëllim që të përcaktohet si do t'i vejë filli konfliktit. I pari ndër këta faktorë themelorë është politika; i dyti, kushtet e motit; i treti, terreni; i katërti, komandanti i ushtrisë; dhe i pesti, doktrina". Përmbledhtazi, Sun

Tzu besonte se një komandant i zoti duhet ta drejtojë luftën varësisht nga kushtet që janë vendimtare për fatet e saj, dhe mes tyre, pesë faktorët themelorë, si dhe shtatë elementët përkatës, janë parësorë për këtë qëllim.

Sa i përket politikës, ai nënkuptonte se sovrani do të duhej ta përdorte presionin politik dhe mjete të tjera, për t'i bërë nënshtetasit më të harmonishëm me qëndrimet e tij. Lidhur me kushtet e motit, ai e kish fjalën të ndërveprimi i fuqive natyrore; efektet e natës dhe ditës, shiut apo kohës së mirë, të ftohtit apo vapës, orëve të ndryshme të ditës apo vetë stinëve, dhe shfrytëzimit të kushteve të favorshme, apo edhe shmangies së ndonjë faktori të dëmshëm. Kur përmendte terrenin, ai e ka fjalën për distancat, për faktin nëse terreni mund të përshkohet lehtësisht apo me vështirësi, nëse një terren përkatës është më i përshtatshëm për taktika sulmuese apo mbrojtëse, si dhe nëse në një terren të këtillë mund të pozicionohen trupat. Lidhur me komandantin e ushtrisë, ai thekson se cilësitë e një gjenerali si komandant, si mençuria, sinqeriteti, dashamirësia, kurajo, këmbëngulja dhe rreptësia, janë jetike. Me doktrinë, ai nënkupton disiplinën dhe organizimin e trupave, caktimin e gradave të duhura për oficerët dhe detyrat e tyre përkatëse, rregulloret dhe administrimin logjistik.

Këta janë pra, faktorët themelorë që Sun Tzu besonte se ishin të domosdoshëm për të analizuar dhe parashikuar fitoren apo disfatën në luftë. Për të analizuar këta faktorë, duhet t'u përgjigjemi pyetjeve vijuese që njiheshin si “shtatë elementët”:

1. Cili mes dy sovranëve rivalë, është më mendjeholli?
2. Cili mes dy komandantëve është më i zgjuari dhe i afti?

3. Cila mes dy ushtrive kundërshtare gëzon avantazhet natyrore dhe të terrenit?
4. Cila palë ndërluftuese kujdeset në mënyrë më të rreptë për disiplinën?
5. Cila mes dy ushtrive është më e fortë?
6. Cila palë ka oficerë më të mirëpërgatitur?
7. Cila palë i administron shpërblimet dhe ndëshkimet në një mënyrë më të mençur?

Pasi të keni bërë një analizë gjithëpërfshirëse, do të jeni në gjendje për të parashikuar se cila nga dy palët ndërluftuese do të ngadhënjejë. Sigurisht, nga këndvështrimi i luftës moderne, këto kushte janë kuptueshmërisht të pamjaftueshme. Por ndërkaq, do vlerësuar jashtëzakonisht fakti se këta faktorë themelorë Sun Tzu i kishte zbuluar dy mijë vite më parë.

Gjatë luftës patriotike kineze kundër pushtuesit japonez, shoku Mao Ce Dun, kishte shkruar një ese ushtarake të shkëlqyer: "Mbi luftën e tejzgjatur", në të cilën, pasi kish marrë në konsideratë faktorët e ndryshëm që lidheshin me politikën, ekonominë, çështjet ushtarake, diplomacinë dhe gjeografinë, ai kishte dalë në përfundimin se Kina do të arrinte të triumfonte kundër Japonisë pushtuese. Dhe pastaj, historia do t'i jepte atij të drejtë. Armiqtë e Kinës në një luftë të ardhshme do të jenë të ndryshëm nga japonezët, por edhe vetë ushtria kineze do të jetë e ndryshme. Por mënyra e Sun Tzu-së për të analizuar luftën, do të mbetet praktike dhe me rëndësi madhore për strategjitë luftarake të Kinës.

STRATEGJITË E LUFTËS TË SUN TZU-SË

Sun Tzu ishte skajshmërisht i kujdesshëm për aq sa bëhej fjalë për strategjinë. Ai gjykonte se ishte më e udhës të nënshtrohej ushtria e armikut pa qenë nevoja që të luftohej. Ai theksonte se: "Të fitosh njëqind herë në njëqind beteja nuk përbën kulmin e aftësisë. Ta nënshtrosh armikun pa qenë nevoja të luftohet, përbën vërtet përsosmërinë e nivelit epërm". Ai kishte dalë në këtë përfundim pasi kish krijuar një bagazh të madh përvoje nga luftërat e kohës së tij.

Parimi i Sun Tzu-së lidhur me operacionet në terren, kish të bënte me marrjen e masave parandaluese, si dhe me marrjen e vendimeve të shpejta gjatë fushatave luftarake. Ky parim ishte formuluar përmes ngjizjes së kushteve sociale dhe historike të kohës. Në kapitullin e titulluar "Veprimet luftarake", Sun Tzu pohonte: "Kur ushtria ndërmerr fushata të tejzgjatura në kohë, atëherë burimet shtetërore nuk do të jenë të mjaftueshme. Kur ushtria juaj të jetë rrastisur dhe morali i saj jetë përtokë, ndërkohë edhe thesari juaj i shtetit të jetë përtharë, rrjedhimisht sundimtarët e shteteve të tjera do të përfitojnë nga rasti dhe do të futen në veprim. Pastaj, sado që të keni këshilltarë të mençur, asnjëri syresh nuk do të jetë i aftë të përpilojë plane të mira për të ardhmen. Prandaj, megjithatë na ka qëlluar të dëgjojmë për nxitim gjatë luftës, akoma nuk na ka rënë të shohim ndonjë operacion të zgjuar luftarak që të ketë zgjatur më tepër se ç'duhet". Ai sërish vë në dukje në të njëjtin kapitull: "Ata, të cilëve iu takon me merren me luftën, nuk e kanë të nevojshme të rekrutojnë të tjerë ushtarë ose të kenë nevojë për më tepër furnizime se zakonisht. Ata i mbartin me vete pajisjet ushtarake nga atdheu, kurse furnizimet ia rrëmbejnë armikut".

Përse pra, janë kaq të nevojshme vendimet e shpejta dhe masat parandaluese në betejë? Kjo gjë përcaktohet nga disa lloj kushtesh sociale, sidomos nga faktorët mbizotërues ekonomikë në kohë lufte. Në kohën e Sun Tzu-së, një shtet i tërë, ishte më i vogël se një provincë sot. Popullata e tij ishte e vogël dhe materialet e kufizuara. Për këtë arsye, shtete të këtilla e kishin të pamundur ta përballonin një fushatë ushtarake të stërzgjatur.

TABUTË LUFTARAKE TË MARSHALLIT LIU BOÇENG

Marshalli Liu Boçeng besonte se një komandant i zoti duhej të merrte parasysh pesë "tabutë" vijuese kur vinte puna te vendimet strategjike:

1. Mos iu futni një lufte nëse vendi juaj nuk është mjaftueshëm i fuqishëm (përfshirë këtu edhe fuqinë njerëzore dhe fuqinë financiare dhe ushtarake).
2. Mos iu futni një lufte nëse nuk e keni situatën të favorshme (përfshirë situatën ndërkombëtare dhe qasjen përkatëse të vendeve fqinje).
3. Mos iu futni një lufte nëse vendi juaj nuk gëzon një paqe dhe qetësi të brendshme.
4. Mos iu futni një lufte nëse populli nuk e mbështet atë.
5. Mos iu futni një lufte nëse ushtria juaj do të duhet të luftojë në dy ose më tepër fronte njëherësh. Është me rëndësi të kihen parasysh këto pesë kushte kur merren vendime strategjike, por ato nuk janë të gjitha të njëjtën peshë. I pari dhe i pesti syresh janë më të rëndësishëm se të tjerët. Sigurisht, ai shtet që bie viktimë e një agresioni armik, nuk duhet t'i mbajë parasysh këto pesë tabu atëherë kur lufton në vetëmbrojtje ndaj agresorit përkatës.

Dhe gjithaq e qartë është se Kina duhet t'i kushtojë vëmendjen e duhur masave të saj mbrojtëse në kohën kur ajo i kushton më tepër kujdes zhvillimit ekonomik ndërkohë që situata ndërkombëtare është akoma e turbullt dhe faktorët luftënxitës janë ende të fortë.

Marshalli Liu përmend një sërë shembujsh për të shpjeguar këto pesë tabu: "Kishte qenë një budallallëk që gjenerali Tojo (japonez) kish shkaktuar Luftën e Paqësorit në vitin 1941. Teksa këtë sipërmarrje madhore e kishte nisur ndërkohë që e kish krejtësisht të pamundur që njërën nga këmbët e ushtrisë së vet ta largonte nga balta e truallit kinez, ai ishte përpjekur që këmbën tjetër ta vendoste në Azinë Juglindore, duke luftuar kështu në dy fronte (kundër Kinës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dy fuqive të mëdha, nga njëra anë, dhe vendeve të Azisë Juglindore nga ana tjetër).

"Stalini ndërkaq, ishte më i mençur. Ai ishte përpjekur me të gjitha mjetet që të merrej vesh me japonezët teksa luftonte me Gjermaninë Naziste. Kur ishte takuar personalisht me ambasadorin japonez, ai në një mënyrë të përshtatshme uronte që të vijonin marrëdhëniet miqësore midis Bashkimit Sovjetik dhe Japonisë. Ai si përfundim, i kishte shpallur luftë Japonisë vetëm kur Gjermania ishte mposhtur". Ka pasur jo pak raste kur një ushtri e fuqishme ka pësuar disfatë kur i është dashur të luftojë kundër më tepër se një armiku njëkohësisht; Hitleri dhe Napoleoni janë dy prej këtyre shembujve.

Është gjithnjë në përputhje me interesat më themelore të një vendi dhe me qëndrimin përkatës strategjik, që të kërkohen aleanca, të nënshkruhen traktate, marrëveshje me vende të tjera pasi të jetë shqyrtuar situata imtësisht. Pasi të jetë përfunduar traktati përkatës, përveç rasteve kur ai është tepër i njëanshëm, do të ishte e udhës që ai të

respektohej përgjatë tërë periudhës së vlefshmërisë së tij; përndryshe vendi dhe udhëheqësi i tij do ta humbin gjithë besueshmërinë në sytë e botës. Hitleri ishte për shembull, një udhëheqës tipik i pabesë në këtë këndvështrim.

ARTI I LUFTËS NË HISTORINË KINEZE

Sun Tzu-ja theksonte tek Arti i Luftës: "Rëndësi madhore në kushte lufte ka dëmtimi i planeve strategjike të armikut. Pastaj është e udhës të rrënohen aleancat e tij përmes diplomacisë, dhe më pas të sulmohet ushtria e tij. Ndërsa qasja më e gabuar ka të bëjë me rastet kur sulmohen qytetet e tij". Ky parim i Sun Tzu-së përbën kuintesencën e ideve strategjike, gjë që është vlerësuar pamasë nga ushtarakët përgjatë gjithë historisë, dhe që vlen gjithashtu si një rregull i përgjithshëm për t'u zbatuar në të tëra luftërat anti-agresive.

Sun Tzu-ja nuk ishte shtjelluar më tej përsa i përket idesë së tij të dëmtimit të planeve strategjike të armikut. Është pra, e nevojshme që të jepen disa shembuj për të shpjeguar si duhet atë që ai kishte nënkuptuar me këtë pohim. Unë mendoj se Sun Tzu-ja kish një mendim të dyfishtë: marrjen e vendimeve strategjike dhe aftësinë për ta mundur armikun përmes strategjisë. Përgjatë historisë ka pasur shembuj të shumtë luftërash që mund ta shtjellojnë qartë këtë parim.

DIALOGU NË LONGZHANG

Gjatë periudhës së Tre Mbretërive (220–265 pas Krishtit), Liu Bei kishte vajtur të shtëpia prej kashte e Zhuge Liangut tre herë, duke kërkuar ndihmë lidhur me përpjekjen

e Liut për të dominuar Kinën. Në Dialogun në Longzhang (qarku Shangyang, provinca e Hubei), Zhuge nxjerr në pah tre përllogaritje tipike strategjike:

1. Përparoni nga drejtimi i perëndimit dhe pushtojeni zonën e Siçuan si bazën tuaj, dhe pastaj prisni për kohën e përshtatshme për të marshuar drejt Rrafshinave Qendrore (përfshirë edhe rrjedhën e epërme dhe të ulët të Lumit të Verdhë).
2. Shtrëngoni një aleancë me mbretërinë e Wu-së me qëllim që forcat e Shu Hanit të mos dërrmohen një nga një.
3. Bojkotojeni Wei (Cao Cao-n) nga ana veriore, duke e bërë kështu situatën politike të qartë për popullin, dhe duke e kthyer atë në anën e Liut.

Para se Liu Bei t'i kërkonte Zhuge Liangut që të bëhej shefi i tij i shtabit, ai ia kishte besuar këtë detyrë Yuan Shaos si ndihmës të tijin. Liu Bei pastaj kishte vajtur te Liu Biao për të gjetur ndihmë pa siguruar më parë një bazë për vete. Përse vallë? Kjo kishte ndodhur ngaqë Liu Bei nuk kishte bërë një analizë të përgjithshme të situatës në nivel kombëtar dhe nuk kish marrë një vendim strategjik të duhur. Rrafshinat Qendrore në atë kohë përbënin skenën e luftërave të ashpra midis zotërve të ndryshëm të luftës. Për këtë arsye, kishte shumë pak mundësi që Liu Bei të ngrinte një bazë të vetën aty pari, ose të mblidhte një ushtri për t'u përballur me Cao Cao-n. Aq më pak mundej ai të fitonte ndonjë avantazh duke shfrytëzuar konfliktet mes zotërve të luftës të Rrafshinave Qendrore.

Zhuge Liangu ndërkaq, kishte bërë një studim shterues te *Dialogu në Longzhong*, të pozicionit strategjik të Siçuanit dhe kishte dalë në përfundimin se Liu Beit i duhej të ngrinte një bazë të vazhdueshme aty. Le të analizojmë më tej tre pikat e *Dialogut në Longzhong.*

Së pari, pasi e kishte kthyer në bazën e saj Siçuanin, ushtria e Liu Bei-t mund t'i rimblidhte dhe t'i shtonte forcat dhe energjinë përpara se të sulmonte Rrafshinat Qendrore. Siçuani kishte mjaftueshëm fuqi njerëzore dhe lëndë të para, meqenëse kish qenë përherë një tokë e lulëzuar, dhe ishte, pra, një bazë e mirëfilltë ekonomike për Liu Bei-n. Së dyti, Liu Bei mund ta shmangte rrezikun e të qenit në dy fronte kundër Cao Cao-s, si dhe Sun Quan-it. Së treti, ushtria e Liu Bei-t mund të merrte iniciativën e të përparuarit duke ndërmarrë njëkohësisht një manovër sulmuese dhe mbrojtëse njëkohësisht, në përparim e sipër.

Liu Bei duhej të bënte aleancë me mbretërinë e Wu-së për arsye se në atë kohë Wei në veri dhe Wu-ja në jug-lindje qenë dy shtetet e vetme të fuqishme të mbetura në këmbë. Të bërit aleancë me Wu-në dhe shmangia e Wei-t do të bënte të mundur evitimin e të luftuarit në dy fronte dhe sigurimin e një ambienti paqësor ku të mbështetej thelbi i fuqisë së tij. Kjo qasje mundësonte një dallim të qartë midis armiqve dhe miqve.

Liu Bei tej mase ta bojkotonte Cao Cao-n për shkak se fuqia e Dinastisë Han atëherë ishte, faktikisht, në duart e Cao Cao-s, që gjatë një përpjekjeje për ta vënë Kinën nën kontrollin e vet, i shpërndante urdhra tërë sovranëve në emër të perandorit. Ndër të tjera, do të ishte e favorshme politikisht, që të mos bojkotohej Cao Cao-ja. Liu Bei kishte vendosur që ta ringjallte Dinastinë Han duke u mbështetur te fakti se ishte një i afërm nga gjaku me dinastinë perandorake. Shteti i tij i Siçuanit ishte malor nga ana veriore, gjë kjo fort e mirë për vijat e mbrojtjes. Prandaj, Cao Cao-ja nuk kishte guxuar ta sulmonte Siçuanin para se të kishte pushtuar mbretërinë e Wu-së nga lindja.

Qëllimi i shpjegimit të strategjisë së Zhuge Liangut që

shpërfaqet te *Dialogu në Longzhong*, ka të bëjë me rënien e idesë së të sulmuarit dhe dëmtuarit të strategjisë së armikut.

BETEJA E KUANLINIT

Një tjetër shembull tipik i mposhtjes së armikut përmes veprimeve të mençura, kishte ndodhur në vitin 354 para Krishtit. Kryeqyteti i Zhao-s në atë kohë, ishte qyteti Handan (në provincën e sotme të Hebeit); kryeqyteti i Wei-it ishte Daliangu (Keifani i sotëm në provincën Henan); dhe kryeqyteti i Qi-së ishte Linzi (Zibo i sotëm në provincën e Shandongut).
Gjenerali Pang Juan nga Wei, kishte udhëhequr një ushtri të përbërë nga njëqind mijë ushtarë për të rrethuar Handanin, kryeqytetin e Zhaos. Zhao kishte dërguar emisarët e vet në Qi për të kërkuar ndihmë. Sovrani i Qi-së kishte mbledhur gjeneralët dhe oficerët e tij për të diskutuar lidhur me një plan për të shpëtuar Zhaon. Gjenerali Tien Ji ishte vetëofruar si komandant i një ushtrie prej njëqind mijë ushtarësh kundër Pang Juanit për t'i vajtur në ndihmë Zhaos së rrethuar. Por këshilltari ushtarak i Qi-së, Pang Bini kishte kundërshtuar, duke thënë se mënyra më e mirë për t'i ardhur në ndihmë Zhaos ishte që të dërgohej një ushtri për të rrethuar Daliangun, kryeqytetin e Wei-t. Ai kishte vënë në dukje se trupat më të mira goditëse të Wei-t tashmë ishin dërguar në Handan, duke e lënë kryeqytetin e tyre të pambrojtur. Kur trupat e Qi-së ishin dërguar drejt Daliangut, sovrani i Wei-t patjetër që do t'i jepte urdhër Pang Juanit që të kthehej dhe të mbronte Daliangun. Rrethimi i Handanit kështu do të shmangej pa luftë. Dhe kur trupat e Pang Juanit të ridrejtoheshin për në Handan, atëherë ushtria

e Qi-së do të zgjidhte një vend të përshtatshëm për t'u përballur me to dhe për t'i mposhtur krejtësisht.
Kjo strategji e mençur kish të bënte me "të sulmohej pikërisht aty ku ia vlente më tepër, atje ku vërtet mund të ndihmohej aleati". Kjo ishte një strategji shumë më e zgjuar sesa ajo e gjeneralit Tien Ji për t'u përballur në betejë me raskapitës. Prandaj, sovrani i Qi-së kishte vendosur që t'i dërgonte trupat në Daliang nën urdhërat e gjeneralit Tien Ji, dhe Sun Bini-t si këshilltar të tij personal ushtarak. Kur trupat e Qi-së ishin në marshim e sipër drejt Daliangut, sovrani i Wei-t, siç pritej, e kishte urdhëruar Pang Juanin që të nxitonte mbrapsht drejt Daliangut bashkë me ushtrinë e tij. Rrethimi i Zhaos me të vërtetë kishte përfunduar pa luftë fare. Ndërkohë që trupat e Wei-t po tërhiqeshin drejt Daliangut, ato kishin ndeshur trupat e Qi-së në distriktin e Kuanlinit, dhe aty ishin mposhtur prej tyre. Kjo do të quhej si Beteja e Kuanlinit. Nga një këndvështrim retrospektiv pra, ne mund të dalim në përfundimin se plani i Tien Jisë për t'i vajtur në ndihmë Zhaos, kish të bënte me të sulmuarit e armikut përmes forcës, kurse plani i Sun Binit synonte ta mposhte armikun falë mençurisë.

BETEJA E MING TIAOS

Në vitin 1763 para Krishtit, Yi Yingu e kishte mposhtur armikun e tij duke përdorur vlerësimet strategjike pas një analize tërësore të situatës dhe peshimit përkatës të përparësive dhe faktorëve të pafavorshëm. Yi Yingu ishte një nga zyrtarët më të rëndësishëm të Sung Tangut, nën ofiqin Ah Heng – një post i barasvlershëm me atë të kryeministrit apo shefit të shtabit në ushtri. Yi Yingu i kishte sugjeruar

Sung Tangut që të mos pranonte më t'i paguante tribute Xia Jie-s në mënyrë që kështu ta vinte në provë popullaritetin dhe fuqinë e këtij të fundit mbi popullin e vet. Sung Tangu e kishte pranuar këtë sugjerim dhe kishte ndalur së paguari tributet e veta për atë vit. Jie ishte tërbuar nga ky gjest dhe kishte caktuar trupat e nëntë fiseve për ta sulmuar Tangun. Meqenëse Jie ishte akoma popullor mes nënshtetasve të tij, Yi Yingu e kishte këshilluar Tangun që t'i kërkonte falje Jie-s dhe t'i paguante atij tashmë edhe më tepër tribute.
Vitin tjetër, Tangu sërish kishte refuzuar që të paguante tribute. Jie ishte tërbuar akoma edhe më shumë dhe prapë kishte vendosur të caktonte trupat nga nëntë fise të ndryshme për ta sulmuar Tangun. Por këtë herë fiset në fjalë nuk ishin treguar edhe aq të gatshme për t'i dërguar njerëzit e tyre në luftë, duke u ankuar për faktin se ata ishin tepër të varfër. Si pasojë e faktit se duhej të përgatiteshin për luftë vit për vit, ushtarët ishin tejet të lodhur. Vetëm tre fise i ishin bindur thirrjes dhe kishin vënë në dispozicion trupat e tyre. Për këtë arsye Yi Yangu kishte thënë se tanimë Jie e kishte humbur popullaritetin e tij, ashtu si edhe fuqinë për të luftuar dhe se morali i trupave të tij të dërguara nga vetëm tre fise ishte tepër i ulët; pra kjo ishte pikërisht koha për t'u përballur në betejë me Jie-n. Sung Tangu e kishte ndjekur këshillën e tij dhe, bashkë me trupat e sovranëve të tjerë, kishin zënë pritë në Ming Tiao të Anyi (provinca e sotme Shansi) dhe i kishin mundur trupat e Xia Jie-s aty. Pastaj Tangu kishte themeluar mbretërinë e Shangut. Historikisht, kjo njihet si Beteja e Ming Tiaos. Ajo shërben si një shembull tipik i gjetjes së mundësisë së përshtatshme për ta mposhtur një armik pasi ta kesh analizuar në mënyrë shteruese situatën.

DIPLOMACIA

Sun Tzu-ja i jepte një rëndësi të madhe diplomacisë. Ai e përdorte atë për të lidhur aleanca me fuqi të tjera rajonale, për të luftuar së bashku kundër një armiku të përbashkët. Mbretëria e Wu-së në atë kohë ndodhej ku sot gjenden Suzhou dhe Wusi i sotëm. Në perëndim të saj ishte mbretëria e fuqishme e Cu-së (provincat e sotme të Hubei, Anhui dhe Hunanit). Ato ishin dy mbretëri fqinje me njëra tjetrën dhe shpesh përplaseshin në përleshje kufitare. Sun Tzu-ja me padurim mezi priste që të lidhte një aleancë mes mbretërive të Wu-së dhe Qi-së në veri, në mënyrë që ta zbuste presionin nga kjo anë dhe t'i përqendronte forcat në luftën kundër Cu-së. Politika e dëmtimit të aleancave të armikut tek Arti i Luftës i Sun Tzu-së, përbën një strategji të një rëndësie tepër praktike. Kjo do të thotë që të sigurohet një qasje e favorshme strategjikisht përmes diplomacisë. Ajo ka të bëjë gjithaq me idenë e mposhtjes së armikut falë vlerësimeve dhe analizave strategjike. Tre shembujt vijues do të jenë të mjaftueshëm për ta shtjelluar këtë ide.

PAKTI I MOS-SULMIT I STALINIT ME HITLERIN

Para Luftës së Dytë Botërore, Bashkimi Sovjetik kishte bërë të pamundurën që të nënshkruante një marrëveshje mbështetjeje të ndërsjellë me Mbretërinë e Bashkuar dhe Francën duke dashur të shmangte kështu pushtimin nga Gjermania Naziste. Por qeveritë e Britanisë dhe Francës në atë kohë rrekeshin që ta drejtonin furinë e Gjermanisë Naziste për nga lindja – pra Bashkimi Sovjetik. Si rrjedhojë, bisedime të shumta mes këtyre fuqive kishin dështuar pavarësisht përpjekjeve të Bashkimit Sovjetik. Në këto

rrethana, Stalini nuk mund të vepronte ndryshe, përveçse të nënshkruante një pakt mos-sulmi me Gjermaninë, gjë që do ta ndalonte përparimin gjerman për njëfarë periudhe kohore duke i lënë kështu kohë sovjetikëve për t'u përgatitur për luftë. Qeverisë britanike dhe franceze nuk ishin treguar aq të kujdesshëm sa sovjetikët dhe e kishin provuar të parët në lëkurë fuqinë goditëse të luftës rrufe të gjermanëve. Kjo gjë përshkruhej nga shoku Mao Ce Dun si "të ngresh nga toka një gur, vetëm për ta hedhur atë mbi këmbët e tua". Taktika e Stalinit e të shtyrrit të sulmit të Hitlerit përmes mjeteve diplomatike, duke fituar kështu kohë për t'u përgatitur, ishte treguar e mençur dhe fort e dëshirueshme nga një këndvështrim ushtarak.

PRISHJA E ALEANCËS QI-CU

Gjatë Periudhës Luftarake (475-221 para Krishtit), mbretëria e Qin-it donte të sulmonte atë të Qi-së, por ajo i druhej aleancës Qi-Cu. Zhang Yi-ja kështu, ishte dërguar nga mbretëria e Cu-së si i dërguar special për të prishur aleancën Qi-Cu. Pasi kishte arritur në Cu, Zhang Yi ishte takuar me mbretëreshën Nan dhe i kishte sjellë asaj një dhuratë të shtrenjtë me perla dhe gurë të çmuar duke i kërkuar ndërkaq që ajo t'i përçonte një mesazh sovranit të Cu-së: "Zhang Yi-a ka ardhur në Cu si i dërguar special për t'u takuar me sovranin e Cu-së. Mbretëria e Qin-it është e gatshme të lëshojë treqind kilometra katrorë të territorit të vet në favor të mbretërisë së Cu-së. Ajo që kërkon mbretëria e Qin në këmbim, është vetëm miqësia me Cu-në dhe mos-sulmi".
Sovrani i Cu-së ishte takuar me Zhang Yi-në, që kishte bërë të pamundurën për t'ia mbushur mendjen atij lidhur

me përfitimet e të qenët në marrëdhënie të mira me mbretërinë e Qinit. Sovrani i mbretërisë së Cu-së ishte ndier më tepër se i kënaqur me premtimin për të fituar 300 kilometra katrorë tokë nga mbretëria e Qinit si shpërblim për marrëdhënie miqësore mes dy vendeve dhe kishte premtuar nga ana e vet se do të mbante lidhje të mira me Qin-in.
Sovrani i Qi-së ishte tërbuar kur kishte dëgjuar lajmet e pajtimit midis sovranit të Cu-së dhe Zhang Yi-së, gjë që atij i ishte dukur si një komplot kundër Qi-së. Pastaj, Qi-ja dhe Cu-ja ishin shndërruar në mbretëri armike.
Faktikisht, oferta për treqind kilometra katrorë territor, përbënte një mashtrim. Kur i dërguari i mbretërisë së Cu-së kishte vajtur në mbretërinë e Qin-it për ta formalizuar pranimin e këtij territori, Zhang Yi-ja kishte thënë se ajo çfarë ai kish premtuar nuk kishin qenë treqind kilometra katrorë nga territori i Qi-së, por vetëm tre kilometra katrorë nga pronat e tij personale. Sovrani i Cu-së atëherë ishte tërbuar skajshmërisht kur e kishte zbuluar këtë rreng. Ai kishte dërguar trupa për ta sulmuar mbretërinë e Qin-it, por kish pësuar humbje. Qysh nga ai moment, mbretëria e Cu-së kishte rënë në izolim nga të gjitha anët. Si pasojë e kësaj, prishja e aleancës Qi-Cu nga ana e mbretërisë së Qin-it, kishte shërbyer si gur themeli për shkatërrimin e vetë mbretërive të Qi-së dhe Cu-së.

ALEANCA NDËRMJET JINIT DHE QINIT

Gjatë Periudhës së Pranverës dhe Vjeshtës (770-476 para Krishtit), prishja e aleancës midis Jinit dhe Qinit nga ana e mbretërisë së Zhengut teksa gjendej nën një sulm të përbashkët prej tyre, përbën një tjetër shembull fort bindës lidhur me përdorimin e diplomacisë për të dobësuar dy

aleatë kundërshtarë. Zhengu ishte një shtet i vogël i shtypur mes dy fqinjëve të fuqishëm – Jin-it dhe Qin-it. Zhengu, duke qenë aleat i Cu-së, shpresonte se mbretëria e Cu-së do t'i vinte në ndihmë. Por duke iu druajtur fuqisë së Jin-it dhe Qin-it, mbretëria e Cu-së nuk guxonte t'i dërgonte trupat e veta në ndihmë të Zhengut. Kështu që Zhengu ndodhej në një situatë të dëshpëruar.

Sovrani i Zhengut atëherë kishte dërguar një zyrtar të tijin me shumë përvojë, Zhu Zhiwu-në – një diplomat plot eksperiencë që ishte gojëtar i madh, njeri i guximshëm dhe me burime të pashtershme – në Qin për t'u takuar me sovranin e kësaj mbretërie personalisht. Zhu Zhiwu-ja i kishte kërkuar sovranit të Qin-it t'i tregonte arsyet se përse ai mbështeste Jinit në sulmin ndaj Zhengut. Sovrani i Qin-it i kishte thënë se ai e mbështeste Jinin ngaqë Zhengu nuk vepronte në mënyrë besnike ndaj Jinit për vete.

Zhu Zhiwu-ja kishte thënë: "Zhengu vërtet e kishte shkelur premtimin e vet ndaj Jin-it, por kjo mbretëri gjithnjë e ka admiruar dhe respektuar së tepërmi mbretërinë e madhe të Qin-it. Madhëria juaj është një njeri i mençur dhe zemërgjerë. Ju e patët ndihmuar mbretërinë e Jin-it të themelonte shtetin e vet. Dhe sakaq ju sërish po e ndihmoni Jin-in që të pushtojë Zhengun duke i raskapitur kështu trupat tuaja në një fushatë tejet të gjatë. Zhengu ndodhet shumë larg nga Qin-i, dhe asnjë përfitim nuk do të keni ju nga pushtimi i Zhengut. Përkundrazi, nëse Zhengu do të pushtohej nga Jini, atëherë pikërisht Jin-i do të fuqizohej jashtë mase nga kjo gjë, dhe meqenëse Qin-i dhe Jin-i janë dy shtete fqinje, nëse Jin-i do të fuqizohet akoma më tepër, atëherë kjo mbretëri do të shndërrohet në një rrezik potencial për Qin-in. Unë shqetësohem për të

ardhmen e Qin-it. Jin-i nuk është një shtet që mund të cilësohet si pafundësisht i sinqertë dhe besnik. Dikur kjo mbretëri kishte premtuar që t'ia lëshonte territorin e saj perëndimor të lumit Huang mbretërisë së Qin-it, por nuk e kishte mbajtur premtimin. Për më tepër, ajo kishte çuar trupa në kufi duke kërcënuar kështu sigurinë e Qin-it. A mos doni ju vallë që ta mbani kështu një fqinj të afërt që ndërkohë është i egër dhe i fuqishëm porzi një tigër? Sipas mendimit tim, gjëja më e mirë për t'u bërë nga ana e Qin-it, është që t'i tërhiqni trupat nga kjo fushatë kundër Zhengut dhe t'i ktheni ato në vendin tuaj. Kjo gjë do të ishte në interesin e Qin-it. Nëse mbretëria e Qin-it do ta ndiqte këshillën time dhe do t'i tërhiqte trupat e saj, Zhengu do të pranojë të jetë nën mbrojtjen e Qin-it dhe, nëse do të jetë nevoja, të ofrojë baza ushtarake kur ushtria e Qin-it të shërbejë si një barrierë e natyrshme për të mbrojtur Qin-in nga ana lindore dhe perëndimore kundër çfarëdo kërcënimi nga Jin-i".

Sovrani i Qin-it kishte mbetur pa asnjë argument nga këto shpjegime gjeniale. Një marrëveshje e heshtur ishte arritur pastaj dhe Qin-i i kishte tërhequr trupat e veta. Duke parë tërheqjen e trupave të Qin-it, dhe duke e pasur të qartë faktin se Cu-ja ishte aleate e Zhengut dhe tashmë Cu-ja do t'i vinte në ndihmë Zhengut nëse kjo mbretëri do të sulmohej, edhe Jin-i i kishte tërhequr trupat e veta menjëherë. Rrethimi i Zhengut kështu kish përfunduar pa asnjë betejë. Ky është një ndër shembujt tipikë në historinë luftarake të Kinës kur një rrethim arrihet të shmangen vetëm falë diplomacisë.

MENÇURIA NË FUSHËBETEJË

Sa i përket parimit të “gjëja tjetër më e udhës për t’u bërë është të sulmohet ushtria”. Kjo gjë nuk do të thotë se ushtria armike duhet mposhtur vetëm me forcë. Faktikisht, maturia dhe mençuria janë skajshmërisht thelbësore në çdo fushëbetejë. Ekzistojnë shembuj të shumtë të nevojës për mençuri strategjike në historinë luftarake të Kinës.

BETEJA NË LUMIN FEISHUI

Në vitin 383 para Krishtit, gjenerali Fu Jian i dinastisë së mëparshme Qin e kishte udhëhequr ushtrinë e tij drejt jugut në një përpjekje për të pushtuar Jinin Lindor. Xie Xuani-i dhe Xie Shi-ja, që ishin gjeneralët kryesorë të Jinit, i kishin urdhëruar ushtritë e tyre që të zinin pozicion në bregun jugor të lumit Feishui për t’i bërë ballë Fu Jianit, ushtria e të cilit (me më tepër se treqind mijë ushtarë) ishte qartësisht më e madhe në numër se ajo e Jinit, që kish vetëm tetëdhjetë mijë ushtarë. Sigurisht që Xie Xuan-i dhe Xie Shi-ja duhej ta mposhtnin armikun falë mençurisë së spikatur.

Analiza e Xie Xuan-it mbi dy ushtritë që përballeshin njëra me tjetrën përgjatë brigjeve të lumit Feishui, tregonte se Fu Jianit i avantazh sa i përkiste numrave, por ndërkaq ushtrinë s’e kish të bashkuar. Këmbësoria dhe kalorësia e tij qenë të përziera dhe pararoja si dhe repartet ndihmëse ishin shumë larg njëra-tjetrës. Për më tepër, gjeneralët e ushtrisë së Fu Jianit nuk dinin të bënin asnjë vlerësim strategjik. Nëse njësitë e pararosjes do të mposhteshin, atëherë fitorja do të ishte në detyrë e lehtë për Jinin Lindor.

Xie Xuan-i kishte marrë me mend se nëse ai do të mund ta sulmonte ushtrinë e Qin-it teksa ajo ishte akoma në

rrëmujë e sipër, atëherë pa dyshim që do të korrte një fitore. Pastaj ai kishte nisur një të dërguar pranë Qin-it, duke u kërkuar atyre që të tërhiqeshin në njëfarë largësie për të bërë të mundur që ushtria e Jin-it të kalonte përmes lumit Feishui për t'u përballur me ushtrinë e Qin-it në një betejë vendimtare. Komandanti i ushtrisë së Qin-it kishte rënë dakort dhe kështu ishte dhënë urdhri për tërheqje. Dhe si pasojë, në tërheqje e sipër njëfarë rrëmuje ishte shfaqur në radhët e ushtrisë së Qin-it, që i detyrohej zinxhirit të dobët komandues të kësaj ushtrie.
Veç kësaj, Zhu Xu-ja, një oficer i ushtrisë së Jin-it i cili i ishte dorëzuar ushtrisë së Qin-it, kishte shfrytëzuar rastin për të krijuar çregullime mes radhëve të armikut, duke bërtitur me të madhe: "Ushtria e Qin-it ka pësuar humbje!" Ushtarët e Qin-it në prapavijë e kishin besuar këtë mashtrim dhe ndërkaq këmbësoria dhe kalorësia kishin filluar të tërhiqeshin. Si rezultat, ushtria e Qin-it kish rënë pre e rrëmujës totale. Ushtria e Jinit, pasi e kish kaluar lumin Feishui, kishte përfituar nga kaosi i armikut, dhe me shpejtësi e kishte sulmuar ushtrinë e qënësishme të mposhtur atë. Fu Jiani, komandanti i ushtrisë së Qin-it, ishte goditur nga një shigjetë, dhe më pas ia kishte mbathur i vetëm në veri të lumit Hui me kalë. Kjo pra, njihet si Beteja e lumit Feishui.

BETEJA E GAIXIA

Një tjetër shembull i zgjuarsisë strategjike në kushte lufte kishte ndodhur në vitin 202 para Krishtit. Sovrani i Hanit Perëndimor i kishte kërkuar marshallit Han Xin që t'i udhëhiqte trupat në Betejën e Gaixia-s kundër ushtrisë së mbretërisë së Cu-së, të komanduar nga Xiang Yu-ja, sovrani i Cu-së Perëndimore. Ushtria e Cu-së ishte qartësisht

tejet e fuqishme, me një forcë goditëse prej më tepër se nëntëdhjetë mijë ushtarësh. Për më tepër, Xiang Yu-ja ishte një njeri trim dhe plot kurajë, dhe askush nga ana e ushtrisë së Hanit nuk guxonte të luftonte përballë tij i vetëm. Pasi e kishte peshuar mirë problemin, Han Xin-i kishte vendosur që të sajonte një skemë. Ushtria e tij kishte përgatitur një pritë në rajonin e maleve Jiulishan. Ai i kishte kërkuar Li Zouche-s që ta tërbonte fare Han Xin-in dhe ta ndillte ushtrinë e këtij të fundit drejt kurthit në fjalë. Për t'i bërë gjërat akoma më keq, Han Xin-i kishte dërguar disa njësi të ndryshme për të luftuar me Xiang Yu-në sipas radhës. Ushtarët e Xu-së kështu as mund të ushqeheshin e as mundeshin të pushonin ndopak. Han Xin-i i kishte përqendruar tërë forcat e veta dhe pastaj kishte luftuar një betejë vendimtare kundër Cu-së.
Gjatë betejës, Xiang Yu-ja kishte rënë në pritë tre herë, dhe atij i ishte dashur ta drejtonte ushtrinë personalisht më tepër se dymbëdhjetë herë duke u përpjekur të largoheshin me këto prita, me humbje tepër të mëdha, përfshirë edhe shumë gjeneralët e tij. Si përfundim, Xiang Yu-së i ishte dashur të jepte urdhër për tërheqje për arsye se ushtarët e tij kishin mbetur pa ushqim dhe përforcime. Han Xin-i i vijoi hapat e këtij triumfi me një ndjekje të beftë, pa i lejuar Xiang Yu-në dhe njerëzit as që të merrnin frymë të qetë. Xiang Yu-ja kishte kryer vetëvrasje duke ia prerë fytin vetes. Kurse pjesa e mbetur e ushtrisë së Cu-së ishte dorëzuar.
Kështu pra, mund të dalim në përfundimin se Beteja e Gaixia-s ishte fituar nga Han Xin-i si rrjedhojë e strategjisë së tij të duhur. Nëse ai do të ishte nxitur ta korrte fitoren vetëm përmes përdorimit të forcës, atëherë rezultati do të kish qenë dukshëm i ndryshëm, pra as largësish nuk do të kishin pasur një dërmim më të plotë të ushtrisë së Cu-së.

PËRMBLEDHJE

Le ta përmbledhim pra atë çfarë kemi mësuar deri më tani lidhur me teoritë e Sun Tzu-së mbi vlerësimet strategjike. Në krye të herës, te *Arti i Luftës* i Sun Tzu-së, ai pohonte se: "Lufta është një çështre me rëndësi jetike për shtetin; një çështje për jetë a vdekje, rruga drejt mbijetesës apo rrënimit. Prandaj, është e domosdoshme që ajo të studiohet me themel". Për këtë arsye, na duhet ta gjykojmë atë mbështetur te pesë faktorët themelorë dhe pastaj të krahasojmë edhe shtatë elementët. Na nevojitet të analizojmë së pari dhe më pas të marrim vendime lidhur me aftësinë për të luftuar, ashtu si edhe përparësitë dhe situatat e pafavorshme të ushtrisë sonë dhe asaj armike. Ajo që kërkohet nga një komandant i zoti, është që: "T'i mposhtë trupat armike, mundësisht pa luftë", dhe ta ngadhënjejë falë vlerësimeve strategjike".
Siç tashmë kemi parë, Sun Tzu-ja mbështeste idenë se në kushte lufte, përgjithësisht qasja më e mirë ka të bëjë me të sulmuarit e strategjisë armike. Gjëja tjetër më e mençur, lidhet me prishjen e aleancave të tij me mjete diplomatike. Pastaj duhet mësymur mbi ushtrinë armike në fushën e betejës, kurse qasja më e gabuar ka të bëjë me rastet kur sulmohen qytetet e armikut. Doktrina e tij na mësonte se lufta nuk është vetëm një çështje punësh ushtarake, por ajo ndërkaq është diçka e ndërlidhur fort me politikën, ekonominë, klimën dhe gjeografinë. Vetëm atëherë kur këta faktorë të jenë shqyrtuar si duhet në mënyrë shteruese, do të jetë e mundur mposhtja e armikut. Ai ishte dakord me marrjen e iniciativës duke goditur i pari në luftë, me betejat e shpejta që do të duhej të shpinin drejt vendimeve të duhura dhe shmangies së luftërave të stërzgjatura.

(Këto përfundime ishin pjekur varësisht nga kushtet politike dhe ekonomike të kohës së Sun Tzu-së.)
Sun Tzu-ja besonte se shteti duhej të përgatiste strategji luftarake, dhe se komandanti përkatës duhej ta organizonte dhe të udhëhiqte personalisht betejën. Me fjalë të tjera, është e nevojshme që të sajojmë një strategji teksa ndodhemi në një pozicion të sigurt udhëheqës, që pastaj do të na sigurojë fitoren në fushëbetejë. Të gjithë faktorët duhet të shqyrtohen në mënyrë praktike dhe realiste pa u ngatërruar asfare me dëshirat apo shpresat tona.
Sun Tzu-ja po ashtu ishte mbështetës i idesë se na duhet ta marrim vetë iniciativën dhe t'i përshtatemi situatës në betejë. Është me rëndësi të jashtëzakonshme aftësia për ta kuptuar pikën nevralgjike të betejës dhe të sulmuarit e armikut pikërisht aty ku ai është më i cenueshëm, duke sjellë kështu një ndryshim vendimtar. Më pas duhet shfrytëzuar sa më mirë situata dhe të udhëhiqet ushtria drejt fitores.
Nevojitet të sajojmet një strategji sipas interesave afatgjatë themelorë të shtetit, jo thjesht sipas përfitimeve të momentit. Është diçka shumë më e koklavitur të sajuarit e një strategjie sesa përpilimi i një plani për betejë. Na duhet të kemi parasysh në horizont shumë më të gjerë veprimi dhe të shqyrtojmë tërë aspektet e pafavorshme ashtu si edhe përfitimet e rastit, dhe të përpiqemi të zhvillojmë dhe gjithaq dhe mëtojmë që t'i shfrytëzojmë gjithë faktorët e favorshëm duke i reduktuar njëkohësisht sa të jetë e mundur negativët. (Është praktikisht e pamundur që të shmangen krejtësisht këta të fundit.)
Së fundi, gjithçka në këtë botë ka pika të forta dhe të dobëta, përparësitë dhe anët e veta të pafavorshme. Ato janë të dyanshme dhe mund të shndërrohen në të kundërtën e thelbit të tyre varësisht nga rrethanat. Por gjithmonë

faktori parësor dhe kyç është ai që bën diferencën në këto raste; kështu që asnjëherë nuk duhet ta humbim përqendrimin duke u marrë me faktorë të një rëndësie shumë të vogël.

KAPITULLI II

QASJA E USHTRISË

Kapitulli i titulluar “Veprimet luftarake” tek Arti i Luftës i Sun Tzu-së përbën një diskutim lidhur me mënyrën se si një ushtri e shfrytëzon pozicionin e saj përpara betejës. Me fjalën “veprime” Sun Tzu-ja nuk kish në mendje formacionet ushtarake apo vendosjen e ushtrisë në fushëbetejë, por qasjen e favorshme strategjike përpara betejës, që pastaj i pamundëson asaj t’u përshtatet rrethanave dhe të jetë më e lëvizshme, dhe ta ndryshojë sa herë të jetë nevoja pozicionin përgjatë zhvillimit të një fushate ushtarake.

Kur diskutohet për “energjinë” dhe “qasjen”, del në pah fakti se Sun Tzu-ja kishte përcaktuar disa kushte paraprake të nevojshme për të arritur të kihet një pozicion i favorshëm:

1. Ajo ushtri që gëzon një epërsi të qartë në trupa dhe armatim.
2. Zënia e terrenit më të favorshëm.
3. Ajo ushtri që ka komandantët më të shkathët, më të mençur, dhe më të aftë për t’i kapur në ajër rastet e favorshme gjatë betejës.

Një qasje e duhur nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me këtë faktor, por gjithsesi buron nga arti i shkëlqyer i udhëheqjes largpamëse në kushte lufte, nga përvoja në fushëbetejë, si dhe nga maturia sa i përket strategjisë dhe taktikave përkatëse

që sajon dhe shfrytëzon një komandant. Sun Tzu-ja theksonte:
“Energjia e trupave që komandohet në mënyrë të zgjuar në betejë, mund të krahasohet me vrullin e gurëve të mëdhenj që rrokullisen nga lartësitë e shpateve të malit... Kur uji i rrebeshtë i merr përpara gurët, kjo ndodh pikërisht për shkak të vrullit të tij të momentit; kur një skifter e godet prenë e tij befasishëm, kjo ndodh për arsye të koordinimit të tij. Kështu që, rrjedhimisht vrulli i veprimeve të drejtuara nga një komandant i zoti, bëhet i pandalshëm atëherë kur sulmi në fjalë është koordinuar si duhet”.
Një komandant i zoti e kërkon fitoren përmes efektit të energjisë së kombinuar dhe nuk kërkon shumë nga trupat e tij. Ai i përzgjedh me kujdes njerëzit e vet dhe më pas ata dinë se si ta shfrytëzojnë situatën. Ai duhet që jo vetëm të jetë tejet i aftë sa i përket përdorimit të vlerësimeve të ndryshme strategjike duke synuar shndërrimin e faktorëve negativë në të favorshëm, por ai gjithashtu duhet të jetë i zoti në të krijuarit e momenteve vendimtare kur vrulli i trupave të tij të bëhet i pandalshëm, si dhe në dhënien e urdhrave të përshtatshëm për ushtrinë, në mënyrë që sulmi pasues të jetë njëkohësisht i beftë dhe skajshmërisht i fuqishëm.
Duke folur në përgjithësi, ata që gëzojnë një epërsi numerike dhe në armatime, zakonisht kanë një qasje më të favorshme. Por ky nuk përbën një rregull universal. Nganjëherë edhe një komandant i një ushtrie më të dobët gjithsesi mund të ketë një qasje më të favorshme nëse ai di se si ta shfrytëzojë situatën varësisht nga asaj që ka në mëngë.
Për shembull, në Kinën jugore, ekziston një kafshë e vogël, një lloj maceje leopard, e së njëjtës madhësi me një mace të zakonshme. Ajo nuk krahasohet dot për nga forca me një tigër, por sërish nuk ngurron të sulmojë e para kur

has ndonjë të tillë. Ajo është po aq e shkathët sa një ketër dhe zakonisht zë pritë majë pemës, dhe më pas papritmas kërcen në shpinën e tigrit, e kap atë për bishti, dhe përdor thonjtë e saj të mprehta për t'ia gërricur atij sytë me forcë. Tigri kërcen përpjetë dhe hungërin nga dhimbja, por e ka të pamundur që ta kapë macen leopard. Zgjedhja e vetme për të është që të zhgërryhet përtokë, moment në të cilin kafsha e vogël ia mbath me të katërta.
Bilbili i ujit është një zog pesëmbëdhjetë centimetrash me pendë të gjelbërta dhe një sqep të mprehtë si gozhdë. Ai zakonisht fluturon mbi ujë. Kur pikas ndonjë peshk, ai i hap krahët dhe përplaset përmbi sipërfaqen e ujit me të gjithë forcën, sikur të ishte një shigjetë. Nganjëherë ai arrin të kapë edhe peshq më të mëdhenj se vetja. Veprimet e bilbilit të ujit qartësisht ilustrojnë pohimin e Sun Tzu-së: "vrulli i sulmuesit është i pandalshëm dhe sulmi saktësisht i koordinuar".

HULMTIMET OPERACIONALE

Në historinë e lashtë kineze, ekziston një tregim për një garë me kuaj midis një sovrani të Qi-së (Qi Wei Wang) dhe gjeneralit Tien Ji, në të cilën Sun Bini e kishte ndihmuar Tien Ji-në që të fitonte duke zbatuar konceptin e "hulumtimit operacional". Sun Bini ishte i vetëdijshëm për faktin se ideja e tij funksionon te, por ai s'kish fare idenë se përse kjo gjë ndodhte.
Tien Ji-ja shpesh bënte gara kuajsh me sovranin e Qisë, por përherë humbiste sepse kuajt e Qi-së ishin më të mirë. Kuajt më të shpejtë të Qi-së vraponin 27,5 kilometra në orë, ndërkohë që kuajt më të shpejtë të Tien Ji-së vraponin 26,5 kilometra në orë; kuajt pak më të ngadaltë të Qi-së vraponin

25,5 kilometra në orë, kurse ato të Ji-së 25 kilometra në orë. Kuajt më të dobët të sovranit 24 kilometra në orë, kurse ato të Tien Ji-së 23 kilometra në orë. Në çdo garë Tien Ji-ja ndërmendte të përdorte të njëjtin lloj kuajsh për të garuar me sovranin e Qisë, por sërish dilte ngaherë i mposhtur. Pasi kish dëgjuar për këtë, Sun Bini i kishte sugjeruar Tien Ji-së që si fillim ai të përdorte kuajt e tij më të dobët për të garuar përballë më të shpejtëve të sovranit të Qisë, në garën e dytë, Tien Ji-ja duhej të përdorte kuajt e tij më të shpejtë për të garuar me kuajt pak më të ngadaltë se më të shpejtët e sovranit të Qi-së, gjë që do të donte të thoshte 26,5 kilometra në orë kundrejt 25,5 kilometrave në orë, një garë që tanimë ai pa dyshim që do ta fitonte. Në garën e tretë, ai do të duhej të përdorte kuajt e tij pak më të ngadaltë se më të mirët syresh, kundër kuajve më të dobët fare të sovranit të Qi-së, pra 25 kilometra në orë kundrejt 24 kilometrave në orë, dhe kështu sërish do të dilte fitues. Në këtë mënyrë Tien Ji-ja do të fitonte dy gara nga tre gjithsej dhe do të shpallej fitues i përgjithshëm i përballjes.
Hulumtimi operacional akoma nuk ka zënë vendin e duhur në fushën ushtarake. Në të ardhmen mund të shndërrohet në një shkencë që të tregojë se si t'i shfrytëzojmë më mirë forcat tona në fushën e veprimeve luftarake.

EFEKTI SURPRIZË

Një komandant që ka mençurinë e duhur dhe kurajën e nevojshme, do të duhej të bënte të pamundurën për të zotëruar momentin e vrullit të pandalshëm, duke arritur kështu të bëjë veprime të befta në një fushë luftarake. Ai nuk duhet të mbështetet vetëm te epërsia e tij ushtarake,

por edhe te faktorët e favorshëm përkatës me qëllim që ushtria e tij të jetë e aftë ta mposhtë armikun falë një lëvizjeje të papritur.

Ekzistojnë shumë shembuj në historinë e ushtrisë kineze përgjatë periudhave të ndryshme të Revolucionit Kinez, kur ajo ishte ndodhur në pozita të pafavorshme strategjike, por që prapëseprapë ia kishte dalë mbanë ta mposhtte armikun duke i përqendruar forcat e veta në sulm. Gjithçka varet nga shkathtësia dhe aftësia e komandantit për t'iu përshtatur rrethanave dhe për të shfrytëzuar një mundësi përkatëse që i lejon atij dhe ushtrisë së tij të gëzojnë një vrull të pandalshëm të momentit, duke vepruar kështu befasishëm. Betejat e Armatës së Parë në Quinghua Bian, Yangmahe dhe Jiquan në vitet 1940 përbëjnë shembuj të qartë të këtillë. Ka edhe shembuj të tjerë të shumtë që mund të merren nga betejat e ushtrive të tjera. Dhe ndërkaq, shumica syresh ngërthejnë të njëjtat karakteristika vijuese:

1. Përshtatshmëri maksimale me terrenin dhe rrethanat sa i përket lëvizjes së trupave dhe zotësi madhore lidhur me shfrytëzimin e mundësive të favorshme për triumfin në betejë.
2. Përqendrimin e forcave për t'i mposhtur armiqtë një nga një.
3. Shpejtësi dhe shkathtësi në lëvizjen e trupave dhe kohë relativisht e shkurtër e kaluar në fushëbetejë.
4. Dërrmim i tërësishëm i armikut me një lëvizje të vetme.

Ekzistojnë shumë faktorë që bëjnë të mundur sendërtimin e një qasjeje të favorshme për një ushtri të caktuar. Për shembull, terreni. Në Kinë ekziston thënia: "Mjafton një njeri i vetëm për ta ruajtur një grykë kalimi që dhjetë mijë të tjerë të mos munden të depërtojnë dot aty".

Gjë që nuk do të thotë tekstualisht se një njeri i vetëm mund të luftojë kundër dhjetë mijëra syresh, por që gjithsesi do të thotë se ai që ka zënë një pozicion të favorshëm mund t'i bëjë ballë sulmit nga dhjetë mijë ushtarë armiq.
Edhe zënia e armikut në befasi, përbën një faktor tjetër të rëndësishëm. Në rastin e Dinastisë së Hanit Lindor, perandori Guangwu e kishte sulmuar prapavijën e ushtrisë së Wang Mangut befasishmt me pesë mijë ushtarët e tij dhe e kishte mposhtur atë. Ja pra një rast tipik ilustrues për këtë.
Të siguruarit e iniciativës dhe të qenët të aftë për t'iu përshtatur rrethanave, përbën një faktor tjetër të rëndësishëm. Për shembull, godisni të parët sa herë që t'ju jepet mundësia, dhe detyrojeni armikun që të qëndrojë pasiv. Sulmoni befas pikërisht aty ku armiku ka pikën e dobët. Përpiquni që të zini një pozicion dominues në terren, i cili ju ofron një fushëpamje të plotë të fushëbetejës.
Sun Tzu-ja ka kishte shkruar në kapitullin e titulluar "Manovrimi: përballja e drejtpërdrejtë dhe e tërtshortë" kështu: "Pranë fushëbetejës ata e presin armikun që vjen nga larg; teksa vetë çlodhen, ata presin një armik të rraskapitur; me ushtrinë e tyre të mirë-ushqyer, ata presin një armik të uritur... Shmangiuni armikut kur shpirtin ai e ka të gjallë dhe sulmojeni atë kur është i amullt dhe trupat e tij i ka zënë malli për vendlindjen... Mos u përballni me një armik që po marshon në mënyrë të koordinuar, as në të tillë formacionet luftarake të të cilit janë sistemuar siç duhet".

PËRMBLEDHJE

Tani pra do të bëjmë një përmbledhje sa u përket mendimeve të Sun Tzu-së mbi veprimet luftarake:
Energjia dhe qasja e favorshme e një ushtrie vijnë si pasojë

e vlerësimeve të duhura strategjike të komandantëve të saj. Një komandant i zoti duhet të tregohet i shkathët në respektimin e parimeve të Sun Tzu-së: "Njiheni thellësisht armikun dhe njiheni gjithasq edhe veten tuaj; dhe më pastaj në qindra beteja, kurrë nuk do të njihni humbje". "Sulmojeni armikun aty ku ai është i pambrojtur dhe zëreni atë në befasi". "Mposhteni armikun tuaj përmes lëvizjeve të befta". "Sulmojeni armikun pikërisht aty ku ai ndihet më i sigurt që nuk do ta sulmoni".

Një komandant i zoti duhet të përpiqet që t'i lëvizë trupat me një vrull të pandalshëm goditës dhe veprime të befta; trupat e tij duhet të spostohen me shpejtësi dhe të luftojnë me kurajë.

Një komandant i zoti duhet të ketë një botëkuptim shterues të kushteve të betejës, dhe të mënyrës se si zhvillohet një fushatë luftarake, si dhe të përçapet të kapë çdo mundësi të favorshme në luftë.

Një komandant i zoti duhet ta ushqejë dhe bëjë të mundur epërsinë e ushtrisë së tij mbi atë armike, në numra dhe cilësi. (Është e vështirë të kihet një epërsi totale, por pasja e përparësive të pjesshme është krejtësisht e mundur.)

Një komandant i zoti duhet të dijë t'i shfrytëzojë terrenet e favorshme për të kompensuar mungesën e ushtarëve (defiçitin numerik). Ky lloj terreni mund të vështirësojë lëvizshmërinë e armikut, duke e vënë atë nganjëherë edhe në pozita fatale për të. Sidoqoftë, nëse një terren i mirë nuk shfrytëzohet si duhet, atëherë rezultatet e betejës do të jenë katastrofike.

KAPITULLI III

FORCAT E JASHTËZAKONSHME DHE ATO NORMALE

Qysh nga koha e botimit të *Artit të Luftës* së Sun Tzu-së, dijetarët e fushës ushtarake kanë formuluar shumë shpjegime lidhur me "forcat e jashtëzakonshme dhe ato normale". Në librin Sun Tzu sipas shënimeve të Njëmbëdhjetë Studiuesve (Botimet Sung Dynasty), njëri syresh, Wei Liaozi, pohon: "Ushtarët që dërgohen të parët për t'u përballur me armikun janë ata më normalët, ndërsa më pas nisen për në fushëbetejë ushtarët e jashtëzakonshëm". Cao Cao-ja po ashtu kishte thënë diçka të ngjashme.
Te Dialogu midis Tangut dhe Lisë, Tang Taizong i thotë Li Jingut: "Ushtarët e mi normalë do t'i dukeshin të jashtëzakonshëm armikut, ndërsa ata të jashtëzakonshmit do t'i dukeshin normalë. Ky është pra ai që quhet 'mashtrim'. Ushtarët e jashtëzakonshëm duken si normalë, kurse normalët duken si të jashtëzakonshëm; ndryshimet pra janë të paparashikueshme".
Li Jingu po ashtu kishte komentuar fitoren në Betejën e Huo Yi-së: "Do të kishte qenë e pamundur që të ngadhënjenim, nëse ushtarët tanë normalë nuk do të ishin shtirur si të jashtëzakonshëm dhe gjithaq edhe ata me aftësi të jashtëzakonshme, sikur të ishin normalë. Për këtë arsye, gjithçka varet nga komandanti, i cili vendos si dhe kur të përdorë një forcë goditëse normale apo të jashtëzakonshme". Duke

komentuar lidhur me këtë tematikë, marshalli Liu Boçeng kishte shpjeguar: "Forcat me aftësi normale dhe ato me fuqi të jashtëzakonshme përbëjnë njësi të kundërta, të cilat çdo gjeneral i mençur duhet të dijë t'i shfrytëzojë si duhet. Te trupat me aftësi të jashtëzakonshme luftarake, ka gjithnjë një gjurmë të forcave me aftësi normale, dhe te normalet, ka përherë diçka të jashtëzakonshme. Me to duhet vepruar në mënyrë të paparashikueshme... Çfarë janë pra forcat me aftësi normale luftarake? Në terma të përgjithshëm, në këtë rast bëhet fjalë për ato forca ushtarake që luftojnë duke respektuar parimet kryesore taktike. Ndërsa ato trupa ushtarake që veprojnë ndryshe dhe që lëvizin befasishmt për ta sulmuar armikun papandehur, janë ato që quhen forcat e jashtëzakonshme".
Sun Tzu-ja nuk i kishte kushtuar një kapitull të veçantë temës së forcave normale dhe atyre të jashtëzakonshme, por ai ndërkaq e kishte përfshirë atë në kapitullin e titulluar "Qasja e ushtrisë" (Veprimet luftarake). Për shembull, ai kishte shkruar: "Ekzistojnë ndryshime të pafundme sa u përket forcave normale dhe të jashtëzakonshme. Ato mbarojnë dhe rifillojnë sërish - në mënyrë ciklike, ashtu siç janë edhe lëvizjet e diellit dhe hënës. Ato veniten dhe më pas rilindin - në mënyrë të përsëritur siç ndodh me stinët njëra pas tjetrës. Përgjithësisht, në betejë, përdorini forcat normale për t'u përballur me armikun, kurse ato të jashtëzakonshmet për ta mposhtur atë. Për këtë arsye, burimet e atyre që janë të zotët sa i përket përdorimit të forcave të jashtëzakonshme, janë po aq të pafundme sa edhe parajsa qiellore dhe toka, po aq të palodhura sa rrjedha e lumenjve të mëdhenj... Është pikërisht falë veprimeve të zgjuara, forcave të jashtëzakonshme dhe atyre normale që ushtri bëhet e aftë të përballojë sulmin pa rrezikuar të pësojë humbje".

Duhet vënë në dukje se përdorimi nga ana e Sun Tzu-së e fjalës "ciklike" lë shteg për hamendësime të tjera lidhur me kuptimin e kësaj fjale, por gjithsesi, një studim i kujdesshëm i kontekstit përkatës, tregon qartas se ai e kishte përdorur këtë fjalë si një metaforë për të përshkruar ndryshueshmërinë dhe paparashikueshmërinë që ndërlidhet me përdorimin e forcave të jashtëzakonshme dhe atyre normale. Ajo pra nuk ka asnjë lidhje me kuptime të tjera dytësore metafizike që mohojnë spiralen zhvillimore të gjithçkaje.

FORCAT E JASHTËZAKONSHME PËRGJATË HISTORISË

Gjatë betejave të ndryshme në historinë e Kinës ka pasur raste të shumta që mund të shërbejnë si shembuj në të cilët fitorja është arritur duke e kapur armikun në befasi.

PAGËZIMI I BUAJVE ME ZJARR

Në vitin 279 para Krishtit, gjenerali i Qi-së, Tian Dian, ishte rrethuar brenda qytetit të Jinio-s. Duke dashur që ta shpëtonte mbretërinë e Qi-së, Tian Diani kishte menduar një plan. Ai kish mbledhur më tepër se një mijë buaj dhe secilin syresh e kishte mbuluar me një cohë shumëngjyrëshe, pastaj kish lidhur kama të mprehta në brirët e tyre dhe kallama të tharë të ngjyer në vaj në bishtat e tyre. Ai kishte mbledhur pesë mijë ushtarë dhe të tërë i kish maskuar si përbindësha. Nëse muzg kur ushtarët e Yen-it ia merrnin të gjithë një sy gjumë, ai ndizte kallamat nëpër bishtat e buajve. Më pas buajt ia krisnin vrapit me të katërta drejt kampit të ushtrisë së Yen-it të ndjekur nga mbrapa nga pesë mijë ushtarët e Tian Dan-it. Ushtria e Yen-it kështu ishte kapur në befasi dhe ish zhytur në kaos. Në këtë betejë, trupat e

Yen-it ishin shfarosur tërësisht, dhe pastaj Tien Dan-i ngadhënjimtar kishte ripushtuar më tepër se shtatëdhjetë qytete me radhë. Mbretëria e Qi-së kështu kish shpëtuar nga pushtimi armik. Kjo betejë do të quhej "Pagëzimi i buajve me zjarr", dhe do të bëhej e famshme si shembull se si kapet armiku në befasi.

FUSHATA PËR T'IA MARRË KRAHËT SHU-SË

Në vitin 263 pas Krishtit, në periudhën e vonë të Tre Mbretërive, gjenerali Deng Ai i mbretërisë së Wei-t kishte marrë urdhër që të sulmonte mbretërinë e Shu-së. Normalisht atyre do t'u ishte dashur që së pari të sulmonin Grykën Jianman. Duke e ditur se kjo grykë ishte tepër e fortifikuar, Deng Ai i kishte udhëhequr dhjetë mijë trupat e tij drejt një krahmarreje të lënë pa rojë të armikut. Ata kishin marshuar përgjatë shtigjeve të ngushta në luginën e malit Yingping, duke depërtuar rreth 320 kilometra në tokë asnjanëse dhe gjithashtu duke gërmuar tunele nëpër male. Kur kishin arritur te mali i rrezikshëm Mage, aty s'kish pasur asnjë shteg të mundshëm kalimi. Kështu që ai e kishte mbështjellur trupin me një cohë dhe ishte rrokullisur teposhtë malit megjithë ushtarët e vet. Pastaj ushtarët e tij kishin zbritur nga shpatet e malit me të shpejtë ia kishin dalë që ta vinin nën kontroll grykën e Jiangou-s, dhe pak më vonë edhe qytetin e Mianzusë. Ata kishin vijuar të përparojnë me shpejtësi dhe kishin arritur në Chengdu në muajin nëntor, duke e zënë armikun në befasi. Liu Shani, gjenerali i Shu-së, ishte detyruar të dorëzohej. Kjo betejë qysh atëherë njihet për befasinë dhe papritshmërinë e saj.

BETEJA E GUAN DU-SË

Në vitin 200 pas Krishtit, trupat e Cao Cao-s dhe të Yuan Shao-s ishin përballur në Guan Du. Trupat e Yuan-it kishin qenë të mirëfurnizuara, dhe rrjedhimisht edhe të afta për të duruar një luftë të stërzgjatur, ndërkohë që trupat e Cao-s kishin mbetur pa furnizime dhe ishin në gjendje vetëm t'i rezistonin një beteje të shpejtë. Cao Cao ishte çoroditur krejt dhe ishte shqetësuar pamasë. Por pikërisht atëherë, Xu You, njëri nga këshilltarët e Yuan-it i cili kishte bërë disa krime dhe që për këtë shkak i druhej dënimit, kaloi në anën e Cao-s i cili ishte treguar shumë mikpritës me të.

Gjatë takimit të tyre, Cao kishte thënë: "Unë dua ta mposht ushtrinë e Yuan-it me një goditje të shpejtë, por mendoj se e kam të pamundur ta bëj këtë për shkak të diferencës së madhe të forcave mes nesh. Kështu që po mendoj të tërhiqem, por njëkohësisht i trembem faktit se mund ta ndjekë ushtrinë time. Prandaj shpresoj fort se mund të më këshillosh për këtë çështje".

Xu-ja e kishte pyetur Cao-n: "Cili mendon se është problemi kyç në fushëbetejë?"

Cao kishte thënë: "Fakti që Yuan Shao mundet fare mirë të durojë një luftë të stërzgjatur, meqenëse furnizimet i ka me shumicë, ndërkohë që ne nuk mundemi për arsye se nuk kemi furnizime".

"Pra problemi kyç qenkan furnizimet", kishte thënë Xu-ja. "Ushtria e Yuan-it i ka stivuar rezervat e veta ushqimore në Wucao, ku ato ruhen nga vetëm pak ushtarë. Pra, duhet ta sulmosh Wucao-n dhe t'ia djegësh rezervat ushqimore, gjë pa dyshim do të mbjellë një kaos të plotë në radhët e ushtrisë së Yuan-it".

Cao Cao e kishte ndjekur këtë këshillë, e kish sulmuar

Wucao-n, dhe i kishte djegur thuajse tërë rezervat ushqimore të ushtrisë së Yuan-it. Kur kishte ardhur ky lajm, trupat e Yuan-it ishin çoroditur totalisht dhe shpejt ishin tërhequr rrëmujshëm. Ushtria e Cao-s nuk ishte ndarë nga pas trupave të shpartalluara të Yuan-it dhe i kishte mposhtur ato përfundimisht. Në një betejë të vetme, qindra-mijëra trupa të ushtrisë së Yuan-it ishin dërmuar krejtësisht. Pastaj, Cao përsëri e kishte mposhtur Yuan-in në Cang Tin.
Si pasojë, Yuan Saho-ja do të vdiste nga një sëmundje. Dy djemtë e tij kishin luftuar njëri me tjetrin për të marrë fronin dhe të dy do të vriteshin nga Cao Cao-ja. Që atëherë, Cao-ja kishte nisur ta konsolidonte bazën e tij në zonën veriore të Rrafshinave Qendrore dhe kishte hedhur kështu themelet e forta për pushtimin e tërë Rrafshinave Qendrore. Kështu pra, çelësi i fitores në një fushatë ushtarake, nganjëherë nuk ka të bëjë me vetë betejën, por me aftësinë për të sajuar strategjitë e duhura. Ky është një tjetër shembull i të zënit të armikut në befasi, që quhet skema e "ndukjes së druve të zjarrit nga poshtë kazanit që vlon".
Këto janë disa shembuj se si përdoren forcat e jashtëzakonshme. Shumë syresh mund të hasen edhe në historinë e Ushtrisë Çlirimtare të Popullit[10]. Falë këtyre shembujve

i buajve me zjarr" ishte sajuar si strategji nga Tian Dao-ja duke synuar çarjen e rrethimit të qytetit Jimo. Për forcat e jashtëzakonshme përdoren përherë për ta zënë armikun në befasi, pavarësisht se në çfarë kohe ndodhin ato. Prandaj mund të pohojmë me bindje të plotë se Deng Ai kishte bërë diçka normale, në suazat e së jashtëzakonshmes, kurse pagëzimi i buajve me zjarr i Tian Dan-it kishte qenë diçka e jashtëzakonshme në suazat e normales.

Gjatë fushatës Hui Hui të nisur nga Ushtria Çlirimtare e Popullit në vitin 1948, përleshjet midis trupave ushtarake kineze dhe armikut, kishin qenë në suazat e normales, por aty gjithsesi kish ndodhur edhe përdorimi i forcave të jashtëzakonshme, njëlloj si pohimi i Sun Tzu-së: "Të rrethohet një vend dhe të dërmohen krejtësisht forcat ndihmëse të armikut", dhe "të inskenohet një sulm i shtirë nga ana e lindjes dhe të sulmohet nga perëndimi". Prandaj pra, dalim në përfundimin se ka pasur gjithmonë një ndryshueshmëri të pandalshme të forcave normale dhe atyre të jashtëzakonshme.

Forcat e jashtëzakonshme dhe normale janë të kundërta dhe të këmbyeshme. Forcat normale mund të shndërrohen në të jashtëzakonshme varësisht nga ndryshimet në fushë-

të tjera që kanë zgjatur për dekada të tëra (luftërat anti-imperialiste dhe anti-feudale të periudhës bashkëkohore). Natyra e këtyre luftërave ka qenë në çdo rast e ndryshme; ashtu si edhe mënyra se si është luftuar në secilën syresh. Por sidoqoftë, shumë nga parimet e Sun Tzu-së dhe dhe teoritë e tij për luftën ishin zbatuar në mënyra të ndryshme në këto konflikte. Për shembull: bërja e vlerësimeve të duhura para se të zbritet në fushëbetejë; zbatimi i përpiktë i vlerësimeve strategjike; zënia e armikut në befasi; marrja e iniciativës në ndeshje; njohja tërësore e armikut dhe e vetvetes; përqendrimi i shumë trupave të tua për të sulmuar njësi më të vogla armike. Me pak fjalë pra, siç kishte theksuar Sun Tzu-ja: "Zotësia në ndryshueshmërinë e taktikave, varet nga truri i mençur".

PËRMBLEDHJE

Për ta përmbledhur mendimin e Sun Tzu-së mbi përdorimin e forcave të jashtëzakonshme dhe atyre normale:
Përdorimi i trupave duhet të jetë i jashtëzakonshëm dhe i ndryshueshëm në mënyrë që armiku ta ketë të pamundur të parashikojë lëvizjet e ushtrisë sate. Sun Tzu kishte thënë: "Lufta ka të bëjë me mashtrimin e armikut". Gjë që do të thotë se gjithmonë duhet të përpiqemi ta çorientojmë kundërshtarin tonë.
Gjithnjë rrekeni ta zini armikun në befasi. Përdorimi trupat tuaja në kohën dhe vendin ku armiku s'e pret këtë gjë. Gjithherë synoni t'i jepni një goditje vdekjeprurëse armikut aty ku ndodhet pika e tij e dobët.
Në të mirë të përdorimit të jashtëzakonshëm të trupave, do të ishte që t'i nisni veprimet luftarake nga një pozicion i patundshëm dhe i pamposhtshëm nga armiku. Dhe pastaj

duhet të tregoheni largpamës, të matur, plot kurajë dhe të kujdesshëm njëkohësisht. Jini të aftë të spostoheni me shpejtësi dhe të përballeni me çdo gjë.
Forcat e jashtëzakonshme dhe normale zotërojnë elementë të këmbyeshëm që ngjajnë fort njëri me tjetrin. Kjo ndodh rëndom në fushën ushtarake. Ju nevojitet që t'u shmangeni parimeve absolute dhe t'u bindeni rreptësisht rregullave që gjenë nëpër librat ushtarakë. Përkundrazi, duhet të tregoheni elastikë në zbatimin e tyre. Kujtoni përherë se nuk ka parime universale që të shpien drejt fitores në çdo përballje.

KAPITULLI IV

ZBRAZËTIA DHE PLOTËSIA

Në kapituj të ndryshëm të Artit të Luftës të Sun Tzu-së, shumë parime të rëndësishme na ofrohen si udhërrëfyes për mënyrën si duhet të lëvizë ushtria. Në kapitullin e titulluar "Zbrazëtia dhe plotësia", Sun Tzu-ja nuk ishte shtjelluar mbi këtë temë. Megjithatë, parimet kryesore të këtij kapitulli janë të pavdekshme. Për shembull, ai kishte vënë në dukje: "Kur jepen udhëzime taktike, rëndësi madhore ka mosdhënia e një forme të përcaktueshme për to. Atëherë edhe vetë spiuni më mendjehollë nuk do të kuptojë dot gjë, e as armiku më i mençur nuk do të mund të përpilojë plane të suksesshme kundër jush... Shfaquni papritmas pikërisht aty ku armikut i duhet të nxitojë për t'u mbrojtur nga ju; shkoni me të shpejtë që ta godisni armikun pikërisht aty ku më pak ai pret që ta sulmoni".
Në kapitullin e titulluar "Manovrimi; përballja e drejtpërdrejtë dhe e tërtshortë", ai kishte shkruar: "Në kushte lufte, mashtrojeni armikun dhe do të siguroni fitoren. Bëni lëvizje taktike vetëm atëherë kur situata është në favorin tuaj. Përqendrojini apo shpërndajini trupat varësisht nga rrethanat. Kur jeni në mes të një fushate luftarake, bëni lëvizje po aq të shpejta sa ç'fryn era; kur marshoni, jini po aq të qetë, madhështorë dhe kompaktë porsi pemët e një pylli; kur mësyrni dhe plaçkitni, jini porsi zjarri; kur fushoni,

jini të qëndrueshëm porsi mali; kur fshiheni, jini të pazbulueshëm porsi retë e shiut të befasishëm; kur godisni armikun, le të bini mbi të porsi rrufe.
"Shmangiuni armikut kur e ka shpirtin luftarak të gjallë, dhe sulmojeni atë kur është i amullt dhe ushtarët e tij i ka zënë malli për shtëpinë. Ky është arti i të kontrolluarit të faktorit moral. Me rregulla të rrepta mes radhëve të ushtarëve tuaj, duhet të përballeni me një armik të çoroditur; me mendjen të kthjellët, t'i dilni para një armiku të amullt. Ky është arti i të kontrolluarit të faktorit moral. Pranë fushëbetejës ai pret një armik që vjen nga larg; teksa vetë çlodhet, ai pret një armik të rraskapitur; me trupat e veta të mirë-ushqyera, ai pret një armik të uritur. Ky është arti i të kontrolluarit të faktorit fizik. Nuk duhet të përballeni në betejë me një armik që marshon në mënyrë të rregullt, dhe as me një armik që i ka shtrënguar radhët e tij. Ky është arti i përshtatjes me ndryshimin e rrethanave".
Në kapitullin e titulluar "Nëntë ndryshoret", ai kishte thënë: "Vërvitini ushtarët tuaj në situata të rrezikshme dhe ata sërish do të mbijetojnë; çojini ata në një terren vdekjeprurës dhe prapëseprapë do të dalin gjallë". Në Kapitullin e titulluar "Planifikimi, vlerësimi i gjendjes", ai kishte vënë në dukje: "Sulmojeni armikun pikërisht aty ku ai është më pak i përgatitur dhe aty ku më pak e pret". Të gjitha këto janë parime të rëndësisë së veçantë në kushte lufte.
Në Kinën e lashtësisë shumë libra mbi artin e luftës merreshin me temën e zbrazëtisë dhe plotësisë. Në disa syresh ato krahasoheshin me "yin-in" dhe "yang-un"[11], që domethënë se "zbrazëtia" është "yin", pra diçka false, dhe "plotësia" është "yang", pra diçka e vërtetë. Kjo analogji gjithsesi

[11]Sipas filozofisë kineze, mënyra se si forcat e kundërta janë faktikisht plotësuese njëra me tjetrën

është e gabuar, ose së paku jo e saktë. Siç qëndron vërtet puna, ndonjëherë ka veprim real edhe te "zbrazëtia", por shumica e veprimeve të këtilla janë thjesht dredhi. Ka veprime ose lëvizje që duket sikur ngjizen te dobësia, por ato synojnë ta mashtrojnë dhe ta fusin në kurth armikun.

ZBRAZËTIA DHE PLOTËSIA NË KUSHTE LUFTE

Përgjithësisht, çdo lëvizje "zbrazëtie" duhet të jetë përmbajtësore në mënyrë që të mos dalim të mposhtur në betejë. Gjithçka do të ketë qenë vetëm një aventurë e kotë nëse nuk keni mbështetjen e duhur. Sa u përket çështjeve ushtarake, ka edhe gjëra konstante (diçka solide, aktuale) dhe ndryshore (të zbrazëta). Në vija të përgjithshme, konstantet mbizotërojnë.
Më poshtë do të mund të gjeni disa shembuj në kushte lufte për të shtjelluar idenë e "zbrazëtisë dhe plotësisë".

SKEMA E QYTETIT TË ZBRAZËT

Gjatë periudhës së Tre Mbretërive, mbretëria e Shu-së kishte humbur Jietungun ndaj mbretërisë së Wei-t. Pak më vonë, ushtria e Wei-t, nën udhëheqjen e Sima Yi-së, kishte marshuar menjëherë drejt Qytetit të Perëndimit, që përbënte një nyje të rëndësishme strategjike të pambrojtur si pasojë e ushtrisë së mangët të Shu-së. Zhuge Liangu e dinte fort mirë se nuk mund t'ia lejonte vetes humbjen e Qytetit të Perëndimit, gjë që do të sillte një kolaps të plotë të ushtrisë së Shu-së. Duke qenë krejt i vetëdijshëm për faktin se Sima Yi-ja ishte një njeri tepër dyshues dhe burracak, Zhuge Liangu kish vendosur të krijonte iluzion të mençur, atë të një qyteti krejtësisht të zbrazët, gjë që e kishte

trembur në palcë Sima Yi-në duke e bërë atë të tërhiqet bashkë me ushtrinë e tij trembëdhjetë kilometra më tej. Ky variant i kishte dhënë kohë Zhuge Liangut për të rezistuar gjersa të vinin përforcimet.
"Skema e Qytetit të Zbrazët" nuk përmendet në librat e historisë, por për të flitet në shënimet e Historisë së Tre Mbretërive. Edhe nëse kjo histori nuk do të ishte e vërtetë, ajo sërish do të kishte vlerat e saj. Ajo na tregon se si ta përdorim "zbrazëtinë" dhe "plotësinë" në kushte lufte. Në këtë shembull, Zhuge Liangu e kishte përdorur formën e "zbrazët" për t'u shtirur sikur kishte mbështetje të sigurt, që në fakt i mungonte. Ai ia kishte arritur qëllimit për ta trembur për vdekje ushtrinë e Sima Yi-së. Por gjithsesi, meqë kjo gjetje gjeniale, nuk kishte mbështetjen e duhur ushtarake, atëherë ajo mund të cilësohet si një qasje aventurese.

BETEJA E SHIJIAZHUANIT

Ekziston një shembull i vonë që lidhet me zbrazëtinë dhe plotësinë në historinë e Ushtrisë Çlirimtare të Popullit. Në tetorin e vitit 1948, gjenerali i Kuomintangut Hu Yi e kishte përqendruar Armatën e tij të 94-të dhe tre divizione të tjera, përfshirë edhe mijëra mjete transporti, në një përpjekje për t'i dhënë një goditje të shpejtë Shijiazuanit, që në atë kohë mbrohej nga vetëm dy garnizone dhe regjimente stërvitje të UÇP-së. Për më tepër, kishte edhe tre regjimente të armatës lokale të UÇP-së që e bllokonin përparimin e Kuomintangut në veri drejt Qarkut të Wuan-it. Duke pra qartë se ishte e pamundur të ndalej ky sulm. Për këtë arsye, komandantët e zonës ushtarake të Jingcaji-t kishin menduar një variant të ri të "skemës së qytetit të zbrazët" dhe kishin marrë masat e mëposhtme.

Pikësëpari, zëdhënësi i UÇP-së për këtë zonë ushtarake, kishte deklaruar në radio se ata ishin në dijeni për qëllimin e Kuomintangut për të sulmuar Shijiazhuanin, si dhe që ishin të përgatitur si duhet për t'u përballur me të. Ai gjithasq kishte lënë të kuptohet se nëse ushtria armike do të sulmonte, atëherë armatët nuk do të ishin më të aftë për t'u tërhequr, gjer që shpërfaqte botërisht forcën e madhe imagjinare të UÇP-së. Hu Yi-ja e kish dëgjuar me vëmendje transmetimin radiofonik të kësaj deklarate, dhe më pas e kishte lexuar atë me shkrim. Ai ishte një njeri me të njëjtin karakter si të Sima Yi-së - dyshues dhe burracak. Ai ishte bërë menjëherë ngurrues dhe i kish kërkuar trupave të tij që të përparonin me kujdes. Si përfundim, përparimi i ushtrisë së tij ishte ngadalësuar mjaft.
Më pas, komandanti i zonës ushtarake i kishte urdhëruar njësitë lokale që ta frenonin përparimin armik sa më gjatë të ishte e mundur në veri të Qarkut Wuan. Ai po ashtu u kishte dhënë urdhër trupave mbrojtëse të Shijiazuanit që të ngrinin fortifikime përgjatë lumit Futou, në mënyrë që të tregohej haptas se ishin të përgatitura për t'i bërë ballë një sulmi. Në ndërkohë, komandanti i kishte urdhëruar ushtrisë që të qëndronte pak më poshtë Changjiakou-t që të lëviznin drejt jugut për t'i ardhur në ndihmë Shijiazhuanit. Dhe së fundi, komandanti i kishte urdhëruar autokolonën e gjashtë të shpartallonte Divizionin e 49-të të dërguar nga Yen Xishan-i për të ndihmuar Hu Yi-në në sulmin e tij ndaj Shijiazhuanit, duke ia ndërprerë kështu furnizimet Hu Yi-së.
Disa ditë më vonë, Hu Yi-në e kish zënë shqetësimi, ishte thellësisht i mërzitur dhe shumë ngurrues lidhur me drejtimin nga duhej të shkonte. Ai i kishte dhënë urdhër forcave të tij ajrore që të kryenin disa misione zbuluese përmbi Shijiazhuan dhe kishte zbuluar se UÇP-ja po ngrinte

fortifikime përgjatë lumenjve Futou dhe Sha (faktikisht, bëhej fjalë për fortifikime të rreme), dhe vetë qyteti i Shijiazhuanit dukej i qetë.
Tri ditë më pas, Hu Yi-ja kishte urdhëruar sërish misione ajrore zbuluese dhe kishte zbuluar se trupat e UÇP-së po lëviznin drejt jugut pranë Qarkut Yi për t'i ardhur në ndihmë Shijiazuanit, në kolona të gjata njëqind e gjashtëdhjetë kilometra. Ai kishte përllogaritur se mund të bëhej fjalë për tetëdhjetë mijë gjer në njëqind mijë ushtarë nga trupat e sulmit të armatës së UÇP-së. Hu Yi-ja kishte menduar se përforcime do të arrinin në destinacion para se të shkonte aty ushtria e tij. Në ndërkohë, ai kishte mësuar edhe për shpartallimin e divizionit të 49-të të dërguar nga Yen Xishan-i. Si përfundim, ai kishte hequr dorë nga sulmi i planifikuar mbi Shijiazuan dhe kështu qyteti kishte shpëtuar nga e keqja.
Për mbrojtjen e tij, UÇP-ja kishte sajuar një "skemë të qytetit të zbrazët", që në të vërtetë ishte e dobët, por në pamje të jashtme rrethohej me fuqishme mjaftueshëm sa për ta ngadalësuar përparimin armik. Në të njëjtën kohë, ata u kishin dhënë urdhër trupave që të zbrisnin në veri për ta përforcuar mbrojtjen e Shijiazhuanit. Përdorimi i kësaj skeme nga ana e Zhuge Liangut, kishte qenë dikur tepër aventuriere, por meqenëse në rastin e Betejës së Shijiazhuanit, mbrojtësit e qytetit kishin mbështetjen e duhur, atëherë në këtë kjo skemë mund të quhej fare e sigurt.

BETEJA E GRYKËS MALIN

Në vitin 341 para Krishtit, mbretëria e Wei-t kishte dërguar trupa nën komandën e Pong Juan-it për të sulmuar Hanin. Hani kishte rezistuar me gjithë trupat e tij dhe ish

përleshur me armikun në pesë beteja, por gjithsesi ishte mposhtur. Atëherë Hani kishte kërkuar ndihmë nga Qi-ja. Sovrani i Qi-së kishte dërguar trupa në ndihmë të Hanit nën udhëheqjen e Tian Ji-së dhe Sun Binit si shefin e tij shtabit. Trupat e Qi-së kështu kishin përparuar drejt Ta Liangut, kryeqytetit të Wei-t duke e detyruar ushtrinë e Wei-t të tërhiqej nga Hani.
Sovrani i Wei-t e kishte kuptuar shumë mirë faktin se Qi-ja përbënte një kërcënim serioz për Wei-n, dhe se kurrë vendi i tij do të gjente paqe nëse Wei nuk mposhtej. Atëherë ai kishte vendosur t'i përqendronte të gjitha trupat e tij goditëse me Pong Juan-in në dhe Princin Shen në komandë, në një betejë vendimtare me Qi-në.
Të vetëdijshëm për këtë, në mbretërinë e Qi-së kishin vendosur të mos luftonin me Wei-n. Sun Bini e kishte këshilluar Tian Ji-në: "Trupat e Wei-t janë të famshme për trimërinë e tyre të spikatur dhe zakonisht i shohin me përbuzje nga lart-poshtë ushtarët tanë të Qi-së. Ne do të duhej të bëjmë sikur u druhemi atyre. Sipas Artit të Luftës së Sun Tzu-së, në një marshim të lodhshëm prej 50 kilometrash, vetë komandanti i pararojës nuk do t'ia dalë mbanë, kurse pas 25 kilometrash vetëm gjysma e ushtrisë ka për të arritur në destinacion. Ai kishte sugjeruar që ushtria e Qi-së të zmbrapsej me qëllim që të tërhiqte si me karrem armikun brenda territorit të saj, dhe njëkohësisht ta shtonte numrin e ushtarëve në radhët e saj, duke e pakësuar ndërkaq numrin e stufave për gatim. Me fjalë të tjera, ushtria e Qi-së si fillim duhet të shtirej sikur ishte e dobët dhe pastaj të gjente momentin e duhur për ta zënë armikun në befasi. Tian Ji-ja e kishte pranuar këtë sugjerim.
Ushtria e Wei-t i kishte ndjekur trupat e Qi-së përgjatë tërë rrugëtimit, dhe zbuluesit e Wei-t kishin raportuar ditën

e parë se ushtria e Qi-së kishte njëqind mijë stufa gatimi; ditën e dytë, pesëdhjetë syresh; ndërsa ditën e tretë, vetëm njëzet stufa. Pong Juan-i kështu kishte pandehur se nga ushtria e Qi-së kishte shumë dezertorë, ndaj dhe e kishte urdhëruar ushtrinë e tij të marshonte përpara edhe më nxitimthi. Ai personalisht kishte udhëhequr disa mijëra ushtarë duke përparuar në thellësi të territorit armik ditë e natë pandalur. Kur kishte arritur bashkë me trupat e tij te Gryka Malin, ai kishte rënë në pritën e ngritur nga ushtarët e Qi-së dhe kish pësuar një shpartallim total. Vetë Pong Juan-i kishte rënë rob. Pastaj trupat e Qi-së kishin mësyrë edhe drejt Princit Shen dhe njerëzve të tij, duke shfrytëzuar vrullin e pandalshëm të momentit, dhe e kishin zënë rob edhe atë. Që atëherë, Qi-ja do të shndërrohej në mbretërinë më të madhe të veriut. Ky pra, është një shembull tipik i përdorimit të formës së "zbrazët" të veprimit, ndërkohë që disponohen të gjitha forcat e duhura.

PËRMBLEDHJE

Për të përmbledhur konceptin e Sun Tzu-së mbi zbrazëtinë dhe plotësinë:
Sa i përket përdorimit të trupave, duhet të ketë gjithmonë elemente të këmbyeshme "plotësie" te "zbrazëtia", si dhe "zbrazëtie" te "plotësia". Normalisht, është më e thjeshtë të përdoret forma e "zbrazët" ndërkohë që nuk na mungojnë forcat e duhura, sesa kur ato na mungojnë vërtet. Është tepër e rëndësishme të njihen karakteristikat e armikut dhe komandantit të tij. Po ashtu ka rëndësi të madhe njohja e pikave të forta të komandantëve tuaj në mënyrë që të mund t'u caktoni atyre detyrat që u shkojnë më përshtat me aftësitë individuale.

Kur synoni të përdorni metodën e "zbrazëtisë", bëjeni këtë gjë në mënyrë të arsyeshme, por sidoqoftë duhet të keni edhe mbështetjen e duhur prapakrahëve (ndryshe nga lëvizja aventureure e Zhuge Liangut me "Skemën e Qytetit të Zbrazur"). Nevojitet që patjetër ta keni iniciativën në duart tuaja, dhe të ndërmerrni veprime të mirëmenduara. Kur doni të shtireni sa për t'u dukur, bëjeni këtë në mënyrë të mençur dhe të arsyeshme me qëllim që armiku ta hajë karremin. Përpiquni po ashtu që ta ndillni armikun drejt thellësisë së territorit tuaj.
"Zbrazëtia" dhe "Plotësia" janë të këmbyeshme dhe të kufizuara në kohë. Shpesh është e vështirë të pikasen detajet e rëndësishme në ndryshimet e situatës së armikut. Për këtë arsye, rëndësi thelbësore ka që të kihen komandantë të mençur, të hedhur, që dinë t'u përshtaten ndryshimeve të rrethanave, të guximshëm dhe të kujdesshëm.

KAPITULLI V

INICIATIVA DHE LAKUESHMËRIA NË KUSHTE LUFTE

Sun Tzu-ja i kushtonte rëndësi të veçantë fitimit të iniciativës në një përballje të armatosur. Parimet e tij të marrjes së masave parandaluese, të të luftuarit të një beteje të shpejtë për ta detyruar armikun të marrë një vendim po aq të shpejtë, të ndjekjes së armikut drejt fushëbetejës në vend të të qenët i detyruar prej tij të zbresësh aty, të gjitha kanë të bëjnë me marrjen e iniciativës në kushte lufte.

Mao Ce Dun ka thënë: "Humbja e iniciativës është e barabartë me të qenët i mposhtur, i shpartalluar". Mao Ce Duni ishte mbështetës i idesë se në betejë duhet ta çosh armikun aty ku do ti, dhe jo të vraposh pas tij. Ai mendonte se ishte më e udhës të fitohej mjeshtëria e luftës duke e goditur armikun vetëm pasi ai ta kish bërë lëvizjen e parë, në mënyrë që të mund ta dalloheshin pikat e dobëta të tij.

Iniciativa gjithashtu do të thotë lëvizshmëri dhe lakueshmëri për ushtrinë. Domethënë se atëherë kur ushtria sulmon, ajo duhet të jetë e papërmbajtshme; kur ajo mbrohet, duhet të jetë e pathyeshme; ndërsa kur tërhiqet, armiku as që duhet të guxojë ta ndjekë nga pas. Ka shumë përkufizime të rëndësishme në lidhje me këtë të Arti i Luftës i Sun Tzu-së.

Në kapitullin e titulluar "Zbrazëtia dhe plotësia", Sun Tzu-ja shkruante: "Ushtria mund të krahasohet me ujin,

meqenëse uji në rrjedhën e tij natyrshme i shmang lartësitë dhe nxiton teposhtë. Kështu pra, në luftë, një ushtri do të duhej ta shmangte forcën dhe të godiste vetëm dobësitë. Ashtu si uji e formëson rrjedhën e tij varësisht nga natyra e terrenit, gjithaq një ushtri arrin të ngadhënjejë varësisht nga armiku me të cilin përballet. Ashtu si uji nuk e ruan një formë të vazhdueshme, edhe në luftë nuk ka rrethana dhe kushte të ngurta. Një komandant që ia dal mbanë t'i modifikojë taktitkat e tij varësisht nga situata e armikut dhe që më pastaj korr fitoren, pa dyshim mund të quhet si njeri me aftësi hyjnore".
Në lidhje me "Manovrimin", ai thekson: "Në kushte lufte, vini në zbatim dredhitë dhe do të korrni fitoret. Lëvizni vetëm kur kushtet janë të favorshme për ju. Përqendrojini apo shpërndajini trupat varësisht nga rrethanat".
Duke shkruar mbi "Terrenin", Sun Tzu-ja kishte thënë: "Gjenerali me përvojë në çështjet e luftës, në momentin që nis të marshojë e ka të qartë se cili është destinacioni dhe nuk e lë kurrë veten të hutohet; në momentin që ai vendos të veprojë, burimet e tij bëhen të pakufishme dhe taktitkat e tij të ndryshueshme. Prandaj, unë pohoj: "Njiheni armikun tuaj, njiheni vetveten, dhe pastaj fitoria juaj kurrë nuk

gjeneral që nuk arrin t'i kuptojë përparësitë e nëntë faktorëve të ndryshueshëm, nuk do të jetë i aftë ta përdorë terrenin sipas interesave të veta, sado mirë që ta njohë atë. Një gjeneral që i udhëheq trupat e veta dhe që nuk arrin t'i kuptojë taktitkat e përshtatshme për nëntë situatat e ndryshme, rrjedhimisht do ta ketë të pamundur t'i përdorë trupat në mënyrën e duhur, edhe nëse ai i kupton si duhet 'pesë përparësitë'". Ai nënvizon në këtë kapitull: "Për këtë arsye, një gjeneral i zoti, kur jep urdhërat përkatëse gjithmonë shqyrton njëkohësisht faktorët e favorshëm dhe të pafavorshëm. Duke shqyrtuar faktorët e favorshëm, ai arrin ta bëjë të realizueshëm planin e vet; kurse duke marrë në shqyrtim faktorët e pafavorshëm, ai gjithsesi gëzon mundësinë e shmangies së ndonjë katastrofe ushtarake".
Te "Nëntë terrenet e ndryshme" ai vë në dukje: "Komandanti i mençur mund të krahasohet me shuairan, një lloj gjarpri që gjendet në malet Chang. Kur këtë gjarpër e godasin në kokë, atëherë ai sulmon me bisht; kur ia godasin bishtin, atëherë sulmon me kokë; kur ia godasin trupin, atëherë ai sulmon si me kokë, ashtu edhe me bisht... Për këtë arsye, shpërfaqni ndrojtjen e një çupëline, deri kur armiku ta humbë vigjilencën dhe t'ju mundësojë një shteg depërtimi, dhe më pas lëvizni po aq shpejt sa një lepur, kështu armiku do ta ketë të pamundur t'ju bëjë ballë". Njëkohësisht me të qenët të vetëdijshëm lidhur me mënyrën e duhur se si duhet udhëhequr ushtria, dhe mbi forcat e jashtëzakonshme dhe ato normale, megjithatë nevojitet gjithashtu që të dimë të marrim iniciativën dhe të jemi të lakueshëm lidhur me përdorimin e trupave. Sun Tzu-ja mençurisht kishte vënë në dukje: "Ashtu si uji nuk ruan formë të vazhdueshme, ashtu edhe në kushte lufte nuk

ka rrethana të qëndrueshme". Me këtë ai nënkuptonte se nuk ekzistojnë formula të paracaktuara në lidhje me përdorimin e trupave. Pa dyshim që do të dalim të humbur nëse rrekemi që të zbatojmë një mënyrë të caktuar luftimi në situata të ndryshme, ose nëse përpiqemi të përdorim një taktikë të caktuar që është sajuar si pasojë e një shembulli përkatës, në kushte betejash të vështira. Mënyra se si përgatitet një fushatë e përshtatshme për zona malore dhe të pyllëzuara, mund të mos jetë e përputhshme me rrafshinat dhe anasjelltas. Prandaj, do të ishte e udhës që të përpiqemi të sajonim mënyra të reja të luftuari varësisht nga zhvillimet e çdo situate praktike që na paraqitet.

Parimi më i rëndësishëm sa i përket udhëheqjes së një lufte është se nuk ekzistojnë shtigje të shkurtra për t'ia marrë asaj dorën. Në fushën e betejës, ngjarjet ndryshojnë me shpejtësi dhe shpesh qëllon që të duken si të paparashikueshme. Faktikisht, nëse përdorim teorinë e materializmit dialektik[12] lidhur me vëzhgimin dhe analizimin e vetë thelbit të luftës, atëherë do të zbulonim se në pozita mbrojtëse apo sulmuese, me forca të forta apo të dobëta (qoftë) secila çështje ka dy anë, të cilat janë thellësisht të ndërlikuara dhe vetëshndërrohen në të kundërtën e vetvetes varësisht nga disa kushte të caktuara. Për këtë arsye, vetëm atëherë kur komandanti përkatës i hyn luftës, i jepet atij mundësia të depërtojë gjer në faktorët objektivë që mundësojnë shndërrimin e të kundërtave, dhe të shmangë dëmet e mundshme duke marrë vendime që shpien drejt fitores.

---

[12] Sipas teorisë marksiste dhe filozofisë zyrtare të komunistëve sovjetikë, që i përshkruan ngjarjet politike dhe historike si pasojë e konfliktit të forcave sociale, që më pas mund të interpretohen si një sërë kundërshtish dhe zgjidhjet e tyre përkatëse.

SHKATHTËSIA, EGËRSIA DHE SHPEJTËSIA NË KUSHTE LUFTE

Mbi këtë, marshalli Liu Boçeng nënvizon lidhur me shkathtësinë, egërsinë dhe shpejtësinë. Ai kishte thënë: "Lakueshmëria e duhur në përdorimin e trupave reflektohet përmes marrjes së masave të aspektit të 'zbrazët' dhe 'plotësisë' në mënyrë të shkathtë, si për shembull të bërit e një dredhie nga ana lindore dhe të sulmuarit nga ana perëndimore, ndryshimet lidhur me forcat e jashtëzakonshme dhe ato normale, hutimin e armikut sipas nevojave tuaja dhe aftësinë për ta bërë atë të kafshojë karremin tuaj, si dhe mundësinë për të sulmuar pikërisht atëherë kur armiku ndihet më i sigurt dhe ku ai më tepër s'e pret".

BETEJA E LUMIT CHESHUI

Një nga veprat më të vlerësueshme të Mao Ce Dunit kishte qenë iniciativa dhe aftësia e tij e spikatur për t'u përshtatur me rrethanat gjatë udhëheqjes së luftës. Ai shpesh e mposhte armikun me lëvizje të befta. Beteja e lumit Cheshui gjatë Marshimit të Gjatë përbën një shembull tipik të këtillë.

Lumi Cheshui endet përmes kufijve të provincave të Yunnan-it, Guizhou-t dhe Siçuanit. Në janar të vitit 1935, Mao Ce Duni kishte vendosur që Ushtria e Kuqe duhej të marshonte në drejtim të veriut nga Zunyi (duke përshkuar Tongzi-n, Songkan-in dhe Tucheng-un) dhe pastaj ta kalonin lumin Cheshui. Armiku ishte shqetësuar se tëpërmi nga kjo lëvizje taktike. Ushtria Qendrore që i ishte vënë pas Mao Ce Dunit, si dhe trupat rajonale të provincave të Siçuanit, Guizhou-t dhe Hunanit, me nxitim ishin përqendruar në atë zonë në një përpjekje për ta rrethuar Ushtrinë e Kuqe.

I vetëdijshëm se tashmë ishte bërë e pamundur të kalohej lumi Jance, Mao Ce Duni i kishte dhënë urdhër Ushtrisë së Kuqe që të mblidhej në atë zonë dhe të priste rastin e duhur. Kur ai kishte zbuluar se armiku në provincën Guizhou ishte i dobët, e kishte urdhëruar menjëherë ushtrinë që të përparonte befas nga ana perëndimore, duke e kaluar lumin Cheshui sërish, dhe ishte kthyer mbrapsht për të sulmuar prapë Tongzi-n dhe Zunyi-n (të dy në provincën e Guizhou). Gjatë marshimit Ushtria e Kuqe kishte shpartalluar njëzet regjimente armike. Jiang Jieshi ishte acaruar se tepërmi nga humbja dhe i kish lëvizur sërish trupat në një përpjekje të re për ta rrethuar Ushtrinë e Kuqe në zonën e Zunyi-së.
Duke dashur t'i çorodiste dhe pastaj t'i shtynte të lëviznin trupat armike, Mao Ce Duni i kishte dhënë urdhër Ushtrisë së Kuqe që të marshonte përmes lumit Cheshui për herë të tretë në Maotai; pastaj ai kishte përparuar në drejtim të veriut për në Siçuanin jugor. Si kishte pikasiur këtë lëvizje, Jiang Jieshi kish pandehur se Ushtria e Kuqe do ta kalonte prapë lumin Jance dhe do të bashkohej me Armatën e Frontit të Katërt. Kështu që ai i kishte urdhëruar trupat rajonale të Siçuanit, Guizhou-t dhe Hunanit, ashtu si edhe Armatën Qendrore që ta rrethonin Ushtrinë e Kuqe sërish në një përpjekje për ta dërrmuar atë me një goditje të vetme.
Duke gjykuar se tanimë armiku ishte vënë në lëvizje sipas planit të tij, Mao ce Duni e kishte devijuar drejtimin e Ushtrisë së Kuqe, duke e kthyer atë papritmas nga lindja, dhe duke e kaluar lumin Cheshui për të katërtën herë, dhe, me një marshim të shpejtë anësh krahut të djathtë të trupave armike, kishte kaluar edhe mespërmes lumit Wujiang dhe kishte marshuar në drejtim të Guiyang-ut (kryeqyteti i

Gouzhou-t). Teksa pjesa kryesore e trupave të Ushtrisë së Kuqe shtireshin sikur do të sulmonin kryeqytetin, të tjera trupa kishin depërtuar me forcë në zonën midis Guiyang-ut dhe Lungli-së, duke përshkuar rrugën automobilistike Hunan-Guizhou, dhe përparuar drejt Kuanmingut (kryeqyteti i provincës së Yunnan-it).
Pasi kishin zbuluar se kundërshtari ua kishte hedhur, trupat armike kishin marshuar 480 kilometra për të vajtur mbrapsht në mbrojtje të Kuanmingut. Në këtë kohë, Ushtria e Kuqe tashmë e kish kaluar lumin Jingsa me shtatë varka të vogla për shtatë ditë dhe net, duke arritur në Huili në Siçuan. Kështu pra, Ushtria e Kuqe e kish çliruar veten nga ndjekja dhe taktitkat rrethuese të trupave të Kuomintangut duke e arritur kështu me sukses qëllimin e saj strategjik të kalimit të lumit Jance dhe të vajturit në Kinën veriore.
Përmes këtij shembulli, ne shohim fare qartë përdorimin mjeshtëror nga ana e Mao Ce Dunit i taktikave të përputhshme me rrethanat, si dhe një shembull të shkëlqyer të artit të luftës. Ai i kishte udhëhequr veprimet e Ushtrisë së Kuqe me aftësi të mrekullueshme, shpesh shumë përtej pritshmërive të armikut. Ushtria e Kuqe kishte humbte tërësisht toruan, të mëdhenj, duke e bërë armikun ta humbte tërësisht toruan, duke e kapitur atë dhe më në fund, duke shpëtuar nga ndjekja e tij.
Shembulli i Mao Ce Dunit shërben mjaft mirë për të ilustruar rëndësinë e përzgjedhjes së gjeneralëve të duhur. Një komandant i papërshtatshëm mund t'ia dalë mbanë në një betejë, por mund ta humbë luftën në përgjithësi. Kjo ndodh për shkak se ai nuk di t'u përshtatet ndryshimeve radikale në fushëbetejë dhe, rrjedhimisht, e ka të pamundur t'i vërë në zbatim qëllimet e tij të epërme strategjike. Për shembull, gjatë periudhës së Tre Mbretërive, Zhuge

Liangu fare mirë mund të cilësohet si një shef shtabi i aftë që ishte fort i zoti sa i përket planifikimit taktik, por ai kishte bërë gabim kur e kishte caktuar Ma Su-në si komandant për mbrojtjen e Jie Ting-ut. Ma Su-ja zotëronte ca njohuri ushtarake; megjithatë, atij i mungonte krejtësisht aftësia për ta marrë në dorë situatën e përgjithshme, dhe po ashtu atij i mungonte përvoja e duhur në përdorimin e trupave për ta marrë në dorë situatën e përgjithshme me ndryshimin e rrethanave. Ai ishte, në fakt, tepër pedant.

BETEJA E JINGZHOU

Gjatë periudhës së Tre Mbretërive, Jingzhou-ja ishte pushtuar nga mbretëria e Shu-së dhe kontrollohej nga gjenerali i famshëm Guan Yu. Mbretëria e Wu-së ishte rrekur ta rimerrte Jingzhou-n, por nuk ia kish dalë dot mbanë. Në vitin 219 pas Krishtit, sovrani i Wu-së, duke iu bindur këshillës së gjeneralit Lu Meng, kishte bërë një marrëveshje me Cao Cao-n për ta sulmuar Jingzhou-n nga veriu dhe jugu njëkohësisht (ushtria e Cao-s nga veriu, të udhëhiqej nga gjenerali Cao Ren; kurse ushtria e Wu-së nga jugu, do të komandohej nga Lu Sun-i).
Si fillim, ushtria e Lu Sun-it udhëhiqej nga Lu Mengu, që njihej gjerësisht për mprehtësinë e tij të madhe dhe guximin e pashoq. Guan Yu-ja ishte më i kujdesshëm lidhur me të. Lu Mengu kishte sajuar një skemë për ta ndjellur armikun jashtë strofullës së tij. Ai bëri sikur do të kthehej në Jianye për shkak se gjasmë ishte sëmurë dhe kishte rekomanduar që vendin e tij ta zinte Lu Sun-i. Kur Guan Yu-ja kishte dëgjuar këtë lajm, ai ishte ndier i lehtësuar. Duke menduar se Lu Sun-i ishte një gjeneral i ri pa ndonjë përvojë të veçantë luftarake, Guan Yu-ja e kishte sulmuar

Shangyang-un dhe Fancheng-un në veri me trupat e tij elitë të drejtuara prej tij personalisht, duke e lënë kështu Mi Fangun dhe Fu Shirengun në mbrojtje të Jingzhou-s.
Kur Lu Mengut i kishin ardhur këto lajme, ai e kishte kuptuar se skema e tij kishte dalë e suksesshme. Atëherë ai kishte urdhëruar disa qindra ushtarë të maskuar si tregtarë që të shkonin në kufirin midis mbretërisë së Zhuge dhe mbretërisë së Wu-së dhe të sulmonin fortesat përgjatë brigjeve të lumit me shumë trupa, duke i detyruar Mi Fangun dhe ushtarët e tij që të dorëzohen. Sidoqoftë, përparimi nga drejtimi i veriut i trupave të Guan Yi-së vazhdonte pa probleme. Ata kishin pushtuar Xiangyang-un dhe kërcënonin edhe qytetin e Fancheng-ut. Yu Jing-u dhe Pang De-ja, gjeneralët kryesorë të Cao Cao-s, kishin rënë rob të dy, dhe shumica e trupave të tyre ishin shpartalluar. Cao Cao-n e kishte zënë paniku dhe kishte arritur gjer në atë pikë sa të mendonte seriozisht ta spostonte kryeqytetin.
Guan Yu-në e kishte vrarë fort ndërgjegjja kur kish mësuar se Jingzhou-ja ishte pushtuar nga ushtria e Wu-së. Ai i kishte tërhequr menjëherë trupat e tij dhe ishte drejtuar për nga Maicheng-u ku ishte rrethuar nga ushtria e Wu-së. Guan Yu-ja kishte rënë në kurth dhe ishte zënë rob. Skema e Lu Meng-ut për ta ndjellur armikun jashtë bazës së tij, kishte dalë e suksesshme për shkak se ai e dinte fort mirë se Guan Yu-ja ishte një njeri arrogant dhe i prirur për të bërë gjëra madhështore. Lu Meng-u i kishte kërkuar Lu Sun-it që t'ia zinte vendin me qëllim që ky i fundit mund ta çarmatoste psikologjikisht Guan Yu-në tërësisht. Mënyra se si Guan Yu-ja i kishte udhëhequr trupat e tij në drejtim të veriut kishte përbërë një dëshmi të qartë të manisë së tij për nder e lavdi. Është tepër e rëndësishme për një udhëheqës

që ta njohë me themel karakterin e gjeneralëve të tij kundërshtarë dhe të synojë që me çdo mjet të ngadhënjejë në betejë përmes strategjisë.

FUSHATA E LIAOXI-SHENYANG-UT

Gjatë Luftës Kineze për Çlirim (1945-49), situata taktike në fushëbetejën verilindore nën drejtimin e Lin Biao-s në përgjithësi nuk ishte shumë e favorshme për UÇP-në. Ai e kishte rrethuar Changchun-in dhe kish kaluar lumin Songhua Jiang tre herë, por sidoqoftë nuk kish arritur ta merrte iniciativën e as të tregohej i lakueshëm në këtë fushatë ushtarake, megjithëse trupat e tij kishin epërsi kundrejt atyre të Wei Lihuang-ut, të Kuomintang-ut. Sipas mendimit të Mao Ce Dunit dhe Çu En Lait, kjo gjë po ndodhte si pasojë e gabimeve të komandantit të UÇP-së në atë rajon.
Pasi kishin mendituar gjatë, Mao Ce Duni dhe Çu En Lai kishin vendosur ta sulmonin Jingzhou-n, që konsiderohej si një lëvizje strategjike meqenëse kështu armiku do të detyrohej t'i mbronte një pozicion shumë të favorshëm për interesat e tij. Jingzhou-ja përbënte një nyje kyçe për kalimin e furnizimeve midis Kinës veriore dhe verilindore. Nëse do të pushtohej Jingzhou-ja, furnizimet për ushtrinë e Kuomintang-ut në rajonin verilindor do të ndërpriteshin. Për më tepër, edhe mbështetja e anasjelltë strategjike e forcave armike në rajonet veriore dhe verilindore gjithashtu do të ndalej njëherë e mirë. Nëse Jingzhou-ja do të mësyhej nga UÇP-ja, si pasojë e iniciativës së UÇP-së armiku do të detyrohej t'i vinte në ndihmë qytetit duke e vënë vetën në pozicion të dobët strategjik. Nëse do të dërgoheshin përforcime, ushtria e Kuomintang-ut do të rrezikonte të shpartallohej në marshim e sipër, duke krijuar kështu kushtet

e duhura që trupat e UÇP-së të lëviznin në mënyrë të përputhshme me rrethanat.
Historia e kishte vërtetuar korrektesën e vendimit të marrë nga Mao Ce Duni dhe Çu En Lai. Siç edhe pritej, kur Jingzhou-ja kishte nisur të sulmohej nga UÇP-ja, menjëherë ishin nisur përforcimet armike nga Kina veriore, por ato ishin sulmuar nga UÇP-ja dhe nuk kishin dalë dot të arrinin në Jinzhou. Trupat e Kuomintang-ut po ashtu ishin nisur nga Shenyangu për t'i vajtur në ndihmë Jingzhou-t, por edhe ato ishin pikasur dhe shpartalluar në Dahushan. Më vonë, armiku ishte detyruar të dorëzohej në Changchun. Gjatë kësaj fushate, më tepër se 470.000 trupat të Kuomintangut të shpartalloheshin. Gjithaq, i tërë rajoni verilindor ishte çliruar.
Mund të dilet pra në përfundimin se iniciativa strategjike nuk është diçka e natyrshme në kushte beteje, por ajo duhet të sendërtohet nga komandantët e zotë. Lakueshmëria e taktikave në një fushatë ushtarake përgjithësisht arrihet duke u nisur tek iniciativa strategjike. Fushata e Liaoxi-Shenyang-ut e ilustron fare qartë këtë strategji.

PËRMBLEDHJE

Duhet të pikasni pikën kyçe që pastaj ndikon në mënyrë vendimtare mbi tërë fushën ushtarake: shkathtësia, egërsia dhe shpejtësia duhet të kuptohen në mënyrën e duhur. Shkathtësia do të thotë që të keni plan të vihet në zbatim me dinakëri; egërsia nënkupton një epërsi e papërballueshme forcash në favorin tënd, po aq e egër sa kafshimi i tigrit ndaj një kafshe të savanës; kurse shpejtësia sa ç'bie një rrufe. beteja duhet mbyllur po aq shpejt sa kafshimi i tigrit ndaj...
Iniciativa dhe lakueshmëria e kanë të nevojshme që dredhitë

dhe goditjet e shpejta të jenë të ndryshueshme, dhe që gjithashtu edhe lëvizjet e armikut të ndodhnin sipas planeve tuaja. Armiku duhet sulmuar pikërisht aty ku ai pret përforcime dhe gjithaq na nevojitet që të kemi edhe alternativa të tjera praktike në dorë para se të nisim një fushatë ushtarake.

Iniciativa në fushatë nuk është diçka e natyrshme, por për ta marrë atë në dorë, duhet të luftojmë fort. Ajo varet gjerësisht nga aftësia e komandantit përkatës për ta drejtuar betejën varësisht nga ndryshimi i rrethanave. Është e mundur që të ndryshohet një situatë e pafavorshme, duke e shndërruar atë në të favorshme, ashtu si edhe pasivitetin në iniciativë (kalimi katër herë i lumit Cheshui dhe Beteja e Jingzhou-s). Një komandant që i përdor trupat në mënyrë të lakueshme përgjithësisht do ta ketë iniciativën në duart e tyre.

Duhet të zgjidhni komandantë që gëzojnë aftësinë të kenë mendje krijuese dhe prirje për të reaguar me shpejtësi. Nuk ekziston formë e përcaktuar e përdorimit të trupave e as ndonjë rregull i përgjithshëm se si fitohet një luftë. Na takon që vazhdimisht të shkelim shtigje të reja.

Duhet t'i jepni shumë rëndësi formimit të një grupi ekspertësh të cilët të dinë se si përgatiten oficerët e stafit tuaj si njerëz që duhet të mendohen lidhur me lëvizjet në kushte beteje. Ata nuk duhet të përdoren si nëpunës pa vlerë ose ordinanca. Vetëm në këtë mënyrë një komandant mund të arrijë ta përthithë gjithë mençurinë e stafit të tij të ngushtë.

KAPITULLI VI

PËRDORIMI I SPIUNËVE

"Përdorimi i spiunëve" është titulli i kapitullit të fundit të Artit të Luftës së Sun Tzu-së. Aty vihet në dukje rëndësia dhe mënyrat se si përdoren spiunët në betejë. Qëllimi i përdorimit të tyre është që të jemi në dijeni të lëvizjeve të armikut tonë. Rrjedhimisht formësohet edhe ideja e Sun Tzu-së: "Njohja e armikut dhe e vetvetes të bën të pathyeshëm". Le të shohim pra se si Sun Tzu-ja e kishte shtjelluar këtë temë.

Në kapitullin që merret me spiunët, Sun Tzu-ja kishte shkruar: "Arsyeja përse sovrani mendjendritur dhe gjenerali i mençur shpesh arrijnë të ngadhënjejnë në betejë kur vendosin të luftojnë, dhe se përse arritjet e tyre i tejkalojnë dukshëm ato të njerëzve të zakonshëm, ka të bëjë thelbësisht me largpamësinë. Largpamësia nuk mund të përftohet nga shpirtrat e përtejshëm apo hyjnitë, as përmes analogjisë dhe përvojës, e as nga llogaritjet astrologjike. Ajo duhet të fitohet nga ata njerëz që e njohin mirë situatën e armikut.

"Në kohët e lashta, zeniti i Dinastisë Shang i detyrohet Yi Zhisë, i cili i kishte shërbyer edhe Xia-s. Ngritja e Dinastisë Zhou vjen nga Lju Ya-ja, i cili i kishte shërbyer Yin-ëve. Prandaj, vetëm sovrani mendjendritur dhe gjenerali i mençur që gëzojnë aftësinë për t'i përdorur sipas interesave të tyre njerëzit me inteli-gjencë si spiunë, munden rrjedhimisht të arrijnë qëllime madhështore.

"Pra, ekzistojnë pesë lloje spiunësh: spiunët vendas, ata të brendshëm, spiunët e dyfishët, spiunët që mund të hiqen qafe dhe spiunët mbijetues. Atëherë kur të pesta llojet e mësipërme të spiunëve punojnë njëkohësisht dhe kur veprimet e tyre janë klandestine, kjo quhet 'tërheqja e mençur e fijeve' dhe përbën thesarin e vërtetë të sovranit.
"Sovrani duhet të jetë në dijeni të plotë të veprimtarive të këtyre pesë lloj spiunëve. Dhe çelësi qëndron pikërisht në përdorimin e spiunëve të dyfishët. Prandaj, është e detyrueshme që ata të trajtohen në mënyrë të jashtëzakonshme të lehtësuar. Ndër gjithë pjesëtarët e ushtrisë, askush nuk është më i afërt me komandantin sesa spiunët; ndër tërë shpërblimet, më bujarët u kushtohen spiunëve; mes gjithë çështjeve të ndryshme, asnjë syresh nuk është më sekrete sesa ato që lidhen me operacionet e spiunimit. "
Aspekti më i vlefshëm lidhur me Artin e Luftës të Sun Tzu-së, ka të bëjë me faktin se ai kishte përpiluar strategji dhe taktika të ngjizura si pasojë e kushteve luftarake të kohës së tij dhe duke u mbështetur te njohja thelbësore e armikut. Ideja e tij e përthithjes së informacioneve kyçe nga kampi armik, ose fakti se iu kushtonte rëndësi të veçantë njerëzve që e njihnin mirë situatën e armikut, është e vërtetuar gjerësisht. Ai kishte përdorur mjete të ndryshme për të mbledhur informacione në shkallë të gjerë. Ai kishte një qëndrim qartësisht mospranues ndaj shpirtrave dhe hyjnive, analogjive me ngjarjet e së shkuarës dhe përllogaritjeve astrologjike që ndërlidheshin me strategjitë luftarake.
Sun Tzu-ja kishte shkruar: "Spiunët vendas janë ata banorë të shtetit armik që në përdorim të mirën tonë. Spiunët e brendshëm janë zyrtarë të armikut që i përdorim sipas interesit tonë. Spiunët e dyfishët janë spiunë të armikut që i përdorim si pasojë e dredhisë. Spiunët që mund të

hiqen qafe, janë ata spiunë të cilëve qëllimisht u japim informacione të pavërteta dhe që u themi t'ua përçojnë ato armikut. Spiunët mbijetues janë ata që venë dhe më pas kthehen nga fushimi armik për të na sjellë informacione freskëta". Dhe me të vërtetë, atëherë kur të pesta këto lloje spiunësh janë njëkohësisht në veprim, armiku nuk ka më paqe.
Ndërsa lidhur me qëllimin e të mbledhurit të informacioneve, Sun Tzu-ja kishte vënë në dukje: "Përgjithësisht, kur bëhet fjalë për një ushtri që ju dëshironi të goditni, si dhe për njerëz të caktuar që doni të vrisni, është e nevojshme që të zbulohen qysh më parë emrat e komandantit të garnizonit, adjutantëve, shoqëruesit e tyre, portierët dhe truprojat. Nevojitet që t'i udhëzoni spiunët tuaj që këto çështje t'i sqarojnë imtësisht". Nuk ka nevojë të thuhet që madhësia e territorit armik, numri i popullsisë së tij dhe rezervat e tij ushqimore bëjnë pjesë në qëllimin themelor të spiunazhit.

HISTORIA E SPIUNËVE

Ata që e kanë studiuar historinë e luftërave kineze dhe të huaja, janë në dijeni të faktit se përdorimi i spiunëve ka përbërë ngaherë një mjet të rëndësishëm në aktivitetet luftarake. Pa dyshim që mënyra se si bëhet spiunazhi ka ndryshuar dhe është zhvilluar nga format më primitive, në metodat e sotme moderne. Por gjithsesi, pavarësisht kohës tejet teknologjike në të cilën jetojmë, që na mundëson të përdorim tërë pajisjet moderne, përfshirë satelitët, përdorimi i spiunëve akoma mbetet tepër i vlefshëm për mbledhjen e informacioneve ndërmjet vendeve të ndryshme. Mënyra themelore e të spiunuarit nuk ndryshon fort nga

ajo që përshkruante Sun Tzu-ja para më shumë se dy mijë vitesh. Më poshtë do t'u ofroj disa shembuj të përdorimit të spiunëve vendas në kohët e lashta, ashtu si edhe në ditët e sotme.

LUFTA MIDIS CHU-SË DHE HAN-IT

Gjatë luftës midis mbretërive të Chu-së dhe Han-it, një oficer i rëndësishëm i ushtrisë së Chu-së i quajtur Fan Zhen kishte qenë i mirënjohur për mprehtësinë e tij dhe tepër i respektuar nga Xiang Yu-ja, sovrani i Chu-së. Zhang Liangu dhe Chen Pingu, të dy këshilltarë pranë oborrit të Han-it, i druheshin Fan Zhenit për shkak të aftësisë të tij për të depërtuar në skemat e armikut.
Chen Pingu e dinte se Xiang Yu-ja ishte fort dyshues, kështu që ai kishte sajuar një plan të shkëlqyer për ta përdorur në luftën e tyre. Ai kishte dërguar një lajmëtar me dhurata dhe kishte shkruar një letër false për Fan Zhanin nga nipi i tij Fan Shi-ja. Në këtë letër, Fan Shi shkruante se ai tanimë ishte bërë këshilltar i Liu Bongut, sovranit të Han-it. Ai thoshte se Liu Bongu ishte një sundimtar i madh dhe tepër madhështor, kështu që ai ni ndihej skajshmërisht i lumtur që t'i shërbente atij. Lajmëtari qëllimisht kishte shkuar te fushimi i Chu-së në kohën kur Fan Zheni nuk ndodhej aty. Ai ia kishte dhënë letrën dhe dhuratat rojës që kishte menduar se ishin gjëra të rëndësisë së veçantë dhe ia kishte shpënë direkt Xiang Yu-së. Xiang Yu-ja kishte nisur të dyshonte pasi e kishte lexuar letrën. Kur Fan Zheni ishte kthyer, Xiangu e kishte pyetur nëse ai kishte një nip të quajtur Fan Shi. Gjë që Fan Zheni e kishte pohuar, por kish shtuar se Fan Shi-ja kishte vdekur qysh në fëmijëri. Xiang Yu-ja atëherë ishte bërë edhe më dyshues për faktin se Fan

Zheni mund të kish nisur të bashkëpunonte me Liu Bongun.
Vitin tjetër, përfaqësuesit e Liu Bongut dhe Xiang Yu-së kishin nisur bisedimet për paqe. Kur përfaqësuesit e Xiang Yu-së kishin arritur në Han, Chen Pingu ishte shtirur sikur ai po priste përfaqësues të Fan Zhenit dhe jo të Xiang Yu-së. Ai e kishte anuluar festën e madhe që pritej të mbahej për nder të njerëzve të Fan Zhenit. Përkundrazi, njerëzve të Xiang Yu-së ai u kishte servirur vetëm një darkë të zakonshme. Kur Xiang Yu-ja kishte dëgjuar për atë çfarë kish ndodhur në Han, dyshimet e tij për Fan Zhenin ishin shtuar. Qysh atëherë ai kurrë më nuk ua kishte vënë veshin këshillave të Fan Zhenit. Marrëdhëniet mes tyre ishin tendosur përditë e më tepër. Fan Zheni ishte detyruar të jepte dorëheqjen dhe kishte vdekur në rrugë e sipër për në qytetin e tij të lindjes. Gjer ditën e fundit të jetës, ai nuk e kishte marrë vesh arsyen e sjelljes së Xiang Yu-së. Pastaj, Xiang Yu-ja i kishte marrë vetë të gjitha vendimet dhe kish pësuar humbje të plotë si përfundim. Skema e Chen Pingut kishte funksionuar.
Gjatë periudhës së Tre Mbretërive, Zhou Yu-ja i mbretërisë së Wu-së kishte përdorur të njëjtën skemë që e kishte shtyrë Cao Cao-n të vriste Cai Mao-n dhe Chang Yong-un, admiralët e vet më të zotë. Si pasojë, Cao Cao kishte pësuar humbje në Betejën e Chibi-t.

TRILLIMI I HITLERIT ME SPIUNËT SOVJETIKË

Në prag të Luftës së Dytë Botërore, shërbimet e spiunazhit të Hitlerit kishin trilluar informacione për të hartuar një çështje kundër gjeneralit Tukhachevski, që në atë kohë

ishte një zyrtar i lartë në Komandën Supreme të Ushtrisë së Kuqe Sovjetike. Informacioni në fjalë e akuzonte pa të drejtë atë se punonte në shërbim të gjermanëve në një përpjekje për ta rrëzuar me dhunë Stalinin nga pushteti. Një spiun sovjetik në Gjermani e kishte blerë këtë informacion për njëqind mijë rubla. Komanda Supreme Sovjetike e kishte ngrënë karremin, dhe jo vetëm që Tukhachevski ishte pushkatuar, por edhe një numër i madh gjeneralësh sovjetikë do të përfshiheshin gjithashtu në këtë komplot të supozuar. Kjo kishte qenë një ndër arsyet kryesore të dështimit fillestar të ushtrisë sovjetike në hapat e parë të luftës kundër Gjermanisë Naziste.

PËRMBLEDHJE

Spiunët vendas dhe të dyfishtë përbëjnë llojet më të rëndësishme të spiunëve që duhen përdorur kundër armikut. Nëse përdoren në mënyrën e duhur, ata mund të kërcojnë unitetin në radhët armike dhe t'ia shpërbejnë atij fare forcat. Armiku po ashtu mund të çarmatoset me dorën e vet nëse brenda radhëve të tij shtihet fara e mosmarrëveshjeve.
Përdorimi i spiunëve duhet të mbahet rreptësisht konfidencial. Ata duhet të jenë tepër të kujdesshëm dhe të mprehtë; përndryshe ata do të mund të mashtrohen, sidomos nga agjentët e dyfishtë.
Spiunët duhet të shpërblehen në mënyrë bujare dhe puna e tyre duhet vlerësuar se tepërmi.
Spiunët duhet përdorur me guxim. Qëllimi i veprimtarisë së tyre nuk duhet të kufizohet. Gjëja e vetme që i do kërkuar një spiuni, është që t'i përmbushë detyrat që i janë caktuar.

KAPITULLI VII

GJEOGRAFIA

Ndër trembëdhjetë kapitujt e Artit të Luftës së Sun Tzu-së, katër syresh – "Nëntë ndryshoret", "Në marshim", "Terreni" dhe "Nëntë terrenet e ndryshme" – merren me pikat e takimit ndërmjet gjeografisë dhe çështjeve ushtarake. Në kapitujt e tjerë, ka gjithsesi pasazhe ku flitet për gjeografinë.

RËNDËSIA E TERRENIT

Në kapitullin "Terreni" vihet në dukje: "Struktura e terrenit është diçka fort e nevojshme për t'u njohur në kushte lufte. Prandaj, virtytet e një komandanti mendjemprehtë kanë të bëjnë pikërisht me vlerësimin e distancave dhe armikut të vet, si dhe me përllogaritjen e distancave dhe shkallën e vështirësisë të terrenit përkatës, në mënyrë që të mund të sigurohet fitorja. Ai komandant që lufton duke zotëruar njohuri të plota të këtyre faktorëve, e ka fitoren të sigurt; ndërsa ai që nuk i zotëron ato, pa dyshim që do të mposhtet."
Do sqaruar këtu se ajo çfarë nënkupton Sun Tzu-ja me terren, nuk është i njëjti term që përdorim sot sipas përcaktimit modern. Bëhet fjalë më tepër për një koncept që ka të bëjë me "topografinë" moderne dhe "gjeografinë ushtarake".

Megjithëse Sun Tzu-ja e konsideronte strukturën e terrenit si një pikëmbështetje në betejë, ai sidoqoftë pohonte se një komandant i zoti do të duhej të ishte tepër i vetëdijshëm për shkallën e vështirësisë dhe distancave në terren. Dhe faktet i kanë dhënë të drejtë pohimit të tij. Ka pasur shembuj të shumtë, në botë, si dhe në Kinë, të cilat na tregojnë se ushtri të caktuara ishin mposhtur si pasojë e mospërputhjes së terrenit.

Për shembull, në vitin 645 para Krishtit, mbretëritë e Qin-it dhe Jin-it ishin përballur në Huan Yuan (në provincën e sotme të Shanxi). Karrocat e luftës së ushtrisë së Jin-it kishin ngecur në baltë për shkak se komandantët e tyre nuk e njihnin aspak terrenin. Si rrjedhojë, ushtria e Jin-it jo vetëm që ishte mposhtur, por Jinhuigongu, komandanti i saj, ishte zënë po ashtu rob.

Në vitin 589 para Krishtit, mbretëria e Qi-së ishte mposhtur nga Jin-i. Gjatë tërheqjes, karrocat e saj të luftës ndërkaq ishte ngatërruar mes një grumbulli pemësh të dendura, dhe vetë sovrani për pak kish rënë rob në duart e armikut.

Sun Tzu-ja, duke i studiuar shembujt e shumtë historikë, kishte shpjeguar edhe disa nga ndikimet e tjera të gjeografisë mbi luftën në vetvete. Në kapitullin e titulluar "Terreni", ai klasifikonte gjashtë llojet përkatëse: "i depërtueshëm", "i koklavitur", "neutral", "me gryka të ngushta", "i thiktë" dhe "i largët". Këto lloje terreni janë fare të natyrshme për fushën e betejës dhe përgjithësisht bëjnë pjesë në kategorinë e topografisë.

Në kapitullin e titulluar "Nëntë terrenet e ndryshme", ai kategorizonte terrenin si "shpërndarës", "kufitar", "kyç", "të hapur", "udhëkryq", "të vështirë", "të rrethuar" dhe "dëshpërues". Këto situata të parashikuara gjeografike që përfshijnë

edhe zonat strategjike përtej një kufiri përkatës, përgjithësisht ndërlidhen me gjeografinë ushtarake.
Në libri e tij, Sun Tzu-ja ja thellohet në secilën kategori imtësisht, duke trajtuar edhe mënyrën se si duhet vepruar në secilën syresh. Ai e ishte vënë fort theksin te të luftuarit në kënetë ose në një vend të mbuluar nga bimësia. Ai vë në dukje: "Kur kaloni nëpër këneta, bëjeni këtë gjë me nxitim. Mos rrini aty gjatë. Kur gjatë marshimit hasni ndonjë grykë të ngushtë ose moçaliste të mbuluara ma barishte ujore, ose pellgje plot me kallama, ose pyje plot me gëmusha dhe bimësi të dendur, jini tejet të vëmendshëm nga kurthet dhe spiunët e fshehur aty rrotull".
Ky parim vlen edhe për luftërat moderne. Gjatë Luftës së Parë Botërore, njëqind mijë ushtarë rusë të udhëhequr nga gjenerali Samsonov, ishin shpartalluar krejtësisht nga ushtria gjermane në një moçalishte. Ndërkohë që gjithashtu mund të përmenden shembuj të tjerë të historisë së luftërave në të cilat ushtri të ndryshme ishin zënë në befasi dhe ishin shpartalluar nëpër gryka të ngushta apo këneta të ndryshme.

TERRITORI UDHËKRYQ

Rëndësia e territorit udhëkryq në lidhje me situatën e sotme ndërkombëtare – veçanërisht lidhur me shpërndarjet strategjike të trupave nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik[13] – është diçka e qartë dhe do të kihet parasysh këtu.
Përkufizimi i Sun Tzu-së për terrenin udhëkryq është: "Kur një territor është i mbyllur nga të qenët i kufizuar me tre shtete të tjera dhe kur ti je i pari që mundëson një qasje të lirë brenda tij, atëherë terreni në fjalë quhet si udhëkryq.

[13] Bëhet fjalë për kohën e Luftës së Ftohtë.

Territori udhëkryq është ai ku puqen rrugët kryesore të komunikimit, duke u bashkuar njëra me tjetrën: ai që arrin ta vërë këtë lloj territori nën kontroll, pastaj do të sigurojë mbështetjen e të tërë vendeve fqinje... Sa i përket territorit udhëkryq, bëni aleanca me vendet fqinje... Në territor udhëkryq, do të përforcoja aleancat".
Terreni (ose territori) udhëkryq, në përgjithësi, ndodhet jashtë territorit tonë, por strategjikisht është tepër i rëndësishëm. Nëse ia dalim që ta pushtojmë atë të parët, atëherë do të ndodhemi në një pozicion tejet të favorshëm. Kështu pra, meqenëse terreni udhëkryq gjendet jashtë kufirit tonë, ai mund të jetë shumë larg. Për këtë arsye, nuk është aspak e lehtë që të arrihet të pushtohet ky lloj territori vetëm duke mobilizuar trupat. Prandaj Sun Tzu-ja na sugjeron që mënyra më e mirë për t'i vënë këto territore nën kontroll është që të lidhen aleanca me shtetet fqinje të terrenit udhëkryq, gjë që tingëllon si tepër e arsyeshme dhe e realizueshme.
Te libri Arti i Luftës i Sun Tzu-së sipas shënimeve të njëmbëdhjetë autorëve, tetë prej shkrimtarëve në fjalë, ishin të të njëjtit shpjegim në lidhje me terrenin udhëkryq. Ata të gjithë besonin se kjo është një zonë strategjikisht tejet e rëndësishme ku kalojnë udhë drejt çdo drejtimi të mundshëm. Për këtë arsye, është me rëndësi jetike që ajo të kontrollohet nga ne para të tjerëve. Por megjithatë, është më e kështillueshme që kjo të arrihet përmes mjeteve diplomatike dhe jo forcës.
Komenti i mëposhtëm nga z. He ngërthen plotësisht në vetvete edhe mendimin e kolegëve të tij: "Terreni (territori) udhëkryq përbën një nyje ku puqen rrugë që të shpien në çdo drejtim. Vëreni i pari atë nën kontroll, dhe gjithë të tjerët do t'u binden urdhrave tuaj. Një territor i këtillë

përbën gurin e themelit të sigurisë suaj, por njëkohësisht është tepër me rrezik për ju nëse do ta humbisni një ditë.
“Sovrani i Wu-së dikur e kishte pyetur Sun Tzu-në: Nëse ndodhemi shumë larg nga territori udhëkryq, atëherë do ta kemi të pamundur që të arrijmë aty të parët, edhe në qoftë se kuajt dhe karrocat tona do të vrapojnë si era. Çfarë të bëj pra?’
Sun Tzu-ja i ishte përgjigjur: ‘Duhet të dini se largësia në fjalë është e njëjtë si për ne, ashtu edhe për armikun. Nëse duam të vëmë nën kontrollin tonë një territor udhëkryq, atëherë duhet t'u kushtojmë më shumë rëndësi florinjve sesa përdorimit të forcave. Nëse dini t'i shpërbleni si duhet aleatët tuaj të mundshëm me florinj e gurë të çmuar, si dhe t'i bindni ata me marrëveshje solemne, atëherë gjithsesi do të arrini të parët në territorin udhëkryq, edhe nëse ushtarët tuaj nuk do të kenë ardhur ende atypari. Sepse tashmë ju do të keni aleatë që do t'ju kenë dalë në krah për realizimin e këtij qëllimi, ndërsa armiqtë tuaj jo’”.
Kuptimi i këtij komenti është i qartë. Ideja kryesore është që të zbatohen plane diplomatike dhe të përdoren mjete ekonomike për t'i bërë për vete vendet që kufizohen me territorin udhëkryq.

RIVALITETI MIDIS SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS DHE BASHKIMIT SOVJETIK

Teoria e Sun Tzu-së lidhur me këtë temë ka një rëndësi të theksuar praktike, gjë që mund të dëshmohet përmes shembujve të rivalitetit midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Karl von Clausewitz shpesh arrinte t'i dëshmonte përfundimet e tij teorike duke ofruar shembuj nga historia e luftërave të ndryshme. Ai po

ashtu i kushtonte një rëndësi të veçantë topografisë, dhe dikur kishte thënë se një rëndësi madhore për shtabin e përgjithshëm të gjeneralit përkatës, ka njohja e thellë e tipareve gjeografike. Dhe faktikisht, gjithmonë mund të hasen precedentë që kanë të bëjnë me terrenin, nëpër luftërat e shumta të historisë botërore. Për këtë arsye, pranë çdo shtabi të përgjithshëm në shumë vende në ditët e sotme, është ngritur një departament i veçantë që studion gjeografinë. Sipas përkufizimit që Sun Tzu-ja kishte dhënë për territorin udhëkryq, dhe nga çfarë thuhet në shënimet për këtë temë, ekzistojnë shumë pak zona strategjike që mund të cilësohen plotësisht si territore strategjike: Ngushtica e Gjibraltarit, Kanali i Suez-it dhe Ngushtica e Bosforit – tre kalimet për në Detin Mesdhe dhe krahun jugor të NATO-s; Ngushtica e Malakas, midis Indonezisë dhe Malezisë; Kanali i Panamasë në Amerikën Qendrore; si dhe Gjiri Persik dhe Gjiri i Meksikës – njëri në lindje dhe tjetri në perëndim.
Siç dihet, njëra nga superfuqitë (Bashkimi Sovjetik), akoma po has në vështirësi të theksuara për të vënë duart mbi – por nuk është se ka hequr dorë – Ngushticën e Gjibraltarit, që gjendet prej kohësh nën kontrollin e Mbretërisë së Bashkuar. Por ndërkaq, sovjetikët kishin shpenzuar miliarda dollarë të kamufluara si "ndihmë" ekonomike dhe ushtarake për Egjiptin me qëllim që të siguronin të drejtën e kalimit përmes Kanalit të Suez-it; gjithashtu i kishin dhënë një miliard dollarë "ndihmë" Turqisë, dhe udhëheqësi sovjetik e kishte vizituar personalisht këtë vend, duke dashur të ruanin mundësinë për të kaluar përmes Ngushticës së Bosforit, gjë që e kishin arritur me sukses. Aeroplanmbajtësja SS Kiev kishte siguruar kështu një kalim të qetë përmes Bosforit në Mesdhe, gjë që deri atëherë nuk ishte e lejueshme sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare.

Veprimet e kësaj superfuqie përputhen tërësisht me parimin e Sun Tzu-së: “Nevojat t'i kushtojmë tepër rëndësi dhënies së ndihmës dhe nisjes së më tepër të dërguarve tanë...”
Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik janë përplasur shpesh për kontrollin e Afganistanit dhe shumë vendeve të tjera përreth Gjirit Persik. Qasja ndaj Kubës, territor udhëkryq në lindje të Gjirit të Meksikës, kishte ndryshuar thellësisht pozicionet strategjike të dy superfuqive në zonën e Amerikës Veriore dhe Jugore.
Tonga, një vendth i vogël në Paqësorin Jugor, përbën një pikë strategjike mes tre aleatëve: Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Australisë dhe Zelandës së Re. Bashkimi Sovjetik ishte përpjekur dikur që t'i avitej këtij vendi duke “ofruar ndihmë ekonomike dhe nisur disa emisarë të vetët” në një përpjekje për të vënë këmbë në Paqësorin Jugor. Por sovjetikët nuk ia kishin arritur qëllimit ngaqë skema e tyre ishte zbuluar nga rivalët e tyre.

GJEOGRAFIA NË EPOKËN E HAPËSIRËS

Tanimë bota ka hyrë në epokën e hapësirës dhe shumë lloje satelitësh sot përdoren për qëllime ushtarake, sidomos “space shuttle”. Si rrjedhojë janë krijuar kushtet që betejat e së ardhmes të luftohen në hapësirë. Por gjithsesi, asgjë nuk mund të shkëputet tërësisht nga suazat tokësore. Satelitët dhe “space shuttle-t” sidoqoftë nga toka nisen, aty ku ndodhen edhe pikat strategjike dhe bazat ekonomike.
Për këtë arsye, gjeografia përbën një ndër katër faktorët themelorë – krahas situatës së armikut dhe asaj tonës, si dhe faktorit kohor – që duhet mbajtur parasysh para se të merren vendimet përkatëse apo të hartohen planet luftarake. Nuk ka asnjë dyshim për faktin se ajo studiohet në çdo akademi

ushtarake nëpër botë. Kur studiojmë Artin e Luftës së Sun Tzu-së, në asnjë mënyrë nuk duhet të neglizhojmë rëndësinë praktike të doktrinës së tij në lidhje me gjeografinë.

PËRMBLEDHJE

Zonat me rëndësi strategjike përfshijnë ngushticat detare, kanalet detare, aeroportet, gjiret detare ose natyrore, si dhe pikat nga ku lëshohen raketat e telekomanduara, të gjitha pra, zona që ia vlen të bllokohen apo kontrollohen sipas interesit tonë. Përgjithësisht ka dy mënyra se si ato mund të bien nën kontrollin tuaj para se armiku ta bëjë këtë gjë: njëra syresh ka të bëjë me lidhjen e ndonjë aleance me një vend kufitar me këtë zonë; ndërsa tjetra arrihet duke e marrë me qira një zonë të tillë përmes negociatave miqësore me vendin përkatës ku ndodhet ky territor, në mënyrë që ai të mos përdoret dot nga armiku.
Shkretëtirat, moçalishtet e mëdha, pyjet, zonat e pabanuara, rajonet e rrënuara dhe malet e larta ku ajri pakësohet, përbëjnë zona ku një ushtri nuk duhet të rrijë për një kohë të gjatë.
Ekzistojnë vende për të cilat duhet luftuar ushtarakisht. Në to përfshihen qendrat e komunikimit ushtarak, politik apo ekonomik. Shumë përfitime sjell edhe marrja nën kontroll e zonave nga ku mund të zotërohet situata, duke e ruajtur kështu mundësinë për t'i spostuar trupat tona sipas dëshirës. Gjithashtu edhe territore nga ku mund të sulmojmë dhe të tërhiqemi në siguri të plotë, ku mund të ruajmë furnizime me shumicë, dhe ku mund t'u përshtatemi të gjitha ndryshimeve përkatëse të situatës; të tërë këta shembuj pra janë tejet të rëndësishëm.
Zonat me rëndësi të theksuar taktike, përgjithësisht janë

lartësi dominuese mbi fushën e betejës, nyje komunikimi, ndërtesa të pangadhënjyeshme në terrene fushore, kryeura[14] dhe disa vende të caktuara ku kalohen lumenjtë.

[14] Një pozicion i fuqishëm i siguruar nga një ushtri thellë brenda territorit armik, nga i cili përparohet më tej, apo sulmohet armiku.

KAPITULLI VIII

PRAPASKENA HISTORIKE E ARTIT TË LUFTËS SË SUN TZU-SË

Mao Ce Duni kishte shkruar në një artikull: "Nga vijnë idetë e duhura vallë? A mos bien ato ndoshta nga qielli? Jo. A mos janë ato të bashkëngjitura në trurin tonë? Jo. Ato vijnë vetëm si pasojë e praktikave sociale, dhe vetëm prej saj. Ato vijnë saktësisht nga tre lloje praktikash sociale: lufta për prodhim, nga lufta e klasave dhe nga eksperimentet shkencore".
Sun Tzu-ja kishte jetuar në periudhën e vonë të Pranverës dhe Vjeshtës, një kohë kur shoqëria e lashtë kineze po kalonte nga epoka skllavopronare, në atë feudale. Në ato kohë vlonte lufta e klasave që më pastaj reflektohej në luftërat e shumta të armatosura. Përpara kësaj periudhe, pesë "bo" (një titull fisnikërie në Kinë, i barasvlershëm me një kont) – Qi Yuan, Jin Wen, Qin Mu, Chu Zhuang dhe Song Rang – po luftonin mes tyre për dominimin tërësor, dhe ndërkaq gjithë sistemi social kinez ishte përfshirë nga turbullirat.
Sipas të dhënave historike për periudhën e Pranverës dhe Vjeshtës së hershme, në atë kohë kishte jo më pak se 130 shtete të vogla që luftonin njëra kundër tjetrës. Gjatë këtij procesi kishin dalë në pah pesë shtete të fuqishme: Qi-ja, Jin-i, Qin-i, Chu-ja dhe Song-u (në fakt, Song-u nuk kishte

qenë aq i fortë sa të tjerët). Ato luftonin për të siguruar kontrollin e plotë, duke u rënë në qafë shteteve më të vogla dhe duke pushtuar rregullisht fqinjet e tyre. Përgjatë periudhës rreth dyqindvjeçare para se të jetonte Sun Tzu-ja, kishin ndodhur treguesi deri në katërqind luftëra midis tyre. Përveç përballjeve ushtarake, që kishin dhënë si rezultat edhe një art të diversifikuar lufte, historia kishte dëshmuar edhe luftëra politike, luftëra ekonomike (që ishin reflektuar sidomos në marrëdhëniet tregtare dhe në vënien nën kontroll të pasurisë së vendeve të tjera përmes praktikave agresive ekonomike), si dhe beteja diplomatike (zakonisht me aleanca dhe kundër-aleanca, si dhe me marrjen në mbrojtje të shteteve të vogla duke synuar zgjerimin e ndikimit të shtetit të fuqishëm përkatës). Arti i Luftës i Sun Tzu-së kishte përbërë pra me të vërtetë një përmbledhje të gjithë këtyre përvojave nga këto luftëra, ajo prandaj ai mbetet i pavdekshëm edhe dy mijë vite pasi ishte shkruar, veçanërisht sa u përket shumicës së parimeve të tij.

Arti i Luftës i Sun Tzu-së duket sikur na flet me një gjuhë dhe terma abstrakte. Por kur ia përqasim atë luftërave të ndryshme që kishin ndodhur para kohës së Sun Tzu-së, atëherë gjërat bëhen të qarta. Sigurisht, nuk përbën për mua një synim të qëllimshëm ndërlidhja e secilit parim të Artit të Luftës së Sun Tzu-së me një ngjarje historike. Vetëm një ose dy shembuj mund të shtjellohen mbi idetë qendrore të Sun Tzu-së.

VLERËSIMI I SITUATËS

"Planifikimi; vlerësimi i situatës", kapitulli i parë i Artit të Luftës së Sun Tzu-së, e çmon së tepërmi rolin që kanë përllogaritjet paraprake në kushte lufte. "Nëse vlerësimet e

bëra përpara betejës tregojnë fitoren e mundshme, kjo ndodh ngaqë përllogaritjet e kryera me shumë kujdes të bëjnë të mendosh se kushtet tua janë më të favorshme se ato të armikut tuaj; kurse nëse ato tregojnë humbjen, kjo gjë ndodh për shkak se përllogaritjet e kujdesshme të shtyjnë të gjykosh se kushtet e favorshme në betejën vijuese janë më të pakta. Falë përllogaritjeve të kujdesshme, gjenerali përkatës mund të dalë ngadhënjyes; kurse në të kundërtën, humbës. Prandaj pafundësisht më pak mundësi për të fituar do të ketë ai gjeneral që nuk bën asnjë përllogaritje përkatëse! Përmes këtyre mjeteve pra, ne mund të parashikojmë rezultatet e një beteje".

"Përllogaritjet paraprake" në kohët e sotme kanë domethënien e vendimeve të marra nga komanda më e lartë para se të shpërthejë lufta pas një analize të mirëfilltë mbi faktorët e ndryshëm lidhur me luftën në fjalë. Nuk është se mund t'i hyjmë luftës pa qenë të sigurt për fitoren. Për ta thënë me fjalë të tjera, vendimi për t'u futur në luftë vjen si rezultat i një studimi gjithëpërfshirës paraprak të faktorëve të ndryshëm që lidhen me përvojën politike dhe ushtarake, me diplomacinë dhe gjeografinë. Shembulli vijues është i mjaftueshëm për të shtjelluar këtë ide.

LUFTA E CHENG PU-SË

Lufta e Cheng Pu-së në vitin 632 para Krishtit kishte qenë e një shkalle të gjerë dhe kishte ndodhur gjatë periudhës së Pranverës dhe Vjeshtës. Kjo luftë gjithashtu i kishte dhënë Jin Wen Gongut mundësinë që ta siguronte pozicionin e tij si dominues duke përbërë kështu gurin e themelit të shtetit i Jinit të bëhej më i rëndësishëm midis tërë shteteve të tjera për një kohë të gjatë. Para kësaj lufte, monarku i Jin-it dhe udhëheqësit

e tij ushtarakë, kishin peshuar me kujdes faktorët e favorshëm dhe të pafavorshëm për secilën palë. Zou Zhuan, një libër që flet për historinë kineze, na ofron një përshkrim tepër të gjallë të luftës në fjalë: "Në dimër, Chu-ja dhe ndjekësit e saj kishin rrethuar Sung-un. Atëherë, Gongsu Guru i Sung-ut kishte vajtur kërkonte ndihmë në Jin".
Xian Zhen-i, njëri nga marshallët e Jin-it, kishte thënë: "Është pikërisht koha që ne ta shlyejmë debitë e mirënjohjes që i detyrohemi Sung-ut duke u ofruar atyre ndihmën tonë, por njëkohësisht ka ardhur edhe koha që të shtrijmë hegjemoninë tonë në atë zonë".
Hu Yen-i, një gjeneral i Jinit, po ashtu kishte nënvizuar: "Mbretëria e Chu-së pak kohë më parë kishte dalë në mbrojtje të mbretërisë së Cao-s dhe kishte bërë edhe lidhje martesore me shtetin e Wei-t. Nëse do ta sulmonim Cao-n dhe Wei-n, atëherë pa dyshim që Chu-ja do t'u vinte atyre në ndihmë. Dhe me këtë rast Qi-ja dhe Sung-u do të çliroheshin nga barra e rrethimit të Sung-ut".
Jin Wen Gong-u, sovrani i Jinit, e kishte ndjekur këshillën e tyre.
Pranverën e mëpasshme, trupat e Jinit kishin sulmuar Cao-n dhe Wei-n, dhe kishin ngadhënjyer. Por gjërat kishin marrë një drejtim të papritur. Zi-Yu-ja, një gjeneral i rëndësishëm i Chu-së, e kishte vizuar sulmin ndaj Sung-ut, gjë që e kishte shtyrë Man Yin-in të shkonte përsëri në Jin për të kërkuar ndihmë urgjente.
Gjatë bisedimeve, Jin Wen Gong-u, ishte shprehur: "Nëse nuk do të bëjmë të pamundurën për të ndihmuar Sung-un, atëherë ata kanë për t'i ndërprerë marrëdhëniet me ne. Nëse ndërkaq Chu-ja nuk ia ka ngrënë pajtimit me ne, do të na duhet të bëjmë luftë kundër tyre. Në atë rast, na nevojitet ujët e pakët ndihma nga Qi-ja dhe Qin-i. Por si do venë punët vallë nëse ata s'e pranojnë kërkesën tonë?"

Xian Zhen-i ishte përgjigjur: “U duhet thënë përfaqësuesve të Sung-ut që në vend që të na kërkojnë ndihmë neve, më mirë t'u paguajnë tribute të majme Qi-së dhe Qin-it, dhe pastaj t'u kërkojnë atyre që të merren vesh me Chu-në. Në ndërkohë, ne, pasi ta kemi zënë rob sovranin e Cao-s, një pjesë të territoreve të shtetit të Cao-s dhe shtetit të Wei-t do t'ia japim Sung-ut. Duke qenë aleat i ngushtë i këtyre dy shteteve, Chu-ja nuk do ta tolerojë këtë veprim. Por ndërkohë, duke qenë thellësisht të kënaqur me tributet e Sung-ut dhe të acaruar me kokëfortësinë e Chu-së, Qi-ja dhe Qin-i patjetër që do të ngrenë armët kundër Chu-së”.

NËNSHTRIMI I ARMIKUT PA PËRDORUR ARMËT

Siç tanimë kemi rënë re te Arti i Luftës i Sun Tzu-së, ekzistojnë parime të një rëndësie të veçantë si: “të sulmuarit e strategjisë së armikut”, “prishja e aleancave të armikut”, dhe “nënshtrimi i armikut pa luftë”. Që domethënë dhe të prishen aleancat e tij me diplomaci me qëllim që të nënshtrohen trupat e tij pa qenë nevoja për të luftuar.
Sun Tzu-ja ishte kundër hyrjes së pamatur në luftë me armikun. Ai theksonte: “Gjëja tjetër më e mirë është që të sulmohet ushtria e armikut, ndërsa qasja më e gabuar është që të sulmohet një qytet i rrethuar me mure të larta”. Të dyja këto veprime, sipas mendimit të tij, duheshin bërë vetëm në mungesë të çfarëdo alternative tjetër. Kjo përbën një vërejtje tejet të mençur për një njeri me përvojë të tij ishte: një ushtri në fushëbetejë. Përfundimi i mendimit të tij ishte: “Nënshtrimi i trupave armike pa qenë nevoja për luftë, përbën diçka të një përsosmërie madhore”.
A ishte pra ky përfundim vetëm një mënyrë dëshirore

të menduari nga ana e Sun Tzu-së, apo mos vallë ai vetëm po ndiqte prirjet e tij? Përgjigja negative, sepse ai kishte dalë në këtë përfundim pasi kish shqyrtuar vite të tëra përvoje luftarake përgjatë historisë.
Zou Zhuan kishte përmbledhur në faqet e veta shumë strategë ushtarakë të cilët, me ose pa një mbështetje të fuqishme prapa krahëve, ia kishin dalë mbanë që ta mposhtnin armikun me ndihmën e mençurisë së tyre, kurajës, mendjehollësisë dhe gojëtarisë së tyre. Ata ia kishin arritur qëllimit që ta nënshtronin armikun pa luftë. Ka pasur dy luftime shumë të famshme para kohës së Sun Tzu-së, që e dëshmojnë këtë parim.

BETEJA MIDIS QI-SË DHE CHU-SË

Në vitin 656 para Krishtit, Qi Huan Gong-u – aleat me shtetet e Lu-së, Sung-ut, Chen-it, Wei-it, Zheng-ut, Xu-së dhe Cao-s – kishte sulmuar shtetin e fuqishëm të Chu-së në jug. Duke u përballur me ushtri të shumta tepër agresive nga të gjitha anët, Chu-ja e kishte gjetur qartësisht veten më të dobët numerikisht.
Perandori i Chu-së kishte çuar një dërgutar në Qi, duke e pyetur Qi Huan Gong-un: “Ju jeni veriu, ndërsa ne jemi jugu. Secili nga ne nuk ka asnjë lloj pune me tjetrin. Atëherë përse vallë po na pushtoni?”
Guan Zhong-u, një ministër i shtetit të Qi-së, në vend të përgjigjes, i kishte kërkuar llogari të dërguarit për mospagimin e tributeve ndaj perandorit Zhou (që ishte veçse një monark kukull në krye të të gjitha shteteve kineze, në emër të të cilit Qi Huan Gong-u kishte nisur luftën për interesat e veta personale kundër Chu-së). Ai gjithashtu e kishte fajësuar Chu-në për mbytjen e mbretit Zhou Sao, që

kish ndodhur shumë kohë më parë. I dërguari i Chu-së e kishte pranuar fajin për mospagimin e tributeve dhe kishte premtuar se do t'i paguante të tëra së shpejti, për ndërkaq nuk kishte pranuar asnjë përgjegjësi lidhur me vdekjen e mbretit Zhou Sao. Qi-ja kështu kish mbetur e pakënaqur nga përgjigja dhe kish vijuar përparimin kundër Chu-së.
Sovrani i Chu-së atëherë kishte nisur një tjetër të dërguar, Qu Wan, për në mbretërinë e Qi-së për të folur në emër të tij. Teksa kishte organizuar pritjen e të dërguarit, sovrani i Qi-së u kishte kërkuar rojeve të tij qëllimisht që të zinin pozita tepër hijerënda në mënyrë që shkatërronin Qu Wan-in të nënshkruante një marrëveshje të favorshme për Qi-në.
Me një sjellje as kryelartë, por as shumë të përulur, Qu Wan-i i kishte thënë: “E kush vallë do të mundej të mos ju bindej madhërisë suaj që arrin t'i bindë sovranët e tjerë vetëm falë virtytit dhe moralit tuaj? Por nëse keni vendosur të përdorni forcën, atëherë mali Fangcheng do të bëhet muri për qytetet tona dhe lumi Hanshui hendeku para portës së kështjellës sonë. Megjithëse ju keni një ushtri të fuqishme, nuk do të keni asnjë dobi prej saj”.
Bëhej fjalë për një gjuhë diplomatike të përdorur me një vetëbesim të përkryer. Qi Huan Gong-u ishte detyruar kështu të nënshkruante një marrëveshje paqeje (jo tërësisht të favorshme për interesat e Qi-së) me Chu-në dhe i kishte tërhequr trupat e veta. Ky shembull na shërben për të ilustruar faktin se Qi-ja ishte vërtet tepër e fuqishme, ndërkohë që Chu-së i kish mbetur vetëm dhuntia e inteligjencës së spikatur dhe gjuhës. Kështu secila palë i kishte arritur qëllimet e veta, por fituesi i vërtetë kishte qenë Chu-ja.

MARRËDHËNIET PAQËSORE TË MBAJTURA ME DIPLOMACI

Në periudhën 579-546 para Krishtit, kishte nisur një lëvizje anti-luftë e promovuar nga Hua Yuan dhe Xiang Shu, dy militaristë të shtetit të Sung-ut, që na shërben si një shembull i përshtatshëm për parimin e nënshtrimit të armikut pa luftë. Në atë kohë, shtetet e vogla si Zheng-u dhe Sung-u, të gjendur të shtypur midis shteteve të tjera më të fuqishme si Jin-i dhe Chu-ja, shpesh e pësonin prej tyre. Zheng-u zakonisht mblidhte skllevër të shumtë dhe gurë të çmuar si dhe mëndafsh në kufi, dhe ia ofronte ato si dhurata shtetërore kujtdo që vinte aty për të shkaktuar ndonjë përleshje të vogël kufitare. Sung-u ndërkohë vuante edhe më tepër, dhe në një rast rrethimi nga ana e Chu-së, banorët e këtij shteti ishin detyruar që t'i shkëmbenin fëmijët e tyre për t'i përdorur si ushqim.

Lëvizja anti-luftë kishte nisur në këto rrethana dhe kishte qenë e suksesshme. Sung-u i kishte bindur gjithë shtetet fqinje (përfshirë edhe Jin-in dhe Chu-në) që të nënshkruanin një marrëveshje me Jin-in dhe Chu-në si liderët e kësaj aleance.

Marrëveshja përfshinte edhe këtë dispozitë: “Jin-i dhe Chu-ja nuk do të përdorin forcën kundër njëri-tjetrit. Ata do të duhet të jenë të bashkuar nga të njëjtat qëllime dhe të mirat apo vështirësitë t'i ndajnë njëri me tjetrin... Kujtdo që ta shkelë këtë marrëveshje, le t'i bjerë menjëherë rrufeja nga qielli”.

Në këtë marrëveshje po ashtu thuhej se shtetet e vogla do të duhej t'i paguanin tribute Jin-it dhe Chu-së. Ishte e qartë se atyre u binte më mirë të paguanin ca florinj dhe gurë të çmuar, sesa t'u nënshtroheshin gjëmave të luftës.

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, kishte mbizotëruar një situatë e qetë midis këtyre shteteve, sidomos pas lëvizjes së nisur nga Xiang Shu-ja. Për më tepër se tridhjetë vite, s'e nisur nga asnjë asnjë luftë e rëndësishme midis tyre.
Ngjarjet e përmendura më sipër, ishin po aq të njohura për Sun Tzu-në, sa ç'janë edhe luftërat e njëqind viteve të fundit për ne. Ai kishte po aq njohuri mbi lëvizjen anti-luftë të nisur nga Xiang Shu-ja, sa ç'kemi edhe ne për historinë e dy luftërave botërore të shekullit të njëzetë. Për këtë arsye, doktrina e tij që thoshte se "mënyra më e mirë është që ta nënshtrojmë armikun pa luftë" mbështetej plotësisht në fakte historike.

PËRMBLEDHJE

Në përgjithësi, Sun Tzu-ja i kushtonte shumë rëndësi përdorimit të mjeteve politike, diplomacisë dhe vlerësimeve strategjike lidhur me nënshtrimin e armikut. Deri në këtë pikë, kjo ishte një strategji që kishte të bënte me situatën ekonomike të shtetit përkatës. Është e qartë që Sun Tzu-ja ishte i mendimit se armiku duhej stepur përmes aktive të spikatura politike dhe diplomatike dhe fuqisë ekonomike dhe ushtarake, më mirë sesa me luftë. Në gjuhën e sotme, kjo quhet "qasje që mbështetet te fuqia", ose strategjia e dekurajimit bërthamor. Sun Tzu-ja kishte qenë personi i parë në historinë botërore që kishte shtjelluar publikisht këtë doktrinë. Mund të dalim pra në përfundimin se Arti i Luftës i Sun Tzu-së ishte ngjizur nën efektet e përvojës së fituar gjatë periudhës së Pranverës dhe Vjeshtës. Ai nuk kishte qenë pjellë e imagjinatës, as nuk ishte kopjuar direkt nga përfundimet e mendjes së paraardhësve të tij.

KAPITULLI IX

MATERIALIZMI NAIV DHE DIALEKTIKAT PRIMITIVE

Nganjëherë bëhet e vështirë të vlerësohen në mënyrën e duhur ngjarjet e ndryshme në botë për shkak të ndryshimeve mes tyre sa i përket kohës, vendit ku ndodhin, prapaskenës historike, zhvillimit dhe rezultatit final. Por ndërkaq, shpesh është e mundur të dëshmohet saktësia e ndonjë të vërtete relative si pasojë e suksesit apo dështimit të asaj çfarë ka ndodhur në përputhje me rregullin e zhvillimit historik.

Nga një këndvështrim filozofik "materializmi nuk është gjë tjetër veç njohurive praktike të njeriut mbi botën reale që është zhvilluar mbështetur në praktikën e tij sociale". Është diçka tejet e lavdërueshme fakti që Sun Tzu-ja e kishte shkruar Artin e Luftës duke sintetizuar fenomenet e ndryshme sociale (përgjithësisht të ndërlidhur me luftën) më tepër se dy mijë vite më parë, dhe duke nxjerrë mësimet e duhura nga librat mbi artin e luftës të shkruara nga paraardhësit e tij. *Arti i Luftës* i Sun Tzu-së hedh dritë mbi shumë ligjësi të rëndësishme të luftës, aty flitet në mënyrë gjithëpërfshirëse për faktorët përkatës që shpien drejt fitores, dhe pasqyrohet qartas materializmi naiv dhe dialektikat primitive.

Gjatë periudhës së Pranverës dhe Vjeshtës, Kina po kalonte nëpër epokën e tranzicionit nga shoqëria skllavopronare

drejt asaj feudale. Gjatë pesëqind viteve sa kishte zgjatur kjo periudhë, disa shkolla të ndryshme mendimi – të zhvilluara nga Konfuci, Menciusi, Yangzi-ja, Mozi, Zhuangzi-ja, Laozi-ja dhe Sun Tzu-ja – ishin përhapur anembanë. Me zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë, disa syresh ishin venitur, por të tjera kishin vijuar të përhapen. Doktrina e Sun Tzu-së bën pjesë mes atyre që vazhdojnë të mbeten popullore qysh atëherë. Kjo gjë pra, e dëshmon plotësisht vlerën praktike të saj.

Arti i Luftës i Sun Tzu-së përmban mendime të materializmit naiv dhe dialektikave primitive që pasqyrohen në shumë prej pohimeve të tij. Më poshtë do t'i paraqesim disa syresh që janë shumë të dukshme: "Kështu pra, arsyeja përse sundimtari mendjendritur dhe gjenerali i mençur arrijnë ta mposhtin armikun dhe përse arritjet e tyre i tejkalojnë ato të njerëzve normalë, i detyrohet largpamësisë. Kjo largpamësi nuk mund të vijë nga shpirtrat e përtejmë, as nga hyjnitë, aq më pak nga analogjitë me ngjarjet e kaluara, e as nga përllogaritjet hamendësuese. Ajo duhet të fitohet vetëm nga ata njerëz që e njohin si duhet situatën e armikut. Sun Tzu-ja nuk besonte te zotat, shpirtrat apo parashikimi i së ardhmes; aq më pak mbështetej ai te astrologjia për veprimet e veta. Kultura jonë krenohet me faktin që Sun Tzu-ja kishte qenë një ateist edhe dy mijë vite më parë.

ATEIZMI PËRBALLË TEIZMIT

Gjithmonë ka ekzistuar një rivalitet i fortë midis dy këndvështrimeve botërore – ateizmit dhe teizmit – gjë që vetëkuptohet se është pasqyruar edhe në punët e luftës. Tashmë e dimë falë mbishkrimeve nëpër kocka dhe guacka breshkash të kohës së dinastisë Shang dhe nëpër objekte

bronzi, se në lashtësi parashikimi i të ardhmes ishte tepër i praktikuar në Kinë përpara zbritjes në fushën e betejës, për të njohur qysh më parë rezultatin e luftës.
Në kohët e lashta, kishte debate të ashpra ndërmjet gjeneralëve me ide materialiste dhe atyre që ishin thellësisht bestytë lidhur me faktin se ishte apo jo e udhës që të viheshin trupat në lëvizje ditën e Jiazi-së. Argumenti që bestytët ofronin kundër materialistëve ishte se Beteja e Muye-s (1098 para Krishtit) kishte nisur ditën e Jiazi-së. Ajo kishte qenë një fitore e plotë për mbretin Zhou mu dhe katastrofë totale për mbretin Ying Zhou. Gjë që shërbente si arsye mjaft e fuqishme.
Pavarësisht faktit se Sun Tzu-ja nuk i pranonte bestytnitë, gjithsesi ka pasur jo pak gjeneralë mendjemëdhenj që para se të lëviznin trupat praktikonin rite bestyte. Kjo gjë e ndodhur jo vetëm në Kinë, por edhe në Perëndim. Afërsisht gjysmë shekulli para erës së Krishterë, Jul Çezari romak po drejtonte një luftë kundër popujve gjermanikë. Në një nga betejat me ta, kundër ushtrisë së tij po luftonte vetëm gjysma e trupave të ushtrisë gjermanike. Si pasojë kishte ndodhur një fitore tepër e madhe e ushtrisë romake, e cila pa dyshim që do të ishte mposhtur nëse edhe pjesa e mbetur e ushtrisë gjermanike do t'i ishte bashkuar betejës. Siç kishte pohuar një rob lufte gjermanik, arsyeja përse pjesa kryesore e ushtrisë gjermanike nuk i ishte bashkuar betejës kishte të bënte me faktin se udhëheqësit e saj besonin se zotat nuk donin që ushtria gjermanike të luftonte para se gjysmë-hëna të ngrihej në qiell, sepse përndryshe ata do të pësonin humbje.
Shpjegim që na tregon se sa i vlefshëm ishte mendimi materialist i ateizmit të Sun Tzu-së. Parimi i tij se “ajo duhet të fitohet vetëm nga ata njerëz që e njohin si duhet situatën

e armikut", nuk kish të bënte vetëm me përdorimin e spiunëve. Faktikisht, theksi që ai vinte mbi rolin e njeriut pasqyrohet edhe në shpërfaqjen e faktorëve politikë, diplomatikë dhe ekonomikë që ndikojnë në fatet e luftës. Doktrinat e tij materialiste pasqyrohen në pikëpamjen se sundimtari duhet ta ketë "popullin në harmoni me veten" dhe "përllogaritjet e duhura në harmoni me mendje". Strategjitë e armikut dhe aleancat e tij duhen dëmtuar. "Pasi të keni në dorën tuaj njëqind mijë florinj, njëqind mijë ushtarë mund të mblidhni".

MENDIMI DIALEKTAL PRIMITIV I SUN TZU-SË

Ka edhe shumë pohime në librin Arti i Luftës së Sun Tzu-së që pasqyrojnë mendimin e tij dialektal primitiv. Fare thjesht mund të përzgjedhim ndonjërin syresh që shkon në vijë të drejtë me ligjësinë e unitetit të të kundërtave. Për shembull: e jashtëzakonshmja dhenormalja, zbrazëtia dhe plotësia, e tërthorta dhe e drejtpërdrejta, e fuqishmja dhe e dobëta, fituesja dhe humbësja, e favorshmja dhe e pafavorshmja, armiku dhe vetvetja, e shumta dhe e pakta, kapitja dhe çlodhja, mirë-ushqyerja dhe uria, turbullirat dhe paqja, e zhurmshmja dhe qetësia, përparimi dhe tërheqja, e largëta dhe e afërmja, fitorja dhe humbja, trimëria dhe burracakëria.
Kur shtjellon zbrazëtinë dhe plotësinë, ai thekson se duhet të ketë zbrazëti te plotësia dhe anasjelltas. Në kapitullin e titulluar "Mbi sjelljen e ushtrisë", ai kishte shkruar: "Në betejë ekzistojnë vetëm forcat normale dhe ato të jashtëzakonshme, por ndërkaq, mënyra se si ato mund të bashkëveprojnë është e pakufishme; dhe askush nuk mund t'i kuptojë ato në tërësi". Dhe më pas ai shton: "Të qenët të

sigurt se ushtria juaj do t'i bëjë ballë sulmit armik pa pësuar humbje, ka të bëjë me përdorimin e duhur të forcave të jashtëzakonshme dhe atyre normale... Meqë këto dy forca janë anasjelltas riprodhuese; bashkëveprimi i tyre është po aq i pakufishëm sa edhe ai i unazave të zinxhirit. E kush mundet vallë të përcaktojë momentin kur njëra syresh mbaron dhe tjetra fillon?"
Ai theksonte fuqishëm se duhen marrë parasysh njëkohësisht faktorët e favorshëm dhe ata të pafavorshëm kur gjykojmë një çështje. Ai vë në dukje në kapitullin e titulluar "Nëntë ndryshimet": "Gjenerali i mençur, kur merr vendimet e tij duhet të ketë parasysh njëkohësisht faktorët e favorshëm dhe të pafavorshmit. Kur shqyrton faktorët e favorshëm, ai e shndërron në të realizueshëm planin e tij; ndërsa kur shqyrton të pafavorshmit, atij i ofrohet mundësia për të zgjidhur problemet e tij".
Ai përsëri vë në dukje në kapitullin e titulluar "Manovrimi": Përballja e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë: "Ata që ia kanë marrë dorën artit të luftës, bëjnë të pamundurën që t'i shmangen armikut kur shpirti i tij luftarak është akoma i përflakur, dhe e sulmojnë atë kur e ka zënë amullia dhe kur ushtarët e tij i ka kapur malli për vendlindjen. Në këtë mënyrë kontrollohet faktori moral. Duke i shtrënguar radhët pra, ata rrinë në pritje të një ushtrie të padisiplinuar; me shpirtin në paqe, ata presin të përballen me një armik të zhurmshëm. Kështu pra kontrollohet faktori moral. Të gjendur vetë pranë fushës së betejës, ata rrinë në pritje të një ushtrie që vjen nga larg; teksa vetë çlodhen, ata presin një armik të rraskapitur; me trupat e tyre të mirë-ushqyera, ata presin përballjen me një armik të uritur. Ky pra është kontrolli i faktorit fizik. Ata nuk përballen me një armik që përparon në mënyrë të rregullt dhe formacionet luftarake

të të cilit janë të grupuar si duhet. Ky pra është kontrolli i faktorit të rrethanave të ndryshueshme".
Nga doktrinat e përmendura më lart të Sun Tzu-së, mund të vërehet fakti se ai kishte shumë ide dialektale që përputheshin plotësisht me ligjësitë universale të unitetit të të kundërtave. Kur eksplorojmë teoritë e unitetit të botës, ne përballemi edhe me faktin se mënyra e tij e të menduarit ishte tepër sistematike dhe objektive. Duke gjykuar për nga mënyra se si ai e shikonte natyrën dhe ligjësitë e botës, mendimi i tij logjik mund të thuhet se ishte tepër i rreptë dhe, për këtë arsye, shumë i vlerësueshëm.

KAPITULLI X

LIGJËSIA UNIVERSALE E LUFTËS

Sun Tzu-ja thekson në kapitullin e titulluar “Përdorimi i spiunëve”: “Kështu pra, arsyeja përse një sundimtar mendjendritur dhe një gjeneral i mençur arrijnë ta mposhtin armikun sa herë që sulmojnë, ka të bëjë me largpamësinë e tyre”. Largpamësia, thelbësisht, domethënë ta njohësh situatën e armikut dhe të vetvetes përpara se të fillojë beteja, pikërisht siç kishte shkruar Sun Tzu-ja në kapitullin “Strategjia sulmuese”: “Njiheni armikun dhe njiheni vetveten; dhe në njëqind beteja kurrë s'do të mposhteni. Kur nuk e njihni armikun, por e njihni vetveten, mundësitë tuaja për të fituar apo humbur janë të njëjta. Nëse nuk e njihni as armikun e as vetveten, atëherë pa dyshim që do të mposhteni në çdo betejë”. Asnjë komandant – qoftë në kohët e sotme apo në të kaluarën, në Kinë apo gjetiu – nuk mund ta ketë luksin ta injorojë këtë parim.

Ai përbën një ligjësi universale të pakrahasueshme përgjatë rrjedhës së historisë, dhe ajo përfaqëson ndërkaq majën e diamantit të mendimit të Sun Tzu-së. Filozofikisht, ajo i përket materializmit naiv. Nga këndvështrimi i teorisë së luftës, ky parim përbën një ligjësi themelore të të gjykuarit dhe analizuarit. Dhe për nga këndvështrimi i udhëheqjes së luftës, ai mishëron një mundësi tejet të rëndësishme të shqyrtimit pikësëpari të kushteve që mund të na shpien

drejt fitores, dhe pastaj për gjetjen e çelësit që na siguron fitoren e plotë.

MBLEDHJA MODERNE E INFORMACIONEVE SEKRETE

Në ditët e sotme, fondet që Bashkimi Sovjetik dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës shpenzojnë për mbledhjen e informacioneve sekrete mbi njëri-tjetrin, janë të jashtëzakonshme. Një gjeneral amerikan që kishte qenë i ngarkuar me shërbimet inteligjente, kishte theksuar se qysh nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, Shtetet e Bashkuara kishin shpenzuar jo më pak se 50 gjer në 75 miliardë dollarë për ngritjen e shërbimeve sekrete. Ai kishte shtuar se pavarësisht këtyre përpjekjeve madhore, sërish Shtetet e Bashkuara nuk ndodheshin në ndonjë pozitë më të mirë se para bombardimit të Pearl Harbor-it në 1941-in. Ky pohim ishte bërë në vitin 1970-të. Kështu pra, mund të përfytyrojmë fare lehtë se sa të larta janë shpenzimet për shërbimet inteligjente. Sa i përket Bashkimit Sovjetik, ky vend i ruan tepër sekrete shpenzimet e veta në këtë fushë, por sidoqoftë nuk është edhe aq e vështirë të imagjinohet se sa fonde marramendëse shpenzojnë edhe ata për këtë qëllim.

Mao Ce Duni e vlerësonte se tepërmi parimin e Sun Tzu-së, duke pohuar se edhe sot e kësaj dite ai përbënte plotësisht një të vërtetë shkencore. Për më tepër, ai vinte në dukje në esenë e tij "Problemet e Strategjisë në Luftën Revolucionare Kineze": "Ka njerëz që janë të zotët në njohjen e vetvetes dhe të dobët në njohjen e armikut, dhe të tjerë njerëz janë krejt e kundërta e kësaj; por asnjëri syresh nuk mund t'i zgjidhë problemet e të mësuarit dhe zbatuarit të ligjeve të luftës. Ka një thënie në librin e Sun Tzu-së, studuesi i madh i çështjeve ushtarake në Kinën e Lashtë: 'Njiheni

armikun dhe njiheni vetveten, dhe në njëqind beteja kurrë nuk do të mposhteni', që ka të bëjë paralelisht me njohjen e ligjësive të zhvillimit të realitetit objektiv, sa edhe me të vendosurit të mënyrës se si duhet të veprojmë në përputhje me këto ligjësi, me synimin që ta mposhtim armikun me të cilin përballemi. Pra, nuk duhet ta marrim me të lehtë këtë thënie".
Le të shqyrtojmë pra parimet teorike me vlera praktike të Artit të Luftës në tri aspekte – politik, ekonomik dhe artin e të udhëhequrit.

ASPEKTI POLITIK

Shumë nga problemet mbi të cilat Sun Tzu-ja shtjellohej lidhur me luftën, kanë të bëjnë me aspektin politik. Për shembull, kur ai thotë: "Lufta është një çështje me vlerë jetike për shtetin; një çështje për jetë a vdekje; shtegu drejt mbijetesës apo rrënimit. Prandaj, është e domosdoshme që ajo të studiohet me themel. Për këtë arsye, ajo do shqyrtuar përmes pesë faktorëve themelorë dhe duhen bërë krahasime të rrethanave të ndryshme të armikut dhe atyre tuajave kur kërkohet të parashikohet rezultati i luftës. I pari ndër këta faktorë themelorë është politika; i dyti, kushtet e motit; i treti, terreni; i katërti, komandanti; i pesti, doktrina". "Gjëja më e rëndësishme në luftë është që të sulmohet strategjia e armikut dhe veprimi tjetër më i mençur është që të prishen aleancat e armikut".
Shumica e këtyre pohimeve përfshijnë veprime politike para ose gjatë luftës. Të gjitha këto doktrina asnjëherë nuk ishin formësuar dhe as që mund të ishin menduar nga ndokush para Sun Tzu-së. Ai arriti që sistematikisht t'i ndërlidhte

veprimet ushtarake me synimet politike. Politikën ai e nënkuptonte si mënyrën për ta bërë popullin të jetonte në harmoni me sundimtarin e vet. Që domethënë se sundimtari duhet t'ia imponojë popullit vullnetin e tij dhe vetëm kështu do të arrijë ai që ta bëjë popullin ta ndjekë atë në luftë dhe paqe, pa iu trembur aspak rrezikut për jetën. Me fjalë të tjera, vetëm kur arrihet harmonia politike, bëhet e mundur edhe që të mposhtet armiku. Kur përmend komandantin, ai ka parasysh aftësitë dhe cilësitë që duhet të ketë një komandant. Ndërsa me doktrinën, ai nënkupton organizimin ushtarak, sistemin dhe rregulloret. Me pak fjalë, tre ndër këto pesë faktorë janë drejtpërdrejt të ndërlidhur me politikën. Kurse mes shtatë elementëve që ai përmend, i pari syresh, i dyti, i katërti, i pesti dhe i shtati janë të lidhur drejtpërdrejt me politikën – përkatësisht, cili sundimtar është më i mençur dhe i zoti, cili komandant është më i talentuar, në cilën ushtri rregulloret dhe udhëzimet zbatohen më mirë, cilat trupa administrojnë shpërblimet dhe ndëshkimet në një mënyrë më mendjendritur.

Sun Tzu-ja kishte qenë një ndër njerëzit e parë në Kinën e Lashtë që besonte se diplomacia përbente një ndër çelësat e luftës. Në thellimet mbi çështjet ushtarake para kohës së Sun Tzu-së, edhe të tjerë kishin shkruar mbi rëndësinë e mjeteve diplomatike, por askush nuk e kish përmbledhur mendimin e vet siç kishte bërë Sun Tzu-ja.

Sun Tzu-ja flet për marrëdhëniet midis luftës dhe politikës dhe nga një pikë ai kishte shtjelluar edhe për barrën e luftës, mizoritë e saj dhe problematikat e saj. Ai thekson: “Kur ushtria nis në fushëtata të stërzgjatura, atëherë burimet shtetërore shpejt do të mungojnë. Kur armët tuaja të jenë squllur dhe vrulli juaj të ketë rënë, kur fuqitë tuaja të kenë

shteruar dhe thesari juaj i shtetit të jetë përtharë, atëherë sundimtarët e shteteve fqinje do të përfitojnë nga kriza juaj dhe do të vihen në veprim. Dhe në atë rast, askush, sado i mençur qoftë, nuk do ta ketë të mundur t'i shmangë pasojat katastrofike që do të vijnë më pas".
Është e vërtetë se Sun Tzu-ja nuk kishte qenë i aftë të formulonte parimet shkencore: "Lufta është vazhdimësi e politikës", "Politika nuk është gjë tjetër veç luftës pa gjak", ose "lufta është veç politikë e përgjakur", por gjithsesi ai kishte qenë qartësisht i vetëdijshëm se qoftë nëse ngadhënjejmë apo mposhtemi, shumëçka varet nga fakti nëse mënyra juaj e të qeverisurit është e ndershme dhe e drejtë, dhe nëse sistemi juaj shtetëror është funksional. Ai kishte shkruar një përfundim në kapitullin "Udhëzime taktike": "Ata njerëz që janë të zotët në punët e luftës, dinë të merren edhe me politikë, i ruajnë ligjet dhe institucionet, duke qenë rrjedhimisht të aftë për të formuluar politika fituese". Është vërtet për t'u lavdëruar te Sun Tzu-ja si një udhëheqës ushtarak, vetëdijësimi për ndikimin me rëndësi të veçantë të politikës mbi luftën.
Karl von Clausewitz konstaton: "Lufta është një vazhdimësi e politikës". Kjo është një thënie tepër e njohur që në Perëndim është vlerësuar si një vërejtje fort e mprehtë. Ndërsa tani është zbuluar se një vërejtje e ngjashme gjendet edhe në shkrimet e lashta kineze, për shembull te *Strategjia e Shteteve Ndërluftuese*, në kohën e dinastisë Qin. Aty pohohet qartas: "Është e pamundur të nxirren përfitime pa bërë përpjekjet e duhura dhe të zgjerohet territori i një shteti pa lëvizur vendit. As pesë perandorët dhe tre mbretërit e vetme për t'i realizuar synimet e tilla është që të jetësohen ata përmes mjeteve luftarake". Sigurisht, nxjerrja e përfitimeve

përkatëse dhe zgjerimi i territorit të një shteti, janë të gjitha qëllime politike që arrihen me luftë. Te *Arti i Luftës*, i shkruar nga Sun Bini, i gjetur pas gërmimeve arkeologjike në malet Yin Que, shkruhet: "Një sovran prestigji dhe aftësitë e të cilit nuk janë të krahasueshme me ato të pesë perandorëve dhe tre mbretërve, e ka të pamundur të vërë në jetë politika të njerëzishme, të drejta dhe të virtytshme, duke u shndërruar kështu në një model civilizimi. Për këtë ishin përpjekur faktikisht pafund edhe Yao dhe Shun-i (monarkë mendjendritur të Kinës së lashtë), por nuk ia kishin dalë dot mbanë. Ka probleme që duhen zgjidhur me forcë. Gjë kjo e barasvlershme me arritjen e qëllimeve politike me luftë.

ASPEKTI EKONOMIK

Para se të flasim për mendimin e Sun Tzu-së lidhur me ndikimin e ekonomisë në luftë, me rëndësi për ne është që të përmendim disa pasazhe nga *Guan Zi*, një libër i shkruar një shekull më parë se vepra e Sun Tzu-së, ku pasqyrohet mendimi i Guan Zhong-it në lidhje me ekonominë ushtarake, në mënyrë që të kemi një botëkuptim më të plotë të teorive ushtarake në Kinën e lashtë.
Në librin *Guan Zi*, shkruhet: "Nëse shteti është mjaftueshëm i pasur, atëherë atij nuk do t'i mungojnë furnizimet edhe në qoftë se lufta ka për të zgjatur shumë; nëse shteti gëzon armatime të shkëlqyera, atëherë atij nuk do t'i shterojnë forcat pas sulmeve të njëpasnjëshme të armikut. Sepse nëse ka një çështje të rëndësishme për ushtrinë, ato janë armët. Nëse ushtria nuk është e mirëpajisur, kjo do të thotë se po i çoni dëm ushtarët tuaj. Nëse lufta zgjat një vit, atëherë rezervat e dhjetë viteve do të shterohen. Ndërsa një

luftë në shkallë të gjerë, do t'i shterojë tërë burimet tuaja". Kjo domethënë se është e vështirë të niset një luftë pa siguruar financa të forta dhe armë të shkëlqyera.
Sun Tzu-ja po ashtu i kushtonte shumë rëndësi marrëdhënieve midis veprimeve ushtarake dhe ekonomisë. Ai shkruante: "Në rastin e veprimeve ushtarake, kur një mijë karroca lufte me katër kuaj, një mijë karroca lufte të rënda, dhe një mijë ushtarë me parzmore të nevojshme në fushëbetejë; kur furnizimet transportohen për qindra kilometra; kur ka shpenzime të shumta në vendin e origjinës dhe në front, si dhe pagesa të shumta për të dërguarit dhe këshilltarët – kosto e materialeve si ngjitësit dhe verniku për karrocat e luftës dhe armatimet, do të arrijë në mijëra florinj në ditë. Njëqind mijë trupa mund të jenë gati për luftë vetëm atëherë kur të dispononi këto fonde... Nëse shkoni në luftë me një ushtri kaq të madhe, atëherë është tepër e nevojshme një fitore e shpejtë. Nëse fitorja shtyhet shumë në kohë, atëherë trupat tuaja do të rraskapiten dhe morali do të bjerë përtokë. Kur trupat sulmojnë qytete, forca e tyre tretet".
Ai shton: "Ata që janë të zotët në punët e luftës, nuk kanë nevojë për një valë të dytë rekrutësh apo për t'u furnizuar më tepër se dy herë. Ata i sjellin pajisjet ushtarake nga vendlindja, por furnizimet ia marrin armikut. Në këtë mënyrë, ushtria është gjithmonë e pajisur siç duhet me rezerva ushqimore". Kur një vend i caktuar varfërohet si pasojë e operacioneve ushtarake, kjo gjë ndodh si pasojë e shpenzimeve marramendëse për transportin; mbajtja e furnizimeve nëpër distanca të largëta, e varfëron tejmase popullin. Dhe ndërkaq, aty ku fushon ushtria, çmimet ngrihen pandalur. Atëherë kur çmimet rriten, paralelisht përthahet edhe mirëqenia e banorëve të zonës. Në momentin që

mirëqenia e tyre është shteruar, banorët e ngratë rrjedhimisht do të ngarkohen me taksa të rënda dhe tejet urgjente. Si pasojë e kësaj humbjeje të mirëqenies dhe rraskapitjes vijuese, banorët e vendit përkatës do të bëhen skajshmërisht të skamur dhe shtatë të dhjetat e pasurisë së tyre do të davariten dhe treten fare. Sa për shpenzimet qeveritare, ato syresh që kanë të bëjnë me karrocat luftarake të dëmtuara, me kuajt e kapitur, me parzmoret, helmetat, harqet dhe shigjetat, shpatat dhe mburojat, shqytat mbrojtëse, buajt për tërheqje dhe karrocat, do të arrijnë gjer në 60 përqind të shpenzimeve të përgjithshme".

Është e qartë se Sun Tzu-ja i jepte shumë rëndësi aspektit ekonomik, veçanërisht situatës financiare të vendit përkatës. Parimi i tij i të luftuarit në betejë shpejt duke synuar që armiku të detyrohet të marrë vendime po kaq të shpejta, kishte lindur nga kjo ide. Ai besonte se lufta e stërzgjatur ishte diçka që e shteronte pasurinë e një shteti. Kështu përthaheshin burimet e tij, taksa të rënda duhej të rëndonin mbi kurrizin e popullit; dhe si pasojë, banorët do të zhvisheshin nga çdo pasuri e tyre. Ky rreth vicioz do të shpinte gjer te momenti kur vendet fqinje do të sulmonin duke përfituar nga rasti. Në këtë rast: "Askush, sado i mençur qoftë, nuk do të ishte i aftë t'i shmangte pasojat e mëtejshme".

Sun Tzu-ja ishte një njeri mjaft praktik dhe realist. Teksa flet për marrëdhëniet midis luftës dhe ekonomisë, ai nënvizon përdorimin e burimeve dhe fuqinë njerëzore të armikut. Ai shkruan: "Një zhong (njësi matëse në Kinën e lashtë) e furnizimeve të armikut është e barabartë me njëzet zhong tonat; ndërsa një shi (afërsisht 60 kilogramë) i sanës së armikut për kafshët e tij, është e barabartë me njëzet shi

tonat”. Ai ngulmonte fuqishëm se një komandant i zoti duhej t'i shpërblente ushtarët e tij bujarisht dhe t'i trajtonte në mënyrë të njerëzishme robërit e luftës. Se duhej të përdoreshin armët që i ishin kapur armikut, pajisjet ushtarake dhe robërit e luftës për të mbushur zbrazëtitë e ushtrisë sonë. Këto mendime të tij kishin qenë tepër përparimtare, dhe i kishin përkitur një klase të re feudale që po ngrihej në Kinën e asaj kohe.

Gjatë luftërave çlirimtare kineze, disa milionë ushtarë të Jieshi-së kishin rënë robër të UÇP-së dhe më pas ishin shndërruar në luftëtarët e saj më të bindur mbas një faze edukimi politik. Ndërsa lidhur me masën e armëve që iu kishin kapur armikut, përfshirë këtu tanke, topa, anije luftarake dhe aeroplanë, kjo kishte qenë diçka e padëgjuar, në Kinë apo gjetiu. Këtë fenomen Mao Ce Duni e quante “ngadhënjimi në betejë dhe fuqizimi i mëtejshëm”.

Krahasuar me luftërat e kohëve të shkuara, varësia e luftërave moderne nga ekonomia është e madhe. Edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, megjithë fuqinë e tyre të patundur ekonomike, kishin hasur vështirësi sa i përket vijimit të një lufte të gjatë në Vietnam. Gjenerali Westmoreland, komandanti i përgjithshëm amerikan në Vietnam, e kishte përmendur Sun Tzu-në si argument për tërheqjen e trupave: “Kurrë s'ka pasur ndonjë luftë të stërzgjatur që të ketë qenë e dobishme për një vend”.

Për këtë arsye, duket qartë se sa më e modernizuar të jetë një ushtri, aq më varësi do të ketë ajo nga kushtet ekonomike. Doktrina e Sun Tzu-së mbi marrëdhëniet midis luftës dhe ekonomisë s'ka humbur aspak kuptimin me kalimin e kohës.

ARTI I TË UDHËHEQURIT

Tashmë kemi folur për problemet e luftës nga një këndvështrim strategjik në kapitujt e mëparshëm. Në këtë seksion, do t'u përqasemi atyre nga ana taktike – me fjalë të tjera, nga aspekti i artit të të udhëhequrit të luftës. (Sun Tzu-ja nuk bën një dallim të qartë ndërmjet strategjisë dhe udhëheqjes në trembëdhjetë kapitujt e librit). Diskutimet mbi artin e të udhëhequrit shpërfaqen në shumë kapituj të Artit të Luftës së Sun Tzu-së. Megjithatë, ne tani do të kufizohemi në dy aspekte: iniciativën dhe lakueshmërinë.

INICIATIVA

Si merret iniciativa? Kjo është pyetja parësore të cilës duhet t'i përgjigjemi teksa flasim për artin e të udhëhequrit. Nëse e humbasim iniciativën në fushëbetejë, atëherë do të ngecim në pasivitet dhe do të na sulmojnë pandalur. Ideja e Sun Tzu-së për ta mbajtur iniciativën në duart tona, pikësëpari pasqyrohet në atë që "ta sjellim sipas interesit tonë armikun në fushëbetejë dhe jo të na sjellë ai aty" dhe "një ushtri ngadhënjyese përpiqet të krijojë kushtet për një fitore të mundshme, qysh përpara zbritjes në fushën e betejës". Çdo gjeneral i mençur do të duhej t'i vinte në zbatim sa më mprehtësisht këto ide.
Sun Tzu-ja mbronte idenë se: "Një komandant i zoti zë një pozicion në të cilin nuk mund të mposhtet dhe shfrytëzon çdo mundësi për ta mposhtur armikun. Kështu pra, një ushtri ngadhënjyese përpiqet të krijojë kushtet për fitore përpara se të fillojë beteja; kurse një ushtri që e ka të shkruar fatin e humbjes së saj, lufton vetëm me shpresën se mos i buzëqesh fati dhe rastësisht fiton. Përgjithësisht, ai komandant

që e çon i pari ushtrinë e tij në fushëbetejë dhe më pas pret ardhjen e armikut, domethënë që ndihet i qetë; ai që e çon ushtrinë e tij më vonë dhe nxiton për t'u përleshur, është i lodhur. Dhe për këtë shkak, ata që ia dinë sekretet punëve të luftës, e sjellin vetë armikun në fushën e betejës sipas interesit të tyre, dhe nuk presin që t'i sjellë armiku aty".
Është e vërtetë fakti se komandanti i zgjuar do të duhej që t'ia imponone vullnetin e vet armikut të tij. Dhe vetëm atëherë kur të keni zënë një pozicion në të cilin kurrë s'do të mund të mposhteni – me fjalë të tjera, ku do ta kishit vetë iniciativën në dorë – mund të kujdeseni për ta bërë armikun t'i lëvizë trupat sipas interesave tuaja, duke e shpënë atë drejt humbjes.
Kur ju arrini që të zini të parët një pozicion në fushëbetejë, atëherë ju fitoni aftësinë për t'i manovruar sipas dëshirës trupat e armikut, duke i reformësuar kështu rrethanat në të cilat ndodhet armiku dhe ju vetë, pikërisht siç këshillon Sun Tzu-ja. Të gjithë specialistët dhe studiuesit ushtarakë, të së kaluarës apo bashkëkohorë, kinezë apo të huaj, e dinë kthelltësisht faktin se lufta është një përballje forcash, dhe se forcat mund të transformohen. Kur palët ndërluftuese janë të barabarta (por edhe nëse armiku është më i fuqishëm), nëse e kemi vetë iniciativën në duart tona, atëherë situata mund të evoluojë në të mirën tonë. Nëse jemi të aftë ta kapitim armikun që gjer atëherë ka qenë në epërsi, atëherë rrjedhimisht do të arrijmë të krijojmë një situatë të favorshme në të cilën të na takojë neve të presim armikun.

LUFTA RUSO-JAPONEZE

Në vitet e para të shekullit të njëzetë, Flota Baltike e Rusisë Cariste ishte shpartalluar krejtësisht gjatë luftës

Ruso-Japoneze. Kjo fitore ishte arritur – sipas marshallit Heihachiro, komandantit japonez në këtë betejë detare – falë përdorimit të doktrinës së Sun Tzu-së "të të priturit me qetësi të lëvizjeve të një ushtrie armike të rraskapitur". Me të vërtetë Flota Baltike e Rusisë kishte bërë një gabim shkatërrimtar duke lundruar tërë atë rrugë gjer në Lindjen e Largët, duke i rraskapitur marinarët e saj, ndërkohë që Marina Japoneze priste me mënë më të madhe.
Deti Baltik ndodhej dhjetëra mijëra kilometra larg Detit të Japonisë. Për më tepër, Flota Ruse nuk e kishte të mundur të shkonte për në Lindjen e Largët duke kaluar përmes Ngushticës së Gjibraltarit të kontrolluar nga britanikët, duke lundruar pastaj nëpër Mesdhe dhe Kanalin e Suez-it, për shkak se Britania ishte aleate me Japoninë. Atyre u ishte dashur t'i binin përqark nga Kepi i Shpresës së Mirë, më shumë se dyfishi i rrugës prej dhjetë mijë kilometrash.
Përveç kësaj, pasi Flota Baltike kish kaluar nëpër Ngushticën e Malakas, Ushtria Japoneze kishte përhapur informacione false (në përputhje me doktrinën e Sun Tzu-së se "lufta bazohet te mashtrimi") lidhur me gjendjen e gatishmërisë e Marinës Japoneze për të nisur një sulm të beftë ndaj Marinës Cariste në Detin e Kinës Jugore. Pasi i kishin ngrënë karremin, Flotës Baltike i ishte dashur që gjithë kohën të lundronte në gatishmëri luftarake, gjë që ia kish shteruar edhe më tepër forcat, dhe më pastaj marinarët kishin qenë krejt të këputur nga fuqitë kur kishin arritur në Ngushticën e Tsushimas. Marina Japoneze kish ndenjur në pritje të ngeshme dhe për këtë arsye kishte korrur një fitore të padëgjuar mbi Flotën Ruse.

LAKUESHMËRIA

Aftësia për t'i lëvizur trupat në mënyrë të lakueshme, përbën një tjetër parim të Artit të Luftës së Sun Tzu-së. Ai pohon: “Ashtu siç uji nuk mban një formë të vazhdueshme, njëlloj në kushte lufte nuk ka rrethana të qëndrueshme. Prandaj, ai komandant që është i zoti të korrë fitore falë modifikimit të taktikave të veta në përputhje me situatën e armikut, mund të vlerësohet si një mendje e hyjshme”. Ai shton se lëvizja e trupave duhet të jetë ajo e gjarpërinjve të malit Chang, të cilët i përgjigjen sulmit në mënyrë të njëkohshme: “Kur e godasin në kokë, atëherë sulmon bishti i tij; kur e godasin në bisht, sulmon koka; kur e godasin në kurriz, atëherë ai sulmon njëkohësisht me kokë dhe bisht”.

Me pak fjalë, ai ishte i idesë se na nevojitet t'i përshtatemi situatës së armikut, duke qenë kështu Sun Tzu-ja haptas kundër taktikave të ngurta dhe materializmit mekanik në kushte lufte. Ai gjithashtu ishte kundër përdorimit të taktikave të dala boje. Ai ishte në favor të përdorimit të forcave normale dhe të jashtëzakonshme, plotësisht dhe me zbrazëtisë, këmbyeshmërisë së të vërtetës dhe të rremes, duke synuar që të turbullohet mendja e armikut dhe të arrihet fitorja.

Në të mirë të zbatimit të synimeve të tij, Sun Tzu-ja përpiqej gjithnjë të zinte një pozicion ku iniciativa të ishte në dorën e tij dhe të merrte masa parandaluese. Ai thekson: “Shpejtësia është thelbi i luftës. Shfrytëzojeni papërgatitjen e armikut, depërtoni nga shtigje të papritura, dhe sulmojeni armikun aty ku është më i pambrojtur”. Pikërisht falë këtyre taktikave të lakueshme ai ia dilte mbanë ta mbante armikun të përçarë, pa i lënë formacionet e ushtrisë së tij të bashkëpunonin dhe forcat e tij t'i vinin në mbështetje njëra-tjetrës.

Një komandant i zoti duhet ta njohë me kthjelltësi të plotë situatën në terren dhe të mësojë një art të atillë të udhëhequri falë të cilit ta ketë të mundur ta manipulojë armikun. Sun Tzu shkruan: "Ai komandant që është i aftë ta vërë armikun në lëvizje sipas interesave të tij, e bën këtë duke krijuar një situatë varësisht nga e cila armiku do të veprojë; duke i hedhur armikut pikërisht karremin e duhur për t'u kafshuar me vullnet të plotë prej tij. Ai e mban armikun në lëvizje duke tërhequr fillin e grepit, dhe pastaj e sulmon atë me trupat e veta më të zgjedhura".
Lidhur me mashtrimin e armikut, ka një pohim tepër kuptimplotë në kapitullin "Zbrazëtia dhe plotësia": "Duhen analizuar planet armike që të jeni në dijeni të pikave të tij të dobëta, ashtu si edhe të përparësive të tij kundrejt jush. Bëni mirë ta trazoni nga pak armikun, në mënyrë që të mësoni mënyrën dhe shtigjet e tij të lëvizjes. Mashtrojeni dhe lëshojini atij ndonjë karrem, për të mësuar lëvizjet e tij taktike dhe për të përcaktuar pozicionet e tij. Kryeni ndonjë sulm zbulues sa për të mësuar pikat ku përqendrohet fuqia e tij, dhe ato ku struken dobësitë e tij". Në këtë mënyrë pra mund të zbatohen me sukses ato që thotë Sun Tzu: "Taktika e tij sulmuese do të jetë e papërmbajtshme nëse ai do të synojë pikat e dobëta të armikut të tij; dhe ajt nuk do të mund ta mposhtin teksa tërhiqet, në qoftë se do të lëvizë si shigjetë... Nëse unë vendos që ta bëj të zbresë në fushën e betejës armikun tim, megjithëse ai mund të jetë i mbrojtur nga mure të larta dhe hendeqe të thella, ai nuk do t'i bëjë dot bisht përballjes me mua, ngaqë unë do ta kem sulmuar në një pikë të pambrojtshme për të. Ndërsa kur unë dëshiroj që t'i shmangem betejës, unë do të mundem ta mbroj veten thjesht duke i vënë atij një kufi të pakalueshëm; kështu armiku do ta ketë të pamundur të më sulmojë

për arsye se unë nuk do ta lejoj atë të godasë aty ku dëshiron".

Nëse do të dini t'i bëni lëvizjet tuaja në mënyrë po aq të lakueshme siç përshkruan Sun Tzu-ja, pa dyshim që do të bëni ligjin në fushën e betejës. "Prandaj, pohoj se fitorja mund të arrihet. Sepse edhe nëse armiku është numerikisht më i fuqishëm, ju nuk do ta lini atë të përballet me ju në fushëbetejë".

Thelbi i përdorimit të trupave në mënyrë të lakueshme gjendet në këtë parim: "Lufta mbështetet te mashtrimi". Kjo gjë thuhet në kapitullin "Planifikimi, vlerësimi i gjendjes": "I gjithë arti i luftës ka të bëjë me dinakërinë dhe mashtrimin. Prandaj, kur jeni të aftë të sulmoni, shtiruni sikur nuk mundeni ta bëni këtë gjë; kur jeni duke i spostuar trupat, shtiruni sikur nuk mundeni fare të lëvizni vendit. Kur ndodheni pranë armikut, bëni të duket sikur në fakt jeni shumë larg tij; ndërsa kur vërtet ndodheni shumë larg, bëni të pamundurën që të duket sikur jeni fare afër". Gjithçka ka të bëjë me lakueshmërinë lidhur me të qenët i aftë ose i paaftë, aktiv apo pasiv, larg apo afër. Gjejini armikut të pandehë se jeni larg nëse jeni afër. Për shembull, parimi se "kur ndodheni larg, bëni të duhej të bënit manovra në afërsi të armikut duke e hutuar atë, ndërkohë që trupat i keni diku larg në të vërtetë.

Më poshtë vijojnë dy shembuj që na tregojnë për suksesin e dy gjeneralëve (njërit që i përket lashtësisë, dhe një tjetri në kohët moderne) në përdorimin e këtij parimi.

FUSHATA E HAN-IT KUNDËR CHU-SË

Në vitin 205 para Krishtit, Han Xin-i (i shtetit të Han-it) kishte dashur të sulmojë Wei Wangbao-n (e shtetit të

Chu-së) përmes Lumit të Verdhë. Synimi i Han-it ishte që ta godiste Wei-n prapa krahëve nga Anyi (në qarkun e sotëm të Anyi-t, provinca e Shanxi-së), duke ardhur nga Xiayang-u i largët (në Hanchen-in e sotëm, provinca e Shan Xi-së). Por ndërkaq ai kishte sajuar një diversion duke mbledhur materiale mbi mundësinë e kalimit të Lumit të Verdhë në një vend aty pranë të quajtur Linjing, sikur gjasme ta kishte vërtet në mendje që ta kalonte lumin pikërisht atje. Wei Wangbao-ja e kishte ngrënë karremin dhe i kishte vendosur shumicën e trupave të veta në zonën e Linjing-ut, duke e lënë kështu Anyi-n të pambrojtur. Si pasojë, trupat e Han Xi-së e kishin kaluar lumin në Xiayang pa asnjë pengesë. Kjo kishte qenë një nga fushatat më të mëdha ushtarake midis Chu-së dhe Han-it.

PUSHTIMI I NORMANDISË

Në rastin e operacionit të njohur ushtarak të ndodhur në Europë, gjatë zbarkimit në Normandi në Luftën e Dytë Botërore, gjenerali amerikan Ajzenhauer kishte vendosur që forcat aleate të zbatonin pikërisht në këtë rajon në veri-perëndim të Francës. Por ai ishte kujdesur që të linte të kuptohej se trupat aleate do të zbarkonin në zonën e Kalesë, duke i lëvizur trupat, forcat e marinës dhe ato ajrore në atë drejtim, si dhe duke ngritur një shtab qendror në atë zonë. Ajzenhaueri gjithashtu kish shpërndarë edhe informacione false si dhe një telegram të rremë që ishte dërguar qëllimisht për të turbulluar mendimet e Hitlerit. Si rezultat, Gjermania Naziste ishte mashtruar plotësisht dhe i kishte përqendruar forcat e saj kryesore përgjatë brigjeve të zonës së Kalesë. Si përfundim, forcat aleate kishin zbarkuar me sukses në Normandi.

THEKSI I VEÇANTË I MAO CE DUNIT MBI INICIATIVËN DHE LAKUESHMËRINË

Në shënimet e tij për çështjet ushtarake, Mao Ce Duni po ashtu theksonte rolin e rëndësishëm që iniciativa dhe lakueshmëria luajnë në luftë. Ai në fakt e krahasonte iniciativën me vetë lirinë e veprimit për një ushtri: "Liria e veprimit përbën vetë thelbin e ekzistencës së një ushtrie dhe kur ajo humbet, atëherë ushtria ndodhet në prag të mposhtjes dhe shkatërrimit". Ai gjithashtu kishte bërë vërejtje tepër të mprehta lidhur me lakueshmërinë: "Lakueshmëria qëndron pikërisht në aftësinë e komandantit të mençur për të marrë masa të duhura duke u bazuar tu kushtet reale të situatës pasi "të ketë vlerësuar rrethanat kohore dhe ta ketë zbërthyer situatën e përgjithshme" (përfshirë këtu edhe situatën e armikut, situatën e trupave të veta dhe terrenin), dhe kjo lakueshmëri, pra, përbën një "zotësi madhore në aftësinë për të ndryshuar taktikat".

Kështu që të shqyrtuarit e teorisë së Sun Tzu-së mbetet diçka me vlera tepër praktike. Faktikisht, ekziston një masë e madhe teorie praktike e shqyrtuar në lidhje me artin e të udhëhequrit të Sun Tzu-së në librin *Arti i Luftës*. Ne ndërkaq po marrim në konsideratë vetëm mendimet e tij më të spikatura.

KAPITULLI XI

IDETË E VJETËRUARA TE ARTI I LUFTËS I SUN TZU-SË

Duhet pranuar fakti se e vërteta është gjithnjë në evoluim e sipër me kalimin e kohës. Mao Ce Duni vë në dukje në shkrimin e tij *Mbi Praktikën*: "Pandalshmëria e ndryshimeve në botën e realitetit objektiv është e pakufishme, duke qenë krejtësisht i këtillë edhe botëkuptimi i njeriut lidhur me të vërtetën përmes praktikës". Dhe duke e mbajtur parasysh këtë teksa shqyrtojmë *Artin e Luftës* së Sun Tzu-së, atëherë mund të dalim në një përfundim të saktë.

Duke folur në përgjithësi, kur studimet e lashta akademike merren në shqyrtim, nuk përbën diçka të gabuar nëse e pranojmë apo mohojmë diçka prej tyre duke thënë: "Për shkak të kufizimeve si pasojë e rrethanave të kohës apo ndarjeve klasore..." Por gjithsesi lexuesit mund t'i ofrohet një botëkuptim më i qartë dhe i thellë i librave të lashtë nëse ata do të vlerësohen duke pasur parasysh ambientin dhe kohën në të cilën ishin shkruar.

Mangësitë kryesore të *Artit të Luftës* së Sun Tzu-së kanë të bëjnë me faktin se ai nuk flet fare për natyrën e luftës. Gjykuar nga statistikat e ofruara nga historianët, kishin ndodhur nga katërqind në pesëqind luftëra të mëdha ose të vogla gjatë Periudhës së Pranverës dhe Vjeshtës kur kishte jetuar edhe vetë Sun Tzu-ja. Menciusi, një dijetar i famshëm

që kishte jetuar pak kohë mbas Sun Tzu-së, kishte dalë në një përfundim të gjithëvlerësuar: "Gjatë Periudhës së Pranverës dhe Vjeshtës asnjë luftë nuk kishte qenë e drejtë". Të jetë vallë një vlerësim i saktë ky? Përgjigja është negative.
Luftërat midis shteteve të mëdha gjatë kësaj periudhe kishin qenë pa dyshim të padrejta, por ndërkohë, ato luftëra që kishin bërë shtetet e vogla kundër agresionit të fuqive të mëdha kurrsesi nuk kishin qenë të tilla. Për shembull, Sung-u, një shtet i vogël, ishte rrethuar nga dy fuqi të mëdha, Jin-i dhe Chu-ja, dhe banorëve të tij u ishte dashur t'i shkëmbenin fëmijët e tyre njëri me tjetrin për t'i ngrënë si ushqim. A mos nuk paskësh qenë kështu Sung-u në anën e së drejtës kur i kishte ngritur armët kundër agresorëve?
Në librin historik *Zou Zhuan*, gjenden të dhëna mbi shumë kryengritje të skllevërve mes shekullit të shtatë dhe të gjashtë para Krishtit. Tepër të njohura ndër to, kishin qenë kryengritja e skllevërve në Qi kundër ndërtimit të mureve të qytetit, si dhe rebelimi i shërbëtorëve në Zhen kundër klasës sunduese. A mos nuk kishin qenë vallë skllevërit në anën e së drejtës kur ishin ngritur kundër zgjedhës së klasës sunduese dhe pronarëve të skllevërve si pasojë e rritjes së fërkimeve klasore? Për fat të keq, kjo gjë nuk shtjellohet në librin *Arti i Luftës* i Sun Tzu-së. Dhe rrjedhimisht, ky fakt nuk mund të mos vlerësohet si një e metë madhore dhe një përpjekje për t'i mbajtur ushtarët të painformuar mbi këto ngjarje.
Qasja obskurantiste kishte përbërë një tjetër të metë të fortë në veprën e Sun Tzu-së. Vërtet që ai kishte shkruar: "Trajtojini ushtarët tuaj si t'i kishit fëmijët tuaj", dhe "Komandojini nën kontroll me disiplinë të hekurt". Duket pra në plan të parë

se ai synonte të përhapte idenë se ushtarët duheshin trajtuar mirë dhe duhej ruajtur disiplina e tyre. Por mënyra se si ai kishte shkruar për në rrethana lufte kishte qenë krejt e kundërta. Ai kishte shkuar aq larg sa të pohonte se komandanti "duhet të jetë i aftë mos ua bëjë aspak të ditura planet e veta oficerëve dhe ushtarëve të tij... Njëherë duhet t'i lëvizte ushtarët në një drejtim, pastaj në tjetrin, sikur të ishte një bari dhensh me tufën e tij, në mënyrë që askush të mos e kuptonte se ku donte të shkonte vërtet... Ta kon gjeneralit që t'ua heqë shkallën ushtarëve të vet që u janë kacavarrur lartësive". Të gjitha këto mund të cilësohen si ide reaksionare që nënçmojnë shtresat punëtore.

Mangësia e dytë ka të bëjë me faktin se ai e tejtheksonte rolin e gjeneralëve. Ai thoshte: "Ai gjeneral që arrin të kuptojë sesi t'i përdorë si duhet trupat e veta, do të shndërrohet në përcaktuesin e fatit të njerëzve të tij dhe arbitër të së ardhmes së kombit". Ja edhe një këndvështrim tjetër i tij mbi këtë temë: "Këto janë ndër ato raste kur udhëzimet e komandantit janë mbi urdhrave të sovranit". Dhe duhet pranuar se nuk kanë qenë të pakët ata komandantë që sipas këtij këndvështrimi, kanë gjetur pretekst për të mos iu bindur urdhrave të komandës supreme. Të jetë pra ky ky këndvështrim i saktë? Qyshkur raca njerëzore ka nisur të bëjë luftëra, ajo është kushtëzuar nga politika, dhe kurrë e në asnjë mënyrë nuk është ndarë nga politika. Prandaj, edhe kombi mund të pësojë dëme të mëdha nëse interesat afatgjata gjithëpërfshirëse të shtetit do të mënjanohen në favor të interesave mendjengushta në fushëbetejë.

Gjithashtu përdoren justifikime të llojit që në kohët e lashta komunikimet ishin të vështira dhe të dobëta, ndërkohë që situata në frontin e luftës ndryshonte tepër shpejt, kështu që komandantëve u dilte nevoja të silleshin në mënyrë

arbitrare për t'u përballur si duhet me situatën e ndryshueshme. Sado që ky mund të quhet një argument i fuqishëm, sidoqoftë gjërat kanë ndryshuar së tepërmi. Në ditët tona, me ndihmën e mjeteve të telekomunikacionit, televizionit dhe satelitëve, komanda e përgjithshme e kontrollon dhe njeh qoftë edhe ndryshimin më të vogël të ngjarjeve në fushëbetejë. Kështu që, rrjedhimisht ajo është krejtësisht në pozitat e duhura për t'i ripërshtatur lëvizjet e trupave ose taktikat përkatëse varësisht nga situata e re e krijuar atypari. Një komandanti nuk i lejohet në asnjë mënyrë të mos u bindet urdhrave nga komanda e përgjithshme, vetëm për shkak të interesave lokale. Në qenësinë e vet si një ligjësi e zakonshme lufte, parimi i Sun Tzu-së "ka raste kur urdhrat e sovranit nuk duhen zbatuar", tanimë duhet konsideruar si i vjetëruar.

KONTRA DIKTAT E SUN TZU-SË

Pika e tretë ka të bëjë me faktin se disa prej parimeve të tij janë shumë të ngurta dhe mekanike. Për shembull: "Mos e pengoni një ushtri që po kthehet në vendlindje. Është e udhës t'i lihet një shteg shpëtimi një ushtrie të rrethuar, dhe të mos sulmohet shumë ashpër një armik i dëshpëruar". Këto parime janë kontradiktore me shumë të tjerë syresh në vetë *Artin e Luftës* së Sun Tzu-së. Për shembull, kini parasysh këshillën e tij për "... shmangeni armikun kur e ka shpirtin të gjallë dhe sulmojeni atë kur është i amullt dhe ushtarët e tij i ka marrë malli për vendlindjen". Pohim ky krejtësisht i kundërt me çfarë ishte thënë më sipër. Parimi i fundit është, pa asnjë hije dyshimi, tepër i saktë.
Sun Tzu-ja sugjeron në kapitullin e titulluar "Strategjia sulmuese" që të rrethohet një ushtri kur jeni në raport dhjetë

me një përballë saj. Kjo është ideja e "luftës për asgjësim", me një përballë saj. Kjo është ideja e "luftës për asgjësim", me një përballë saj. Kjo është ideja e "luftës për asgjësim", duke qenë plotësisht i saktë. Sigurisht, nuk do të duhej t'i linit një shteg shpëtimi armikut nëse e keni rrethuar atë. Gjatë fushatës së Huai-Hai-t, nëse UÇP-ja do ta kishte lënë një shteg daljeje armikut për t'ia mbathur, do të kishte qenë sikur ta kish lënë tigrin të kthehej në mal. Në atë rast, si do të mundej vallë UÇP-ja ta kish arritur fitoren duke e fshirë fare armikun nga faqja e dheut? Pikëpamja se "i duhet lënë një shteg shpëtimi një armiku të rrethuar" konsiderohet si tepër e ngurtë për shkak të fjalës "duhet". Gjithaq ka raste kur mund të jetë krejt e pranueshme dhe e favorshme të lihet një rrugëdalje për armikun atëherë kur synohet një fushatë e shpejtë ushtarake ose që të shpihet armiku drejt një kurthi.

Sa për doktrinën e "mos e sulmoni shumë ashpër një armik të dëshpëruar", ajo mund të quhet absurde. Mao Ce Duni kish shkruar dy vargje tepër të famshme në një poemë të tij:

Fuqishëm dhe pa ngurrim, armikun e amullt duhet ta ndjekim hap pas hapi

Dhe jo të imitojmë si majmunë Xiang Yu Pushtuesin, që veç famë kish synuar

Arti i Luftës i Sun Tzu-së, është një vepër ushtarake e shkruar më tepër se dy mijë vite më parë. Megjithatë, shumëçka nga doktrina e tij, parimet dhe rregullat e tij akoma kanë një domethënie praktike dhe plotësisht universale. Për këtë arsye, ai mbetet një pasuri tepër e çmuar e popullit kinez dhe i këtillë do të mbetet në çdo luftë të ardhshme kundër çfarëdo agresioni.

Pavarësisht gjithë kësaj, ky libër, që ishte shkruar sipas interesit të klasave të reja feudale, përmban pashmangshmërisht disa pikëpamje reaksionare, si pasojë e kufizimeve të kohës në të cilën është shkruar, dhe për shkak të klasës sociale së cilës i kishte përkitur autori. Këto mangësi do të duhej të mbaheshin parasysh gjatë hulumtimeve të mëtejshme. Në këtë mënyrë, shkenca ushtarake do të mund të zhvillohet dhe ide të tjera do të ngjizen ndërkaq.

PËRMBAJTJA

Parathënie 7
KAPITULLI I
Planifikimi, vlerësimi i gjendjes 11
KAPITULLI II
Veprimet luftarake ..... ……..15
KAPITULLI III
Strategjia sulmuese 19
KAPITULLI IV
Udhëzime taktike 23
KAPITULLI V
Mbi sjelljen e ushtrisë 27
KAPITULLI VI
Zbrazëtia dhe plotësia 31
KAPITULLI VII
Manovrimi: përballja e drejtpërdrejtë dhe e tërthortë ... ……...37
KAPITULLI VIII
Nëntë ndryshoret ..... .41
KAPITULLI IX
Në marshim 45
KAPITULLI X
Terreni 51
KAPITULLI XI
Nëntë terrenet e ndryshme ..... ……57

KAPITULLI XII
Sulmi me zjarr 65
KAPITULLI XIII
Përdorimi i spiunëve 69

KOMENTET E GJENERALIT TAO HANGZHANG PËR ARTIN E LUFTËS

KAPITULLI I 75
KAPITULLI II 99
KAPITULLI III 107
KAPITULLI IV 117
KAPITULLI V 127
KAPITULLI VI 139
KAPITULLI VII 145
KAPITULLI VIII 155
KAPITULLI IX 165
KAPITULLI X 171
KAPITULLI XI 189

SUN TZU

ARTI I LUFTËS

I shkruar më shumë se 2,500 vjet më parë,
Arti i Luftës i Sun Tzu mbetet vepra më e rëndësishme
ndonjëherë mbi strategjinë dhe udhëheqjen.
I thellë, i mençur dhe jashtëzakonisht i zbatueshëm,
ky libër i lashtë ofron mësime të përjetshme për fitore
jo vetëm në fushën e betejës, por në çdo sfidë të jetës.

Nga njohja e vetes dhe e armikut, te menaxhimi i burimeve,
terrénit, kohës dhe njerëzve – Sun Tzu zbulon parimet
që gojnë drejt fitores me mençuri, jo me forcë të verbër.

Një udhërrëfyes i domosdoshëm për liderë, strategë,
sipërmarrës dhe këdo që kërkon të kuptojë
thelbin e suksesit në një botë konkurruese.

"Sundimi më i madh është të mposhtësh armikun
pa luftuar."
– SUN TZU